

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve



Ky material është përgatitur duke u bazuar në:

1. Materialet e përgatitura nga Banka Botërore për Projektin Pilot të mirëmbajtjes, implementuar në qarqet e Tiranës dhe të Kukësit.
2. Në eksperiencat më të mira të mirëmbajtjes së rrugëve në vendin tonë.
3. Në Materialin SITEB-Shoqata Italianë e Bitumit, Asfaltit dhe Rrugëve.
4. Në Manualin e Inspektimit për Mirëmbajtjen me Bazë Performance të përgatitur nga kompanitë “EGIS” dhe Banka Botërore.
5. Në ligjin nr. 8378, dt. 22.7.1998, hyrë në fuqi më 21.7.1999 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Manualin e Sinjalizimit Rrugor (Viti 2007)

SHKURTIME

ARrSh	Autoriteti Rrugor Shqiptar
BB	Banka Botërorë
KPB	Kontratat me Bazë Performance
MP	Mbikqyrësi(Mbikëqyrësi i Punimeve)
NSh	Niveli i Shërbimit
S SH	Standarti Shqiptar
S SH EN	Standarti European
RPM	Shënjesit e Ngritur Retrorefrektues
MSDS	Materiali Dokumentit të të Dhënave të Sigurise
IRI	International Roughness Index
KRrSh	Kodi Rrugor Shqiptar
MSRr	Manual i Sinjalizimit Rrugor,

PËRMBAJTJA	<i>fq</i>
<i>Hyrje</i>	9
<i>Qëllimi dhe objektivat</i>	9
<u>Pjesa A1. Konceptet themelore te Kontratave te Mirembajtjes te Bazuara ne Performancë</u>	10
<u>Pjesa A2. Përshkrim i Shërbimeve që do mundësohen</u>	12
2.1.1 <i>Qëllimi i Shërbimeve që do mundësohen</i>	13
2.1.2 <i>Përshkrim i zonës ku ndodhet rruga</i>	13
2.2 <i>Punimet Rehabilituese që do kryhen nga Kontraktori</i>	153
2.2.1. <i>Si shprehen punimet e rehabilitimit</i>	13
2.2.2. <i>Kriteret e dizenjimit për punimet e rehabilitimit</i>	13
2.2.3 <i>Lista e dokumentave që lidhen me aprovimin e punimeve te rehabilitimit</i>	13
2.2.4 <i>Përshkrimi i punimeve të rehabilitimit</i>	14
2.2.5 <i>Cilësia e materialeve që do të perdoren</i>	15
2.2.3. <i>Funksionet e personelit kyç</i>	15
2.4. <i>Puna paraprake para fillimit të punimeve</i>	15
2.5. <i>Rregullat e kriterëve të cilësisë së shërbimit</i>	16
3. <i>Metodat e Inspektimit të Niveleve të Shërbimit</i>	16
3.1. <i>Inspektimet formale të Niveleve të Shërbimit</i>	16
3.2 <i>Inspektimet Informale të Niveleve të Shërbimit</i>	16
3.3. <i>Paraqitja e Informacionit të Menaxhimit të Rrugës</i>	17
3.3.1. <i>Deklarata Mujore</i>	17
4. <i>Programi i Punimeve</i>	17
4.1 <i>Plani i Kontraktorit për Sigurimin e Cilësisë</i>	18
4.2 <i>Planet e Menaxhimit të Shëndetit e Sigurisë</i>	18
4.3 <i>Procedurat e Emergjencës</i>	19
4.4 <i>Plani i Menaxhimit të Trafikut</i>	19
4.5 <i>Raporti i Dorëzimit</i>	20
5. <i>Kriteret e Niveleve të Shërbimit për rrugët e shtruara</i>	20
5.1. <i>Përdorimi i Rrugës, Shërbimi i Përdoruesit të Rrugës dhe Masat e Komfortit për Rrugët e Shtruara</i>	20
6 <i>Masat e Qendrueshmërisë për rrugët e shtruara</i>	20
6.1. <i>Ashpërsia e rrugës</i>	20
6.1.1 <i>IRI – Treguesi Nderkombëtar i Ashpërsisë së rrugës</i>	22
6 <i>Masat e Qendrueshmërisë për rrugët e shtruara</i>	20
6.2. <i>Gjërësia e shtrimit</i>	23
6.3 <i>Mjetet e perdorura per vleresimin e Niveleve te Shërbimit per rrugët e shtruara</i>	21
6.4 <i>Metodologji për masat e qendrueshmërisë</i>	21
6.4.1. <i>Procedurat për inspektim</i>	21
7. <i>Sinjalistika dhe Siguria e Rrugës</i>	21
7.1 <i>Masat e Niveleve të Shërbimit për Sinjalistikë dhe Siguri në rrugë</i>	21
7.2 <i>Variacionet dhe pajtueshmëria graduale me Nivelet e Shërbimit për Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore</i>	23

7.3	<i>Procedurat për inspektim.....</i>	26
8	<i>Kullimi.....</i>	26
8.1	<i>Nivelet e Shërbimit.....</i>	26
8.2	<i>Variacionet dhe Pajtueshmëia graduale me nivelet e shërbimit</i>	27
8.3	<i>Procedurat për inspektim.....</i>	27
9.	<i>Bimësia.....</i>	28
9.1	<i>Nivelet e shërbimit.....</i>	28
9.2	<i>Menyrat që perdoren për të vlerësuar përputhshmërinë me NSh...</i>	30
10	<i>Veprat e artit.....</i>	30
10.1	<i>Nivelet e shërbimit.....</i>	31
10.2	<i>Devijimet dhe përputhshmëria graduale me Nivelet e Shërbimit.....</i>	31
10.3	<i>Procedurat për inspektim.....</i>	31.
11.	<i>Skarpata – Gërmimet dhe Bankinat.....</i>	32
11.1	<i>Nivelet e shërbimit.....</i>	32
11.2	<i>Devijimi dhe përputhshmëria graduale me Nivelet e Shërbimit.....</i>	33
11.3	<i>Procedurat për inspektim.....</i>	33
12.	<i>Pjesa B: pagesat dhe Penalitetet.....</i>	33
12.1	<i>Zbritjet në pagesa dhe Demet e Likuidueshme.....</i>	33
12.2	<i>Si përcaktohen zbritjet nga pagesat.....</i>	33
12.3	<i>Pajtueshmëria/ mospajtueshmëria për kryerjen e shërbimit sipas niveleve të caktuara.....</i>	34

Pjesa B : Rregullat për punimet Emergjente.....43

1.	<i>Detyrimet e Kontraktorit gjatë punimeve dhe situatave emergjente.....</i>	45
2.	<i>Riparime të vogla që janë të nevojshme nëpërmjet “Fenomeni Natyror i Paparashikuar”.....</i>	45

Pjesa C: Rregullat Standarte48

1.	<i>Kërkesa të përgjithëshme.....</i>	48
2.	<i>Termet.....</i>	49
3.	<i>Mjeshtria dhe Kontrolli i Cilësisë.....</i>	51
4.	<i>Dorëzimi tek Mbikqyrësi.....</i>	51
5.	<i>Mirëmbajtja e rrugëve dhe ndertimeve ekzistuese.....</i>	52
6.	<i>Materialet dhe artikujt e prodhuar.....</i>	52
7.	<i>Njoftimi i nderhyrjeve.....</i>	52
8.	<i>Punimet e përkohëshme.....</i>	52
9.	<i>Informacioni i dhënë nga punëdhënësi.....</i>	53
10.	<i>Kërkesat e përgjithëshme të ndertimit.....</i>	53
11.	<i>Mbrojtja nga uji.....</i>	54
12.	<i>Mbrojtja e shërbimeve komunale ekzistuese.....</i>	55
13.	<i>Devijimi i shërbimeve komunale.....</i>	56
14.	<i>Koordinimi me Qeverinë dhe nenpunësit e policisë.....</i>	56
15.	<i>Furnizimi me ujë.....</i>	57
16.	<i>Moti i pafavorshëm.....</i>	57
17.	<i>Heqja e kampeve.....</i>	57

Pjesa D: Programi i Kontraktorit 58

1.	<i>Përshkrimi.....</i>	58
----	------------------------	----

2. Të përgjithëshme.....	58
3. Paraqitja e Programit.....	59
Pjesa E: Siguria ne rruge dhe kontrolli i trafikut.....	60
1. Kërkesa të përgjithëshme	61
2. Masat për kontrollin e trafikut.....	61
3. Numri i Korsive të trafikut.....	62
4. Punimet e perkohëshme rrugore.....	62
5. Ndihma ndaj Mbikqyresi i Punimeve.....	63
Pjesa F: Kontrolli i Cilësisë.....	64
1. Miratimi.....	64
2. Inspektime dhe prova.....	64
3. Matjet dhe pagesat.....	65
Pjesa G: Menaxhimi Ambjental.....	65
1. Përshkrimi.....	65
2. Rivendosja (ribimësia).....	65
3. Nivelet e zhurmave.....	66
4. Rrugët e aksesit.....	66
5. Rrugët hyrëse në prona.....	66
6. Pemët për tu prerë.....	66
7. Takimet me publikun.....	66
Pjesa H: Punimet me dhëra.....	67
1. Përshkrimi.....	67
2. Klasifikimet.....	67
3. Hedhja e materialit të tepërt e të papërshtatshëm.....	68
4. Materialet për skarpatë.....	68
5. Ndertimi i argjinatures.....	69
6. Mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve.....	69
7. Dhënja e formës perfundimtare dhe kompaktësimi.....	69
8. Gjeotekstilet.....	69
9. Punimet pranë trotuarit.....	70
10. Skarifikimi i sipërfaqes ekzistuese.....	70
Pjesa I: Gërmimi i strukturave dhe mbushja.....	70
1. Përshkrimi.....	70
2. Gërmimi për shmangjen e lumit.....	71
3. Materiali gjeotekstil për strukturat.....	72
Pjesa J: Nën baza granulare.....	74
1. Përshkrimi.....	74
2. Materialet.....	74
Pjesa K: Shtresa e parë dhe veshja me bitum.....	75
1. Përshkrimi.....	75
2. Pajisjet.....	76
3. Aplikimi.....	77
KËRKESAT PËR SHITRESAT SIPËRFAQËSORE.....	81

REHABILITIMI I BANKINAVE.....	84
Pjesa L: Veshja sipërfaqësore.....	84
1. <i>Korrigjimi i bazës.....</i>	84
2. <i>Pastrimi i sipërfaqes.....</i>	84
3. <i>Vendosja e shtresës ngjitëse ose sperkatjes me emulsion.....</i>	84
4. <i>Mbushja e gropave me asfaltobeton</i>	84
5. <i>Impjantet dhe makineritë.....</i>	86
6. <i>Kufizime dhe kërkesa të përgjithëshme.....</i>	89
7. <i>Lidhjet.....</i>	91
8. <i>Ngjeshja.....</i>	91
9. <i>Karakteristikat, specifikime dhe punimet per shtresat.....</i>	94
10. <i>Riparimi i plasaritjeve.....</i>	97
Pjesa M : Kanalet e betonit për drenazhet dhe drenazhet e nëndherave. 99	99
1. <i>Përshkrimi.....</i>	99
2. <i>Programimi i punimeve.....</i>	99
3. <i>Përputhshmeria me tolerancat.....</i>	99
4. <i>Materialet.....</i>	99
5. <i>Instalimi.....</i>	100
6. <i>Drenazhet e nëndherave.....</i>	100
7. <i>Pastrimi i tombinove.....</i>	100
8. <i>Miratimi i punimeve.....</i>	101
Pjesa N: Pastrimi dhe forma e drenazhimeve ekzistuese.....	102
1. <i>Pastrimi</i>	102
2. <i>Kullimet e hapura.....</i>	102
3. <i>Kunetat e betonit.....</i>	103
4. <i>Metodat e ndertimit.....</i>	103
Pjesa P: Barriera me shufra çeliku.....	104
Pjesa T: Shenjat e trafikut	105
1. <i>Përshkrimi.....</i>	106
2. <i>Detajet e sinjalistikës.....</i>	107
3. <i>Pastrimi.....</i>	107
4. <i>Pozicionimi standart.....</i>	108
5. <i>Dukshmeria e sinjaleve.....</i>	108
6. <i>Vendoasja e sinjaleve.....</i>	108
7. <i>Vijezimi i referimit.....</i>	109
Pjesa Y : Vijëzimi rrugor	110
1. <i>Përshkrimi.....</i>	110
2. <i>Materialet.....</i>	110
3. <i>Provat.....</i>	111
4. <i>Makineria.....</i>	111
5. <i>Detajet.....</i>	112
6. <i>Mbrojtja.....</i>	113
7. <i>Llojet dhe pozicionet.....</i>	114
8. <i>Vijezimi per asfaltet.....</i>	115

Pjesa Q: Betonimet për struktura &Përdorime të tjera.....	118
1. <i>Pershkrimi.....</i>	<i>118</i>
2. <i>Perkufizime.....</i>	<i>118</i>
3. <i>Materialet për beton.....</i>	<i>118</i>
4. <i>Provat për perzjeresit.....</i>	<i>120</i>
5. <i>Kontrolli i cilesisë së betonit.....</i>	<i>121</i>
Pjesa Y: Punimet me llaç për strukturat	
1. <i>Qellimi.....</i>	<i>122</i>
2. <i>Materialet.....</i>	<i>122</i>
Pjesa Z : Tombinot e tubat e parafabrikuara ne beton.....	124
1. <i>Pershkrimi.....</i>	<i>124</i>
2. <i>Materialet.....</i>	<i>124</i>
3. <i>Instalimi.....</i>	<i>124</i>
Pjesa U: Siperfaqja e urave.....	125
1. <i>Pershkrimi.....</i>	<i>125</i>
2. <i>Trashësia e shtrimit.....</i>	<i>125</i>
MIRËMBAJTJA DIMËRORE	126
1. <i>Hyrje.....</i>	<i>128</i>
2. <i>Perkufizimet.....</i>	<i>128</i>
3. <i>Përparësite e shërbimeve.....</i>	<i>128</i>
4. <i>Materialet kunder ngricës.....</i>	<i>129</i>
5. <i>Depozitimi i materialeve.....</i>	<i>131</i>
6. <i>Pajisjet për mirëmbajtjen dimërore.....</i>	<i>131</i>
7. <i>Kryerja e shërbimeve për mirëmbajtje dimërore.....</i>	<i>132</i>
8. <i>Informacion për shërbimet dimërore ne Shqipëri.....</i>	<i>137</i>
9. <i>Ditë pune</i>	<i>138</i>
10. <i>Kamionet.....</i>	<i>138</i>
MIREMBAJTJA DHE RIPARIMI I RRUGEVE TE PASHTRUARA/ME ZHAVORR.....	145
SKEMAT E SINJALISTIKËS SË PERKOHËSHME.....	147

HYRJE

Qëllimi kryesor i përgatitjes së këtyre specifikimeve është:

Rritja e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mirë bashkëkohorë për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim, dhe për të patur qëndrueshmëri të investimeve.

OBJEKTIVAT:

1. Përmirësimi i kushteve të lëvizjes për të gjithë përdoruesit e rrugës, duke përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuar.
2. Rritjen e jetëgjatësisë së rrugëve.
3. Uljen e shpenzimeve për kryerje të investimeve të mëdha nëpërmjet mirëmbajtjes së pandërprerë me bazë performancë.
4. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin e kompanive për mënyrat e mirëmbajtjes, larg metodave të mëparshme tradicionale.
5. Vendosjen e penalteteve ndaj kompanive që nuk zbatojnë kushtet e kontratës.
6. Përmirësimi i metodave dhe mënyrat e inspektimeve për mbajtjen e rrugëve nën kontroll për 24 orë.

I.PJESA A1.

Konceptet themelore të kontratave të mirëmbajtjes me bazë Performancë

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor përfshin detyrat e mirëmbajtjes **rutinë** dhe **periodike**. Mirëmbajtja rutinë konsiston në detyra që janë të nevojshme për të mirëmbajtur funksionimin e rrugës (siç janë riparimet e gropave, pastrimi i drenazhimeve, vulosja e plasaritjeve, prerja e shkurreve, etj.). Mirëmbajtja periodike konsiston në masa me të kushtueshme të një natyre me pak të përdorshme në menyrë që të parandalohet degradimi i rrugeve (sic është nivelimi, drenazhimet, rimbushjet, mbishtresat me asfalto - beton, etj.). Tepër të rëndësishme janë menaxhimi i kujdesshëm, afatet e ndërhyrjeve dhe saktësia e zgjidhjeve teknike.

Kushtet minimale rrugore dhe Nivelet e Shërbimit janë përcaktuar gjatë procesit të matjeve të rrugës dhe Performancës.

Keto kontrata jane nje model i ri kontratash i bazuar ne efektivitet.

Kontratat e bazuara ne efektivitet paraqesin nje tip me te avancuar kontraktimi kryesisht per perdorim ne kontraktime mirembajtjeje dhe ne kontrata tip BOT dhe bazohen ne cka kerkojne ne fund perdoruesit, qe d.m.th. nivele standarte te caktuara fillimisht me pagesa te bazuara ne shuma vjetore apo mujore ne total te plotesojne keto standarte.

Pra, keto kontrata ndryshojne nga kontratat e zakonshme , bazohen ne performance, ne arritjen e niveleve dhe standarteve te caktuara dhe bazohen ne pagesa mujore per plotesimin e standarteve. Zerat e ketyre punimeve nuk jane me mase njesi me sasi punimesh te vleresuara te bazuara ne nje projekt dhe ne nje cmim njesi por jane pagesa mujore te bazuara ne arritjen e nje standarti.

Kriteri i Performancës duhet domosdoshmërisht të mbulojë gjithë aspektet e kontratës dhe të marrë parasysh faktin që në zona të ndryshme brënda kontratës të kërkohen nivele shërbimi të ndryshme. Kriteri mund të përcaktohet me anë të tre niveleve,(niveli i katert aplikohet për rrugët e pashtuara) megjithatë kontratat më të thjeshta nuk do përdorin të gjitha kriterin e identifikuar me poshtë:

Matjet për Shërbimin dhe Konfortin e Përdoruesit Rrugor, që mund të shprehen shkurtimisht si:

Ashpërsia rrugorë

Gjerësia e korsise dhe e rrugës

Gjurma e gomave të makinave

Rezistenca e fërkimit

Kontrolli i bimësise

Qartësia e sinjalistikës rrugore dhe vijëzimi

Disponibiliteti i çdo korsie – km për trafikun

Disponibilitet i menjëhershëm për riparimin e defekteve që lidhet me sigurinë e përdoruesve të rrugës

Prania e aksidenteve rrugorë

Drenazhim gjatë gjithë rrugës (ujërat në rrugë janë të rrezikshëm për përdoruesit e rrugës)

Masat për Jetëgjatësinë e Rrugës, që shkurtimisht shprehen si:

Profili gjatësor i rrugës

Fortësia e asfaltit

Sasia e riparimeve të lejueshme përpara se të kryhet trajtim i mirëfilltë periodik për mirëmbajtjen

Niveli i shkallës sedimentare në shërbimet e drenazhimit

Masat për Performancën Menaxhuese, që përcaktojnë informacionin që kërkon Punëdhënësi si për të drejtuar asetet gjatë kohëzgjatjes së kontratës, dhe të ndërmjetësorë në fazën pasuese të tenderit. Kërkesat duhet të përfshijnë:

-Shpërndarjen e raporteve të ecurisë së zakonshme për Autoritetin Kontrollues Rrugor

-Rifreskimet e inventarëve dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me kërkesat

-Historiku i Mirëmbajtjes (në këtë mënyrë tenderuesi pasardhës vlerëson punimet).

Se bashku me masat e performancës përcaktohen **Nivelet e Shërbimit** minimal të pranueshëm për rrugë të veçanta. Në përcaktimin e Kriterit për masat e ndryshme (si ato teknike dhe praktike) nevojitet që të merren parasysh në konsideratë, si (i) volumi i trafikut dhe përbërja e tij, (ii) rrugët rurale dhe urbane, (iii) terrenet e sheshta, kodrinorë apo malore, (iv) cilësia dhe lloji i nënshtrësës, (v) cilësia e materialeve të disponueshme për ndërtim, (vi) kapaciteti i kontraktorëve të disponueshëm, (vii) çdo pengese ambientale, siç janë zonat e mbrojtura, parqet, rezervat pyjore, etj.

Megjithatë, mbetet kriter tepër i rëndësishëm çështja se çfarë Niveli Shërbimi do përzgjidhet dhe justifikohet ekonomikisht për rrugën në fjalë.

Shërbimit që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasisë të punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.

Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë

4. Ndhurma e pare në rast aksidenti
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindertim pas aksidenteve rrugorë
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrorë
9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës
10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :
 - shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise(gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
 - riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
 - kujdesi për bimesinë
 - aktiviteti në dimer për largimin e deborës dhe akullit

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin.
4. Pastrimi i deborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes se rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

Nëse objekt i kontratës është mirëmbajtja e rrugëve, por pa mirëmbajtjen dimërore (pasi është zonë që nuk preket nga kjo mirëmbajtje), kontraktori është i detyruar të sigurojë shërbimin, pasi si shkak i ndryshimit të kushteve meteorologjike, mund të ketë fenomene të rralla, të veçuara, të ngricave në rrugë dhe rreshjeve të borës. Kontraktori duhet te kryeje punime per pastrimin e debores me makineri, per shperndarjen e kripes e materialeve te tjera me qellim parandalimin e formimit te ngricave dhe shtresave te akullit.

Rregulla te pergjithshme dhe pagesat :

Kontraktori do paguhet cdo muaj ne perputhje me Certifikaten Mujore te Pagesave (Akt-Kontrolli Mujor) qe firmoset nga Kontraktori dhe vertetohet nga Manexheri i Projektit (Mbikqyresi i sherbimeve). Certifikata do perfshije nje sigurim nga Kontraktori qe ai ka qene ne pajtim me nivelet e sherbimit dhe cilesine e punimeve te specifikuar sipas Kontrates. Pagesa do bazohet ne sasite dhe cmimet njesi ne Preventiv. Kerkesat per pagesa do shoqerohen nga dokumentacion mbeshtetes plotesues.

Cmimet e specifikuara ne Preventiv gjithashtu do mbulojne kostot e punimeve te pergjitheshme dhe lehtesirat ne perputhje me Dokumentat e Kontrates, dhe te cilat nuk jane specifikisht te paraqitura ne Preventiv.

Pagesa perfshin verifikime dhe raportime, per te gjitha pagesat, te gjitha provat, sic specifikohet ne Dokumentet e Kontrates.

Nese nuk eshte thene ndryshe, puna do matet dhe shperblehet me njesite e specifikuara ne preventiv.

Nese niveli i cilesise se sherbimit apo cilesia e punimit te specifikuar nuk arrihet, pagesat pakesohen.

Menaxheri i Projektit (Mbikqyresi i sherbimeve) mund edhe te zbrese sasite dhe shumat qe lidhen me punen, qe sipas opinionit te tij, nuk eshte kryer me profesionalizem dhe duhet ribere. Ky vendim do regjistrohet ne Raportin e Perbashket Verifikues bashke me nje motivim te hollesishem.

Pagesat me baze efektivitetin (Lista nr. 2 dhe nr. 4)

Pagesat me baze efektivitetin jane te pa rregullueshme dhe i referohen shperblimeve mujore. Pagesat mujore me baze efektivitetin nuk mund te perdoren per zera te tjera te preventivit. Penalitetet e vendosura ne zerat me baze efektivitetin nuk mund te perdoren per zera te tjera te preventivit.

Pagesa do mbuloje te gjitha kostot per pune funksion te arritur plotesisht ose punim te perfunduar ne kuptimin e plote te Dokumentave te Kontrates. Zeri i pageses do perfshije te gjitha kostot per burimet dhe operacionet e kerkuara qe nevojiten per te mbajtur vetite funksionale dhe duke mbajtur ne mend te gjitha pengesat/kufizimet ne punime sipas Dokumenteve te Kontrates.

Per rrjedhoje, ato do perfshijne te gjitha kostot per mbikqyrje, administrime dhe interesa te tjera, si edhe pagen e Kontraktorit.

Pagesat me cmime njesi (Lista nr.3)

Pagesat ne cmime njesi jane pagesat per punime periodike te rregullueshme bazuar ne sasite aktuale te kryera.

Rregullat ne vijim per Matjet dhe Shperblimet do perdoren per punimet e rregullueshme nese nuk bihet dakord ndryshe:

- Punedhenesi ruan te drejten te beje rivendosje midis zerave te ndryshem te pageses. Gjate zbatimit te kontrates mundt te behen ndryshime ne zerat e preventivit qe jane me volume te matshme dhe cmime njesi por pa kaluar vleren e kontrates.
- Kontraktori do sipermarre te kryeje punime qe korrespondojne zerave te pageses te specifikuar ne Preventiv.
- Pagesa do te paguhet ne perputhje me cmimi njesi te specifikuar ne Preventiv per njesine qe eshte specifikuar, dhe sipas sasise aktuale, nese nuk eshte shenuar ndryshe per zerin e pageses ne Specifikimet.
- Cmimet ne Preventiv do mbulojne te gjitha kostot per funksionet e specifikuara plotesisht te arritura ose punime te perfunduara ne kuptimin e plote te Dokumentave te Kontrates. Zeri i caktuar i pagese do perfshije te gjitha kostot per burimet dhe operacionet e kerkuara per masat e specifikuara me qellim mbajtjen e vetive funksionale dhe duke mbajtur ne mend te gjitha pengesat/kufizimet ne punime sipas Dokumenteve te Kontrates.
- Gjithashtu, duhet menduar per tu perfshire ne cmimin njesi, kostot e punimeve dhe sipermarrjeve ne perputhje me kete Kontrate, qe nuk jane te permendura posacerisht ne Specifikimet por qe kerkohen per te arrire funksionin ose zgjidhjen teknike te kerkuar.
- Verifikimi i cilesise dhe sasise te punimeve te kryera do kryhet menjehere me plotesimin e punimeve. Verifikimet do mbyllen ne Certifikatat Mujore (Akt-Kontrolli Mujor) te pageses.

Dokumentacioni shoqerues per kryerjen e pagesave :

Kontraktori do te paguhet cdo muaj (pasi te kete perfunduar muaji). Pagesa do bazohet ne sasite dhe cmimet njesi ne Preventivin Fitues te Kontraktorit. Pagesa do te kryhet pasi te jete realizuar inspektimi i perbashket mujor nga Kontraktori e Menaxheri i Projektit (Mbikeqyresi i Sherbimeve) dhe te jete hartuar Raporti Mujor Verifikues i Perbashket (Akt-kontrolli mujor). Dokumentacioni per kryerjen e pagesave mujore duhet te permbaje :

1. Situacioni mujor pjesor
2. Situacioni progresiv.
3. Lista e penaliteteve.
4. Raporti Mujor Verifikues i Perbashket (Akt-kontrolli mujor).
5. Grafiku mujor i sherbimeve.
6. Libreza e masave.
7. Ditari i objektit.
8. Ne raste te vecanta kur eshte e nevojshme do te paraqiten proces - verbale, inspektime formale, inspektime informale, informacione, instruktazhe teknike, shkresa zyrtare etj.

2. PJESA A2. Përshkrim i Shërbimeve që do kryhen

Pamvarësisht llojit, menyrës, zërit të punimeve në hartimin e preventivave të mirëmbajtjes me performancë, këto specifikime do të aplikohen në të gjithë segmentet rrugorë.

2.1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me cdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ata përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zerrat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugorë
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i deborës

2.1.2. Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Jep përshkrimin e vendodhjes së rrugës, gjatësia, gjërësia, kushtet aktuale të saj, kushtet klimaterike të zonës, shtrirjen e saj, nevoja për rehabilitim ose jo, duke u shoqëruar edhe me një hartë pjesore të rrugës e cila do të nënshtrohet mirëmbajtjes.

2.2 Punimet e Rehabilitimit/periodike për tu kryer

Punimet totale të rehabilitimit për tu kryer nuk duhet të kushtojnë me shumë se **40% të vlerës totale të kontratës.**

2.2.1 Si shprehen punimet e rehabilitimit /periodike

Punimet e rehabilitimit/periodike janë punime të cilat do të shtrihen gjatë gjithë periudhës dyvjecare të zbatimit të kontratës. Këto punime do të përdoren sipas nevojave që do të kenë aksent rrugorë gjatë periudhës dyvjecare të zbatimit të kontratës. Këto vëllime punimesh nuk kanë vendndodhje konkrete, por gjatë 2 vjetëve të zbatimit të kontratës do të përdoren në rast nevojë aty ku do të kemi demtime elementesh strukturore, demtime amortizime të sinjalistikes, nevoja të ndryshme emergjente etj.. Punimet e

rehabilitimit/periodike jane punime te zevendesueshme pra mund te kete ndryshime tek zerat e preventivit te mirembajtjes periodike (Lista nr.3). Ato mund te shtohen, te pakesohen, ndonje volum mund te mos perdoret ne qofte se nuk do jete e nevojshme.

Është kompetencë e mbikqyrësit të punimeve ndryshimi i volumeve te preventivit te mirembajtjes periodike (Lista nr.3). Keto ndryshime miratohen edhe nga Autoriteti Kontraktor.

Keto punime zënë maksimalisht 40% te vleres totale te kontrates.

2.2.2 Kriteret e Dizenjimit per Punimet e Rehabilitimit/Periodike

Te gjithë Punimet e Rehabilitimit/Periodike do të jenë të dizenuara për të permbushur kërkesat e plota të Standardeve të reja të Dizenjimit dhe Ndertimit te Rrugeve Shqiptare te cilat jane aktualisht duke u finalizuar.

2.2.3. Lista e dokumentave që lidhen me aprovimin e punimeve të rehabilitimit/periodike

- Skicat e plota për punimet e rehabilitimit sipas Standartit Shqiptar të projektimit të rrugëve, me vendodhjet e sakta të shprehura në kilometra, të shoqëruara me foto e pamje filmike për gjendjen ekzistuese të segmenteve rrugorë.

- Grafikon e punimeve

2.2.4 Përshkrimi i Punimeve të Rehabilitimit /Periodike

Kontraktori do të duhet te kryeje sasinë minimale të punimeve të rehabilitimit/periodike të treguara në preventivin për keto lloj punimesh.

Këto punime i referohen të gjithë komponentëve të rrugës (drenazheve, punimeve të dheut, strukturave, shtresave asfaltike, elementëve të sinjalistikës, pajisjeve të sigurisë, vegjetacionit, etj.) Punimet e Rehabilitimit/Periodike kryhen mbi bazën e skicave “as built”, vizatimeve dhe preventivave të hartuar nga Kontraktorët (me çmimet e manualeve që janë në fuqi ne qofte se do te kete nevojë per zera te rinj ne preventiv).

Punimet e rehabilitimit/periodike janë punime që parashikohen të kryhen me qëllim rinovimin e elementëve të ndryshëm të rrugës, pajisjeve rrugore si dhe rivendosjen dhe përmirësimin e cilësisë fillestare, të njëjtë, kur ato janë të rrezikuara ose të dëmtuara seriozisht dhe përfshijnë punimet e mëposhtme :

- rinovimi i sipërfaqes së pjesës kaluese/karrexhatës
- përmirësimi i sistemit të kullimit;
- riparimin e urave, nëse sistemi strukturor dhe materialet nuk kanë ndryshuar;
- zëvendësimi i sinjalizimit dhe pajisjeve rrugore;
- gjeometrinë e një rruge duke zgjeruar ose riorganizuar atë;

Nëse trafiku në rrugë ndërpritet, si rrjedhojë e kryerjes së një punimi rehabilitimi, atëherë Kontraktori do të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme, si :

- Të rihapë trafikun sa më shpejt të jetë e mundur
- Të mirëmbajë rrugën e hapur gjatë punimeve të rehabilitimit

2.2.5 Cilësia e materialeve që do të përdoren

Materialet që duhen përdorur nga Kontraktori do të pajtohen me kriteret e cilësisë sic janë përshkruar në **Rregullin Teknik të Projektimit dhe Ndertimit të Rrugeve. Kontraktori është i detyruar të kryejë testet laboratorike të nevojshme për të përcaktuar cilësinë e materialeve. Pajtueshmëria / mospajtueshmëria e Kontraktorit me kërkesat e nivelit të shërbimit do të raportohet nga Stafi i tij**

2.3 Funkcionet e Personelit Kyc

Përsonele kyc dhe funksionet e tyre do të jenë në përputhje me të dhënat e kualifikimit dhe me propozimet teknike të kërkuara.

2.4 Puna paraprake para fillimit të punimeve

a. Kontraktori është i detyruar që në zbatim të Ligjit për disiplinimin e punimeve të ndërtimit, përpara fillimit të punimeve të vendosë tabelën emertuese me të dhënat : emrin e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, emërtimin e kontraktorit, emërtimin e mbikqyrësit e tjerë.

a/1 Kontraktori do të vendosë sinjale paralajmëruese (shenja të trafikut dhe sinjalizime të tjera të nevojshme) për përdoruesit e rrugës, për të evituar cdo aksident të mundshëm. Sinjalizimi dhe barrierat mbrojtëse duhet të miratohen nga Mbikqyrësi.

b. Në vendet e banuara Kontraktori duhet të vendosë tabela për informim përpara fillimit të punimeve duke dhënë informime të nevojshme sic kërkohet nga Projekt Menaxheri.

c. Kontraktori duhet të vendosë shenja paralajmëruese para fillimit të punimeve për të lajmëruar drejtuesit e mjeteve me qëllim zvoglimin e shpejtësisë dhe pranë qëndrave të banuara të tregojnë rrugën alternative për këmbësorët.

d. Kontraktori do të sigurojë shenja të qarta në rast ndryshimesh të korsisë së rrugës për qarkullimin e automjeteve dhe persona që drejtojnë trafikun në rast bllokimi, përveç tabelave sinjalizuese të përkohëshme.

2.5 Rregullat e Kriteve të Cilësisë së Shërbimit

Për qëllimet e kësaj kontrate, nivele shërbimi të ndryshme janë të kërkuara për rrugë apo seksione të ndryshme rrugësh. Për rrugët e rrjetit kombëtar do të zbatohen Nivelet e mëposhtme të shërbimit :

Shumë Mirë

Mirë

Mesatare

Minimum(përdoret për rrugët e pashtuara)

Përkufizimet që shpjegojnë ndryshimet midis këtyre niveleve të shërbimit janë dhënë në seksionet e mëposhtme të këtij materiali.

3. Metodat e Inspektimit të Niveleve të Shërbimit

3.1. Inspektimet Formale të Niveleve të Shërbimit

Kontraktori do vendose, brenda strukturese se tij organizative, nje **Njesi Vete-Kontrolli** te vacante te plotesuar me personel te kualifikuar, detyra e te cilit eshte te monitoroje dhe mbeshtese verifikimin e shkalles se perputhjes me Nivelet e Cilesise se Sherbimit. Njesi e Vete-Kontrollit gjithashtu do kryeje ose organizoje prova dhe matje; pergatise, paraqese dhe dorezoje tek Manexheri i Rruges gjithe informacionin me qellim krijimin e dokumentacionit te percaktuar ne Specifikimet dhe manexhimin dhe mirembajtjen efektive te rrugeve. Njesia e vete-kontrollit do kryeje gjithashtu ose monitoroje, ne bashkepunim te ngushte me Manexherin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilesise se Sherbimit.

Inspektimet formale janë ato të planifikuara në avance nga Mbikqyrësi, dhe të kryera nga Kontraktori nën mbikqyrjen e Mbikqyresit të Punimeve. Qëllimi kryesor i inspektimeve formale është ti mundësojë Mbikqyresit të Punimeve të verifikojë informacionin e prezantuar në deklaratën mujorë të kontraktorit. Mbikqyrësi duhet të informojë Kontraktorin për qëllimin e tij për të kryer një inspektim formal se paku 48 orë përpara, duke treguar datën ekzakte, orën dhe vendin ku duhet të filloje inspektimi formal. Kontraktori është i detyruar të jetë prezent në datën, orën dhe vendin e caktuar nga Mbikqyrësi, duke paraqitur mjetet fizike të nevojshme. Inspektimet formale lejojnë krahasimin e informacionit në lidhje me pajtueshmërinë e ofruar në tabelat e standartit të cilat janë pjese e Deklaratës se tij Mujore, me masa aktuale të marra në vende që duhet të përcaktohen nga Mbikqyrësi .

Gjatë inspektimeve formale, Mbikqyrësi do të përgatise një material të shkurtër duke përshkruar rrethanat e përgjithshme të vizitës në vendin e punimeve, duke përfshirë datën, seksionet e vizituara të rrugës, personat prezent, etj., çdo mospajtueshmëri e cila mund të jetë hetuar, dhe kohën e dhënë nga Mbikqyrësi për kontraktorin për të rregulluar defektet e hetuara. Inspektimet formale do të planifikohen gjithashtu për vizita në vazhdimësi të vendit të punimeve, qëllimi i të cilave është të verifikojnë nëse kontraktori ka rregulluar shkaqet e mos-pajtueshmërisë së mëparshme, brenda kornizës kohore të dhënë nga Mbikqyrësi dhe e specifikuar në material. Dështimi për të korrigjuar mos-pajtueshmërinë brenda kornizës kohore të specifikuar do të çojë në ulje të mëtëjshme të shumës për pagese.

3.2. Inspektimet Informale të Niveleve të Shërbimeve

Mbikqyrësi do të kryejë inspektime informale të Niveleve të Shërbimit si pjese e mandatit të tij të përgjithshëm që i është dhënë nga Punëdhënësi. Ai mund ta bëjë një gjë të tillë me inisiativën e tij, në cdo kohë dhe kudo në rrugët e përfshira në kontratë. Ai duhet të përdorë mjetet e tij për këto inspektime. Nëse ai zbulon ndonjë seksion rrugor ku kriteret e Nivelit të Shërbimit nuk janë përmbushur, ai është i detyruar të informojë Kontraktorin brenda 24 orëve me shkrim, me qëllim për ti mundësuar kontraktorit të marrë masa rregulluese sa me shpejt të jetë e mundur. Detyrimi i Mbikqyresit të Punimeve për të njoftuar Kontraktorin për

ndonjë mos-pajtueshmeri të identifikuar në asnjë mënyrë nuk pakëson kërkesen që Kontraktori të monitorojë në vazhdimësi kushtet e rrugës dhe të korrigjojë të gjitha defektet brënda kufijve kohore të specifikuar në kontratë dhe duhet të vërehet që periudha e specifikuar për Kontraktorin për të korrigjuar defektet fillon nga ndodhja apo zbulimi i defektit dhe jo nga ndonjë njoftim i një defekti nga Mbikqyrësi. Aty ku inspektime informale identifikojnë defekte të cilat Kontraktori ka dështuar t'i korrigjojë brënda kufijve kohore të specifikuar, defekte të tillë të identifikuar mund të përdoren nga Mbikqyrësi për qëllime të korrigjimit të deklaratave mujorë të kontraktorit apo zbatimin e denimeve apo dëmeve të likuiduara. Aty ku Mbikqyrësi ka identifikuar defekte në kursin e një inspektimi informal ai do të kryejë një inspektim të mëtejshëm për të siguruar nëse defekti është korrigjuar brënda kufirit kohor të përshkruar. Ai ose mund ta bëjë këtë një Inspektim Formal të plotë ose thjesht mund të kërkojë një përfaqësues të Kontraktorit ta shoqërojë atë për të verifikuar situatën. Në këto rrethana, nëse Kontraktori dështon në dergimin e një përfaqësuesi, pasi i është kërkuar ta bëjë një gjë të tillë atëhere këmbëngulja e Mbikqyrësi i Punimeve për natyrën e korrigjimit do të jetë finale dhe detyruese pa mundësi apelimi apo kundërshtimi.

3.3. Paraqitja e Informacionit të Menaxhimit të Rrugës

Kriteret e mëposhtëm të Nivelit të Shërbimit do të zbatohen për të gjithë seksionet rrugorë të kërkuar për menaxhimin e vazhdueshëm të kontratës.

3.3.1. Deklarata Mujore

Pajtueshmëria apo mospajtueshmëria e Kontraktorit do të raportohet tek Mbikqyrësi në formën e tabelave për të cilat një format standarti i detyrueshëm është miratuar. Ka një tabelë për secilën rrugë apo seksion rrugor. Tabelat janë pjese e deklaratës mujorë të Kontraktorit, dhe ato mund të plotësohen me komentë për të cilat një format specifik nuk kërkohet.

4. Programi i Punimeve

Kontraktori do të paraqesë një Program Performance brënda njezet e tëtë (28) ditëve pas firmosjes së marrëveshjes së kontratës. Programi do të përfshijë:

4.1. Planin e Kontraktorit për Sigurimin e Cilësisë

Plani i Kontraktorit për Sigurimin e Cilësisë përshkruan metodat dhe procedurat të cilat Kontraktori do të zbatojë për ekzekutimin e Kontratës, duke përfshirë se si do të:

- identifikojë kërkesat e cilësisë specifike të kontratës,
- planifikojë dhe ekzekutojë punën për të plotësuar këto kërkesa
- të inspektojë dhe/ose të testojë punën për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e cilësisë
- të regjistrojë dhe monitorojë rezultatet si provë e pajtueshmërisë, dhe
- të sigurojë që veprimi i menjëhershëm merret për të korrigjuar mospajtueshmërinë.

Plani i Kontraktorit për Sigurimin e Cilësisë duhet të përshkruajë qartë sistemet, procedurat dhe metodat që do të përdoren për të kryer dhe monitoruar pajtueshmërinë e Shërbimeve.

4.2 Planet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë

Programi i Performancës do të përfshijë një Plan të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë.

Qëllimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë është të nxisë një sjellje të përgjegjshme drejt shëndetit dhe sigurisë në punë dhe për tu pajtuar me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë.

Për shkak të natyrës së shërbimeve, Kontraktori mundet, me raste, të jetë i ekspozuar ndaj situatave shqetësuese të cilat mund të përfshijnë rrezikun e shkallëve të ndryshme, tek stafi kontraktues dhe/ose publiku.

Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë duhet të jetë në pajtueshmëri me personelin e Kontraktorit dhe të gjithë nënkontraktoret në çdo kohë.

Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë, ku implementohet në përputhje me kërkesat e planit, do të:

- Sigurojë identifikim sistematik të rreziqeve ekzistuese dhe të reja në vendin/vendet e punimeve
- Sigurojë minimizimin e rreziqeve domethënëse, aty ku eliminimi dhe izolimi janë të dy jopraktikë
- Sigurojë ofrimin dhe përdorimin e masave të përshtatshme mbrojtëse
- Përfshijë procedura emergjence të derdhjeve aksidentale, ndotje apo rrezik të pashmangshëm
- Sigurojë vlerësim dhe rishikim të rregullt për çdo rrezik të identifikuar dhe të monitorojë ekspozimin e punonjësve ndaj këtyre rreziqeve.
- Sigurojë raportimin dhe rregjistrimin e incidenteve të sigurisë në vendin e punës në mënyrë të tillë që problemet e sigurisë mund të adresohen shpejt dhe rregullisht. Është një kërkesë e kësaj Kontrate që çdo incident i tillë të këshillohet menjëherë tek Mbikqyrësi.

Koha e Dorëzimit për Programin e Sigurisë dhe Shëndetit do të jetë jo më vonë se 45 ditë pas Datës së Fillimit.

4.3. Procedurat e Emergjencës

Programi i Performancës do të përfshijë një Plan të Procedurave të emergjencës i cili do të ndërtojë rolet, praktikat dhe procedurat gjatë tipeve specifike të ngjarjeve të emergjencës të identifikuara në planet e lidhura me mbylljen e rrugëve. Qëllimi i Procedurave të Emergjencës është të garantojë sigurinë e personelit të kontraktuesit dhe përdoruesve të rrugës në raste emergjence dhe/ose mbyllje rruge. Ai duhet të përfshijë:

- një komunikim efektiv dhe sistem rregjistrimi ngjarjesh
- emrin, numrin e kontaktit dhe detyra specifike të Personelit të kontraktorit të emëruar për tu përgjigjur për një rast emergjence
- numrin e kontaktit të paleve të tjera të cilat duhet të njoftohen në rast të ngjarjeve të emergjencës, p.sh policia
- procedura të detajuara përgjigjëje/ reagimi për të gjitha ngjarjet emergjencës

- rrugë të mundshme të tërthorta në rast të mbylljes së rrugëve

4.4. Plani i Menaxhimit të Trafikut

Programi i Performancës do të përfshijë një Plan të Menaxhimit të Trafikut. Plani i Menaxhimit të Trafikut vendos praktikat për menaxhimin e trafikut në vendet e punimeve. **Plani i Menaxhimit të Trafikut duhet të përgatitet nga Kontraktori dhe duhet të dakortësohet me Mbikqyrsin e Punimeve.**

Objektivat e Planit të Menaxhimit të Trafikut janë të:

- të përcaktojë qartë dhe dokumentojë përgjegjësitë dhe zinxhirin e komandës për zhvillimin, implementimin dhe menaxhimin e masave dhe sistemeve të kontrollit të trafikut
- të vendose kërkesat minimale për kontroll trafiku të përkohshëm
- të vendose standartet minimale gjeometrike, nder-seksionale dhe të sipërfaqes për punimet e përkohshme
- të ofrojë tranzicione të përshtatshme dhe të mundësojë rrjedhje të trafikut të sigurtë dhe eficient , përmes dhe jashtë vendeve të punimeve
- të mbrojë personelin në çdo kohë
- të mbrojë asetet dhe burimet e kontraktorit në çdo kohë
- të përmbushë kërkesat operacionale të rrugës.

Plani i Menaxhimit të Trafikut duhet të përfshijë si më poshtë :

- Një proces të dokumentuar për përgatitje, rishikim dhe miratim të Planit të Menaxhimit të Trafikut
- Diagramat e ekspozimit, deklaratat e metodës etj. për implementimin e kontrollit të trafikut ndërkohë që kuptohet çdo aspekt i Shërbimeve (duke përfshirë diagramat specifike të ekspozimit të vendit të punimeve dhe deklaratimet e metodave nëse shërbimet kërkojnë masa të kontrollit të trafikut që nuk janë të mbuluara nga kodet standarte të praktikës.)

4.5 Raporti i Dorëzimit

Menjeherë para përfundimit të kontratës Kontraktori do të përgatise një **Raport Dorëzimi**. Qëllimi i Raportit të Dorëzimit është të paraqese një tranzicion të lehtë tek kontrata tjetër dhe të sigurojë që kontraktori tjetër është i ndërgjegjshëm për ndonjë çështje të diskutueshme.

Raporti do të:

- Përmbledhë ndonjë çështje të pazgjidhur;
- Paraqese detajet e meposhtëme:
- Një plan defektesh dhe detyrimesh të diskutueshme
- Detaje të ndonjë çështjeje të pazgjidhur,

- Detaje të ndonjë ceshtjeje të ndjeshme
- Detaje të ndonjë nevoje të vazhdueshme të veçantë monitoruese/mirëmbajtjeje.
- Inventarin e plote per segmentet rrugore te kontrates

5. Kritere të Nivelit të Shërbimit për Rrugët e Shtruara

Ky seksion specifikon Nivelet e Shërbimit për tu pajtuar në rast të rrugëve të shtruara. Ka tre kritere në tërësi:

- Përdorimi i Rrugës
- Sherbimi i Përdorimit të Rrugës dhe Masat e Komfortit
- Masat e Performances se qëndrueshmërisë

5.1. Përdorimi i Rrugës, Sherbimi i Përdoruesit të Rrugës, dhe Masat e Komfortit për Rrugët e Shtruara

Kontraktori do të duhet të sigurojë që rruga është e hapur për trafikun dhe e lirë nga ndërprerjet në cdo kohë.

Përfundimet e Lejuara janë: pak orë mbylljeje pas aksidenteve rrugore serioze ose rreshqitjeve të shpateve apo trupit të rruges, rrenies së pemeve etj. Kriteri i nivelit të Shërbimit për shërbimin e përdoruesit të rrugës dhe komfortit në rrugë të shtruara janë të përcaktuara me poshtë në Lidhjen A.

6.Masat e Qëndrueshmërisë për rrugët e shtruara

6.1 Ashpërsia e Rrugës

Kontraktori duhet të ketë pajisje të nevojshme për të kryer masa të rregullta të ashpërsisë së rrugës. Matja e ashpërsisë do të bëhet në baza të vazhdueshme që mundësojnë krahasim të mëtejshëm të ashpërsimit të shkuar dhe të ardhshëm në cdo shtrirje rruge të vazhdueshme 500 metra.

Asnjë kriter ashpërsie e rrugës nuk do të zbatohet gjatë fazës së rehabilitimit të kontratës. Megjithatë, ashpërsia do të kontrollohet në përfundim të rehabilitimit të pranuar dhe vlerat e rregjistruara dhe të pranuar në atë fazë do të përbejnë pragun kundër të cilit ashpërsitë e ardhëshme do të krahasohen. (sipas standarteve të IRI-t)

Aty ku asnjë fazë rehabilituese nuk është e parashikuar, ashpërsia do të matet në fillim të kontratës dhe, përseri, vlerat e rregjistruara dhe të pranuar në atë fazë do të përbejnë pragun kundër të cilit ashpërsitë e ardhëshme do të krahasohen.

Duke ndjekur rehabilitimin, apo fillimin ku nuk ka rehabilitim, Kontraktori do të jetë i përgjegjshëm për mbajtjen e ashpërsisë së rruges nën vlerat e pragut të vlerave të matura me sipër. Mbikqyrësi do të marrë pjesë në masat e ashpërsisë të cilat do të mendohen të formojnë një pjesë të Inspektimeve Formale.

Nëse ashpërsia akoma kalon maksimumin e lejuar, mirëmbajtja mujore bazë përse i përket gjatësisë së ndikuar do të pakësohet nga një faktor:

$$(Ra - Rp) / Rp$$

aty ku Ra është ashpërsia aktuale dhe Rp është ashpërsia e lejuar për nivelin e kërkuar të shërbimit. (shprehet në m/km)


Pakësimi do të vazhdojë të bëhet çdo muaj deri në një kohë të tillë sa ashpërsia e matur është pakesuar në një vlerë nën maksimale të lejuar.

(Më poshtë paraqiten shkalla e matjes së IRI-t sipas standarteve të Bankës Botërore).

6.1.1 IRI (*International Roughness Index*)- Treguesi nderkombëtar i rrudhshmërisë/ashpërsisë së rrugës

Përfaqëson çrregullimet gjatësore mbi sipërfaqën e rrugës. Ky tregues përmbledh matematikisht profilin gjatësor të sipërfaqes së rrugës përgjatë gjurmës së një rrote, që përfaqëson ndryshimet që i ndodhin automjetit gjatë levizjes për shkak të rrudhshmërisë së rrugës. Këto çrregullime të profilit krijohen nga të meta që përgjithësohen nga mungesa e përsosmërisë nga deformimet strukturore. IRI është treguesi nderkombëtar me i përdorshëm, është konceptuar që të llogaritet mbi bazën e të dhënave të marra mbi profil.

Në figurën e mëposhtme paraqitet shkalla e matjes së IRI (Banka Botërore)



6.2 Gjëresia e Shtrimit

Kontraktuesi është i përgjegjshëm për të siguruar që gjëresia e shtrimit është se paku po aq e gjërë sa është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Rruga	Gjëresia e Shtrimit	Koha e lejuar për riparime apo tolerancë të lejuar
(jepet emri i rrugës)	(percaktohet gjeresia e saj)	Asnjë tolerancë e lejuar

Gjëresitë e specifikuara nuk përfshijnë anët e shtruara të rrugës.

6.3 Mjetet e përdorura për vlerësimin e Niveleve të Shërbimit për rruget e shtruara

Për inspektimet formale të pajtueshmërisë me Nivelet e Shërbimit, Kontraktori do të punojë në bashkëpunim të afert, dhe nën supervizionin e Mbikqyrësit.

Me qëllim të kryerjes së këtyre inspektimeve, Mbikqyrësit ti vihen në dispozicion mjetet e nevojshme dhe stafi i kualifikuar.

6.4 Metodologji për Masa të Qëndrueshmërisë

Metodologjitë që do të përdoren për inspektimet e niveleve të shërbimeve janë si më poshtë:

6.4.1. Procedurat për Inspektim

Inspektimet formale të Niveleve të Shërbimit në rrugë të shtruara do të kryhen duke ndjekur procedurat e prezantuara në këtë material.

(a) Përdorimi i Rrugës

Kushti nuk është i pajtuar nëse rruga ndërpritet në çdo pikë. Megjithatë kushti është i pajtuar nëse është e nevojshme të vazhdohet të drejtohet mjeti në rrugë me shpejtësinë e treguar, dhe pamvarsisht mjetit që vuan nga ndonjë dëmtim i shkaktuar nga kushti i keq i rrugës.

(b) Masat e Komfortit të Përdoruesit të Rrugës dhe Gjërësisë së Shtrimit

Procedurat për Inspektimet e masave të operacionit dhe aspekteve të gjërësisë së shtrimit të rrugës do të jenë në përputhje me të dhenat e paraqitura në këtë material

7. Sinjalistika dhe Siguria e Rrugës

7.1 Masat e Niveleve të Shërbimit për Sinjalistikë dhe Siguri në rrugë

Kontraktori është i përgjegjshëm për të siguruar që e gjithë sinjalistika horizontale dhe vertikale, gjithashtu edhe parrakët dhe pajisjet e sigurisë rrugore pajtohen plotësisht me Standartet Rrugore Kombëtare Shqiptare. Ai, kontraktori, është i detyruar që gjatë periudhës së zbatimit të kontratës të ketë me kontratë, një ekspert të sigurisë rrugore të certifikuar me:

“ Çertifikatë aftësie për auditues/inspektues të sigurisë rrugore(ASR/ISR)

Kërkesat e Nivelit të Shërbimit për sinjalistikë dhe mjete të sigurisë rrugore janë të treguara në tabelën e mëposhtme:

Pjesa	Niveli i Shërbimit	Masa/Hetimi	Koha e Lejuar pe Riparime ose Toleranca e lejuar
Sinjalet e informacionit	Duhet të jenë prezent,të plota, të pastra, të qarta dhe me strukture të mirë;	Inspektim Vizual dhe testim te reflektueshmerise	Shenja që mungojnë apo që janë difektoze duhet të zëvendesohen brënda katërmbëdhjetë (14) ditëve.(për nivelin “ mirë” të shërbimit)
Sinjalet e njoftimit	Duhet të jenë prezent, të plota, të pastra, të qarta dhe me strukture të mirë; dhe qartësisht të shikueshme natën °	Inspektim Vizual dhe testim te reflektueshmerise pektim Vizual	
Sinjalet e drejtimit të trafikut	Duhet të jenë prezent, të plota, të pastra, të qarta dhe me strukture të mirë; dhe qartësisht të shikueshme natën °	Inspektim Vizual dhe testim te reflektueshmerise	
Kufij Horizontal: dhe/ose boje shtrimi	Duhet të jenë prezent, të lexueshme dhe të vendosura në mënyrë të qëndrueshme në rrugë. Mikrosferat duhet të jenë të qëndrueshme dhe vizive.	Inspektim Vizual	
Tregues distance dhe delineatorë	Duhet të jenë prezent,të plota, të pastra, të qarta dhe me strukturë të mirë; sipërfaqja e lyer apo ndryshe e mbuluar.	Inspektim Vizual	
Mbrojtëset	Duhet të jenë prezent, të pastra, (pastrohen me furçë teli)pa ndonjë dem domethenës, pa korrozion.	Inspektim Vizual	
Ndriçimi	Shtyllat dhe elementët	Inspektimi Vizual	Cdo riparim duhet të

Pjesa	Niveli i Shërbimit	Masa/Hetimi	Koha e Lejuar pe Riparime ose Toleranca e lejuar
	tjerë të ndriçimit duhet të jenë prezent, duhen kontrolluar dhe ndërruar llampat e djegura, shtyllat e dëmtuara nga aksidentet ose shkaqe të tjera duhet të riparohen ose të zevendesohen. Cdo defekt i ndriçimit duhet riparuar nga kontraktori		bëhet brenda 7 ditëve për llampat dhe brenda 30 ditëve për shtyllat dhe defektet tjera të linjës



Variacionet dhe pajtueshmëria graduale me Nivelet e Shërbimit për Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

Me qëllim respektimin e periudhës së mobilizimit fillestar të Kontraktorit, pajtueshmëria me cdo kriter të nivelit të Shërbimit, do të jetë në përputhje me kërkesat për Shërbimin e Përdoruesit të Rrugës dhe Nivelet e Komfortit.

Procedurat për Inspektim

Inspektimi viziv do të ndermerret si pjesë e Inspektimeve Formale dhe Informale. Kriteri për Sinjalistikën dhe Sigurinë Rrugore do të zbatohet në seksione të zgjedhura nga Mbikqyrësi të bazuar në aparencën vizive. Mbikqyrësi do të jetë gjykatësi i vetëm i pajtueshmërisë. Nëse një kriter i specifikuar nuk përmbushet, seksioni një kilometër në të cilin deficiti ndodh do të gjykohet i papajtueshëm.

8. Kullimi

8.1 Nivelet e Shërbimit

Në terma të përgjithshëm, Kontraktori duhet të sigurojë që të gjithë elementët dhe strukturat e kullimit janë pa ndonjë pengese e cila mund të pakesoje nder-seksionimin e tyre normal dhe të pengojë rrjedhjen e lirë të ujit.

Kërkesat e Nivelit të Shërbimit për strukturat apo mjetet kulluese janë si ato të treguara në tabelën e mëposhtëme:

Pjesa	Niveli i Shërbimit	Hetimi i Mases	Koha e Lejuar pe Riparime ose Toleranca e lejuar
Gropat dhe kanalet vertikale me linjezim	Duhet të jenë të pastra dhe të linjezuara pa ndonjë demtim domethenës të linjzimit.	Inspektim Vizual	Toleranca e lejuar; zbatohet për cdo pjese:
Gropat dhe kanalet vertikale pa linjezim	Duhet të jenë të pastra dhe të lira nga pengesat.	Inspektim Vizual	Pengesat do të jenë: Çdo pengese që con në me shumë se 10% ulje të kapacitetit të një kanali apo 5% të një kanali.
Kolektorët	Duhet të jenë të pastër dhe të lirë nga pengesat, dhe pa dëm strukturor. Duhet të përmbahen qëndrueshem nga toka apo materiali rrethues.	Inspektim Vizual	Pengesat duhet të pastrohen brënda shtatë (7) ditëve pas hetimit.
Kanale dhe drenazhe të ngjashme	Duhet të jenë të paster dhe të lirë nga pengesat, dhe pa dëm strukturor. Duhet të përmbahen qëndrueshem nga toka apo materiali rrethues.	Inspektim Vizual	Dëmet duhet të riparohen brënda tre javeve pas hetimit.



Fig. Shembull nga pastrimet e tobinove

Variacioni dhe Pajtueshmëria Graduale me Nivelet e Shërbimit

Me qëllim respektimin e periudhës fillestare të mobilizimit të Kontraktorit, pajtueshmëria me kriteret e nivelit të kullimit nuk do të kërkohet gjatë 60 ditëve të para të periudhës së Kontratës.

Procedurat për Inspektim

Pastërtia dhe kushti i strukturave të kullimit (duke përfshire gropat, kryqëzimet dhe të gjitha tipet e tjera të mjeteve të kullimit) është pjesë e Kriterit për “Qëndrueshmëri të Rrugës”. Ajo verifikohet në një bazë të rregullt, në vecanti përpara dhe gjatë stinës së shirave. Strukturat e kullimit për tu verifikuar janë të përcaktuara nga Mbikqyrësi. Inspektimi bëhet vizualisht. Parimi bazë i përdorur për të përcaktuar pastërtinë e strukturave apo pajisjeve të kullimit është “përqindja e ndër-seksionit teorik të strukturës apo pajisjes e cila është e papenguar”. Kjo përqindje është e specifikuar në tabelen e përmbledhjes me sipër. Për një seksion rrugë një kilometër, pastërtia e kanaleve të kullimit duhet të verifikohet se paku në dy nënseksione prej 50 metër sejcili.

Për një seksion një km të rrugës, pajtueshmëria me këtë kriter kërkon që (i) të gjitha strukturat e kullimit të jenë të pastra në sensin e përcaktuar me sipër; (ii) të gjitha strukturat dhe pajisjet janë nga ana strukturale të mira, të bazuara në gjykimin e Mbikqyrësi i Punimeve.


9. Bimesia (duhet pasur parasysh nëni 25 i Rregullores Kodit Rrugor)

9.1 Nivelet e Shërbimit

Ky seksion specifikon Nivelet e Shërbimit për tu pajtuar në rast të bimësisë në rritje brënda rrugës ku lejohet kalimi: Bimësia duhet të kontrollohet në lartësitë, në vendet dhe me kufizimet sic janë paraqitur në tabelën dhe diagramën më poshtë.

Tabela 1: Kategoritë e Kontrollit dhe Mirëmbajtjes së Bimësisë

Lloji	Lartësia (mm)	Tiparet që do aplikohen:
1	25 – 75	Shpatullat e superstrukturës urbanë, brezat e ndermjetëm, ishujt me gjëlberim dhe skajet e rrugës, gjëlberimi në zonat e pushimit, (duke përfshirë furniturën për zonat e pushimit).
2	25 – 300	Rrugët jo urbanë dhe zonat e medha të gjëlberuara, duke përfshirë kanalet me uje që kapin një rreze përthyerje gjatësorë prej $\geq 3\%$.
3	0 – 200	Rrethinat për kontrollin e gjëlberimit: Posterat e vijeimit Posterat e shenjave Sinjalizuesit e urave dhe tombinove Mbrojtësat metalike Parapetet Kollonat e ndricimit Shpatullat e urës
4	Hapesirat e gjëlberuara apo afersitë e hapësirave të gjëlberuara	Aplikohet për kontrollin e gjëlberimit përreth: Mbylljet e tombinove Kokat e mureve të tombinove Kunetat anësore Tombinot e ujrave Kanalet sipërfaqësorë të ujrave me rreze $< 3\%$ (përveç vendeve që janë emertuar për zhvendosjen në kërkesat specifike të kontratës) Trotuare dhe kanale Kanalet anësorë, gjithë sipërfaqet e taposuara Krahët metalikë Deket e urave.
5	Prerjet e barërave që hiqen kur ato afrohen në zonat e lira të gjëlberuara nga anët deri në fillim.	Aplikohet për kontrollin e gjëlberimit në membranë, përfshirë pemë, gerryerjet apo deget që varen në zonat e lira të gjëlberimit (brënda 0.5m nga linja e skajit të postërave të vijeuesit apo brënda 6.0m sipër rrugës)
6.	Mirëmbajtje e bimësisë në pjesët anësore të rrugëve	Aplikohen shërbimet e nevojshme si krasitja, ujitja si dhe zëvendësimi i tyre në rast tharje apo dëmtimi (nga aksidentet rrugore apo shkaqe të tjera natyrale).



EXTENT AND TYPE OF VEGETATION CONTROL

- NOTE 1 this distance must be a minimum of 3.0m on straightis and on the outside of curves and a minimum of 5.0m on the inside of curves.
- NOTE 2 Vegetation free zone must be maintained free of all vegetation.
- NOTE 3 A minimum of 3m to be maintained on the cuts up, and 2m on slopes down.
- NOTE 4 These areas must be maintained according to the local requirements

Figure shoqëruese: Tipi i kontrollit të vegjetacionit



Figure :Shembull i pastrimit të bimësisë

9.2.Mënyrat që përdoren për të vlerësuar përputhshmërinë me Nivelet e Shërbimit

Lartësia e pemëve/shkurreve si dhe qartësia e rrugës gjatë udhëtimit, është pjesë e Kriterit të “Komfortit të Përdoruesit Rrugor”. Matjet do kryhen në ato seksione rrugorë që përzgjidhen nga Mbikqyrësi bazuar në qartësinë vizuale. Matja e lartësisë së tyre bëhet me anë të një ruli; kjo përcakton se si matet distanca vertikale ndermjet tokës dhe pikës me të lartë të shkurreve. Qartësia e rrugës matet me një rrul apo shirit matës; kjo përcakton distancën ndermjet pikës me të ulet të pëmes sipër sipërfaqes rrugore.

Për cdo km seksion rruge, përputhshmeria me Kriterin e lartësisë kërkon që lartësia mesatare e shkurreve brënda seksionit rrugor prej një km të jetë poshtë vlerës maksimale të caktuar në kontratë dhe për përputhshmerinë me Kriterin e qartësisë që është me i madh se qartësia minimale e përcaktuar.

Kontrolli i gjendjes së bimësisë në anët e rrugëve bëhet vizualisht. Mirëmbajtja e tyre realizohet sipas karakteristikave të veçanta të pemëve apo llojeve të tjera të shkurreve dekorative.

10. Veprat e artit

Kontraktori është përgjegjës për mirëmbajtjen rutinë të gjithë urave dhe veprave të artit të ngjashme, gjatë rrugës dhe seksioneve rrugorë të përfshirë në kontratë. Në vecanti, ai do jetë përgjegjës për funksionimin e saktë të veprave të artit (lyerja me boje e strukturave metalike, sipërfaqja rrugorë e strukturave, pastrimi i mureve të betonit dhe parapeteve të tuneleve, gjëndja dhe vendosja e barrierave metalike) dhe siguria e komforti i përdoruesve rrugorë që përdorin rrugën me shpejtësi normale. Megjithatë, rindërtimi dhe përmirësimi i urave (por jo i tombinove) përjashtohet nga detyrimet e Kontraktorit vetëm nëqoftëse specifikohet.

Çdo 6 muaj te behet verifikimi i gjendjes faktike të urave dhe të raportohet gjendja e tyre tek mbikqyrësi i punimeve.

10.1 Nivelet e Shërbimit

Kërkesat për Nivelet e Shërbimit për urat dhe muret mbajtës si dhe veprat e artit janë të tilla sic tregohen në tablen e mëposhtme:

Zeri	Niveli i Shërbimit	Masat/ Ndjekja e procedures	Koha që jepet për riparime apo toleranca e lejuar
Strukturat metalike apo të tjera si këto	Mbrojtëset metalike do jenë në testim dhe të padeformuara. Gjithë pjesët metalike të strukturave në tëresi do bojatisen apo mbrohen në të njëjtën mënyrë dhe do kontrollohen për korrozion. Sistemi i drenazhimit do jetë në gjendje të mirë dhe tëresisht funksional.	Inspektim Vizual	Kontraktori duhet që të njoftojë menjehere Mbikqyrësin e Punimeve në rast kercenimi të integritetit strukturor të strukturës
Struktura betoni (vepra arti)	Stukimi i demtimeve për shkak të agjenteve atmosferike dhe mbulimi armatures së hekurit kur zhvishet nga faktore të ndryshëm. Riparimi i pjeseve të demtuara në ballinat e urave nga renja e gureve. Do vendosen parapetat dhe bojatisen. Shufrat dhe pjesët e tjera të strukturës do jenë tëresisht në gjendje të mirë punë.	Inspektim Vizual	Kontraktori duhet që të njoftojë menjehere Mbikqyrësin e Punimeve në rast kercenimi të integritetit strukturor të strukturës
Fugat bashkues	Pastrim dhe kushte të mira	Inspektim Vizual	Dëmtime dhe defekte që duhen të riparohen brenda shtatë (7) ditëve.
Muret mbajtës	Kontraktori do kontrollojë gjendjen dhe kushtet e mureve mbajtës dhe drenazhimet e tyre.	Inspektim Vizual	Dëmtime dhe defekte që duhen të riparohen brenda katërmbedhjetë (14) ditëve.

Zeri	Niveli i Shërbimit	Masat/ Ndjekja e procedures	Koha që jepet për riparime apo toleranca e lejuar
Shtratët e lumit	Kontraktori duhet të sigurojë që të rrjedhin pastër e normalisht ujrat e shtratit të lumit dhe niveli i tyre të arrije deri në 100 metra nga të dyja anët e burimit Kontraktori duhet të ruajë dhe mbajë sa me pastër pjesen poshtë urave. Kontraktori duhet të marrë gjithë masat e nevojshme për të kontrolluar erozionin rreth kembeve dhe shufrave të ures.	Inspektim Vizual	Nëse nuk pranohen këto punime do hiqen e zevendesohen brënda katërmbëdhjetë (14) ditëve pasi të tërhiqen ujrat dhe të mundësohen nderhyrjet.

10.2 *Devijimet dhe përputhshmëria graduale me Nivelet e Shërbimit.*

Për të respektuar periudhën e mobilizimit fillestar të Kontraktorit, nuk do të hyje në fuqi 60 ditëshin e pare të punimeve të kontratës përputhshmeria me Kriterin e nivelit të Shërbimit.

10.3 *Procedurat për Inspektim*

Inspektimet vizuale do kryhen si pjese e Inspektimeve zyrtare dhe jozyrtare. Kriteri për Veprat e Artit do kontrollohet në ato pika që janë përzgjedhur me sy të lirë nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi do jetë i vetmi që do vendosë mbi përputhshmërinë. Nëse nuk arrihet një kriter i specifikuar, seksioni prej një km ku ka ndodhur problemi do quhet si i papërputhshëm.

11. *Skarpata – Gërmimet dhe Bankinat*

Kontraktori është përgjegjës për mirëmbajtjen e gjithë bankinës dhe skarpatave gjatë seksioneve të rrugës që janë përfshire në kontratë. Në vecanti ai është përgjegjës për të siguruar nëse janë të qëndrueshme, pa deformime dhe erozione. Megjithatë, rindertimi dhe përmirësimet e veprave të artit mbajtës dhe stabilizimi i skarpatës përjashtohet nga detyrimet e Kontraktorit, vetëm nëse nuk specifikohet ndryshe në Specifikimet Teknike apo të udhëzohet në punimet e emergjencës.

11.1 *Nivelet e Shërbimit*

Kërkesat e nivelit të Shërbimit janë treguar në tabelën e mëposhtëme.

Zeri	Niveli i Shërbimit	Matjet/Ndjekja e procedures	Koha në dispozicion për riparimet apo Tolerancat e lejuara
Bankinat e skarpatave	Do jenë pa deformime dhe erozionë.	Inspektimi Vizual	Riparimet do përfundojnë brënda shtatë (7) ditëve pas ndjekjes se difektit.

Riparimi i rreshqitjeve	Rreshqitjet nga Materialet e skarpatave në rrugë janë konsideruar si emergjencë në rastin kur saisa e Materialit është sipër 500 m ³ në cdo rast.	Nëse kontraktori ka ndermend të zbatoje kushtet e kontratës për emergjencat, ai ka vlerësuar keshtu sasishtë dhe menjehere njofton Mbikqyrësin e Punimeve, që me pas ben verifikimet.	Rrjedha e trafikut do ristabilizohet brënda 6 orëve. Periudha për heqjen e materialeve të tjera që kanë rreçitur me urdher të Mbikqyrësi i Punimeve kryhet sic është specifikuar në klauzolat për emergjencat.
Gërmime në skarpata	Gërmimet në skarpata duhet të jenë të qëndrueshme duhet të jenë të qëndrueshme dhe/apo të përshtatshme me muret mbajtës dhe stabilizimin e skarpatës që duhet që shoqërtohen me masat përkatëse.	Inspektimi Vizual për Materialin në skarpata mbi bankina apo shtrim	Materiali që rrezohet nga skarpata duhet të hiqet nga rruga Sasishtë sipër 50 m ³ : Nga rruga brënda 4 orëve pas ndjekjes se procedures Nga bankinat dhe kunëtat anësorë brënda 48 orëve pas ndjekjes se procedures. Ndermjet 50 m ³ dhe 500 m ³ nga rruga brënda 24 orëve pas ndodhjes nga banikant dhe kunëtat anësorë brënda 96 orëve pas ndodhjes Shenim: për rreshqitjet klasifikohet si “Emergjente” aplikohën rregulla të tjera.

11.2 Devijimet dhe përputhshmeria graduale me Nivelet e Shërbimit

Për të respektuar periudhën e mobilizimit fillestar të Kontraktorit, përputhshmëria me Kriterin e nivelit të shërbimeve të punimeve të dherave do jetë në përputhje me afatin e punimeve të kriterit të kohezgjatjes se rrugës.

11.3. Procedurat për Inspektim

Inspektimi vizual do ndërmerret si pjesë e inspektimeve zyrtare dhe jozyrtare. Kriteri për skarpatat do kontrollohet në ato seksione që përzgjidhen nga Mbikqyrësi bazuar në qartësinë vizuale. Mbikqyrësi do jetë gjyqtari i vetëm që vendos për përputhshmërinë. Nëse nuk ndiqet një kriter i përzgjedhur, atëhere do merren masa jo kualifikuese për cdo km rrugë që ndodh ky deficit.

12 .Pjesa B : Pagesat dhe penalitetet

12.1 Zbritjet në Pagesa dhe Dëmet e Likujdueshme

Zbritjet e Pagesave do aplikohen në rast se ka mosperputhje me kerkesat e Niveleve të Shërbimit, ndersa Demet e Likujdueshme aplikohen në rast të mospërputhshmërisë me Punimet Rehabilutuese.

12.2 Si përcaktohen Zbritjet nga Pagesat

Pagesat që vijnë nga Kontraktori në lidhje me nderhyrjet e mirëmbajtjes behen bazë për këto zbritje pasi ato paraqesin dhe mungesa të zërave të pakryer të punimeve të mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat e Specifikimeve. Zbritjet behen në bazë të tre formave të raportimit:

- Raporti nga vetë Kontraktori mbi vetekontrollimin e njesive të punës që përben një pjese të Certifikatës se Ndermjetme të Pagesave të Kontraktorit.
- Inspektimet jozyrtare që kryhen nga Mbikqyrësi gjatë muajit të meparshem dhe që janë raportuar për Kontraktorin.
- Inspektimet zyrtare që kryhen me dorëzimin e Certifikatës se Pageses dhe të cdo dokumenti tjetër që kërkohet në cfaredo lloj kohe nga Mbikqyrësi.

Rezultatet e sejcilit inspektim të Niveleve të Shërbimit dhe kriteret e tjera të kryerjes së punimeve do dokumentohen nga Mbikqyrësi në formën e një memoje. Memoja do tregojë qartë kategorinë dhe pozicionimin e cdo punimi me difekt, në vecanti këtu ato punime që nuk përputhen me ato standarte kategorizuese të vëna për kontraktorin si pjesë e gjëndjes se punimeve mujorë. Për secilin rast të veçantë të mospërputhshmerisë, Kontraktori bëhet pjesë e zbritjeve nga pagesat.

Zbritjet nga Pagesat janë grumbulluar me kalimin e kohes. Nëse Kontraktori dështon në përmbushjen e një punimi me difekt për të cilat tashmë është aplikuar një zbritje pagese, atëhere sasia e zbritjes nga pagesa rritet nga muaji në muaj për atë rast specifik të punimit me difekt, pa aplikuar një shumë tavan, deri në momentin kur të zevendesohet ky punim në standartin e përcaktuar. Llogaritja e sasive fillestare të zbritjeve të pagesave (të muajve të pare) si dhe formula me rregullimin e tyre në afat, do behet me anë të rregullave të meposhtëm, bazuar ne tabelen e aplikimit të penaliteteve.

Zbritjet e Pagesave për mospërputhshmeri me Përdorimin, Konfortin e Shërbimit të Përdoruesit Rrugor dhe Masat e marra për Jetëgjatësinë e Rrugës: Për cdo rrugë apo seksion rrugor, Punëdhënësi do zbrese nga pagesat mujore të pagueshme për Kontraktorin duke zbritur gjatësinë totale të pagueshme me numrin e atyre kilometrave rrugë të papërputhshme me Standartët sic përcaktohet cdo muaj nga Mbikqyrësi. **Në rastet kur zbritjet e pagesave (penalitetet) arrijnë shumën e 30% të vlerës së punimeve të mirëmbajtjes rutinë, ky fakt mund të bëhet shkak për fillimin e procedurave që çojnë**

deri në prishje të kontratës, me justifikimin e mospërmbushjes së kritereve të kërkuara të shërbimit.

12.3 Pajtueshmëria/ mospajtueshmëria për kryerjen e shërbimit sipas niveleve të caktuara.

Pajtueshmëria/mospajtueshmëria me nivelet e shërbimit të kërkuara për rruget e caktuara, pas inspektimeve do të behet sipas tabelës së Lidhjes A, ku jepen qartë afatet për reagimin ndaj defektëve dhe penalitetet për mospajtueshmërinë ndaj tyre.

(Sipas Lidhjes A)/

Përshkrimi		NIVELI I SHERBIMIT				Menyra e vëzhgimit	Koha e riparimit ose tolerances	Normat e penalitetit për mospërputhje
Emertimi	Kushtet	Shumë I Mirë	I Mirë	Mjaftueshem	Minimum			
(një plasaritje e hapur në asfalt me gjëresi me të madhe se 3 mm)	Nuk është e lejueshme asnjë plasaritje në rruge	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektimi vizual Gjëresia e plasaritjes matet me një vizorë të vogël transparent	të mëdha se 3mm tolerohen deri në 28 ditë me gjëresi me shumë se 10 mm duhet të pastrohet e riparohen deri 48 orë	për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë
Plasaritje të shumta në sipërfaqë	Për cdo 50 m seksion plasaritjet nuk duhet të jenë me shumë se 10% e sipërfaqe zonë plasaritur është ekuivalentë me një zonë katrorë, paralel me korsin, e cila është një carje e plotë, kur carja me e afert është 0.25 m nga anët e sipërfaqës se plasaritjes					Inspektimi viz. Gjëres. plasaritjes matet me një vizorë të vog.	Sip. me carjet duhet të pritët dhe të arnohet brenda 28 ditëve nga verifikimi, veçse kur PM është dakort që carjet	20% të Lump - Sum mujor për seksionin që I tëjkalon e sipërfaqës se shtreses se demtuar në një 50 m seksion

						përgj	të vulosen	
Pastrimi I sipërfaqës dhe I bankinave	Sip. E rrugës duhet të jetë përhershë e pastër nga rera, copra mbeturinash e objektë të tjera	Largimi brënda 3 orëve nëse paraqësin rrezik për sigurinë e trafikut e brënda 3 ditëve nëse ska rrezik	Largimi brënda 4 orëve nëse paraqësin rrezik për sigurinë e trafikut e brënda 4 ditëve nëse ska rrezik	Largimi brënda 6 orëve nëse paraqësin rrezik për sigurinë e trafikut e brënda 7 ditëve nëse ska rrezik	Largimi brënda 8 orëve nëse paraqësin rrezik për sigurinë e trafikut e brënda 14 ditëve nëse ska rrezik	Inspektim Vizual	Sipas përcaktimit	30% të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë
Gjurmet e gomave të mjetëve	Nuk lejohen Gjurme gomash me të thella se 40 mm Në rastet e me shumë se 10 mm sduhen pranuar me shumë se 5% për cdo 1 km gjat	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Matën me 2 vizorë, një horizontal e 3 m gjat dhe një vizorë e vogel pingul mat thellesinë e gjurmes	Në rastet kur verifikohën dhe I kalojnë nivelet e lejuara duhen eliminuar brënda 28 ditëve	10 % të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë

Shpërberja e asfaltit thermimi I tij në sip e rrugës	Sipërfaqë të tilla nuk duhet të ekzistojnë	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Sipërfaqja e demtuar duhet riparuar brënda 28 ditëve pas verifikimit	20 % të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë
---	--	-----------------------------	-----------------------------	-----------------------------	-----------------------------	------------------	--	---

Prishja e anëve të karrexhatës	Anët e demtuara nuk mund të lejohen	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Sipërfaqja e demtuar duhet riparuar brënda 28 ditëve pas verifikimit	15% të Lump - Sum mujor për seksionin që I tëjkalon e sipërfaqës se shtreses se demtuar në një 50 m seksion
Diference lartësie mes sip rrugës	Kjo diference nuk duhet të jetë kurre me tëpër se	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Matën me 2 vizorë, një horizontal e	Diferenca e verejtur duhet riparuar brënda 7 ditëve	20% të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet

dhe bankinave	50 mm					një vizorë e vogel pingul mat dif mes rrug e bankin	pas verifikimit	në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë
Bankinat e shtruara	Duhet të jenë pa deformime, pa erozion dhe pa gropa	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Sipërfaqja e demtuar duhet riparuar brënda 28 ditëve pas verifikimit	20% të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson përputhshmerinë
Bankinat e pa shtruara	Duhet të mirëmbahen të lëmuara. Nuk lejohen uljet 3metër gjatësi	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Matën me 2 vizorë, një horizontal e 3 m gjat dhe një vizorë e vogel pingul mat	Sipërfaqja e demtuar duhet riparuar brënda 7 ditëve pas verifikimit	50 % të lump-sum mujor për 1 km të aplikohet në cdo km të seksionit I cili nuk plotëson

	të anëve të bankinës deri në 75 mm					thellesinë e differences ese uljes	përputhshmerinë
--	------------------------------------	--	--	--	--	------------------------------------	-----------------

Përshkrimi		NIVELI I SHËRBIMIT				Menyra e vëzhgimit	Koha e riparimit ose tolerances	Normat e penalitëtit për mospërputhje
Emertimi	Kushtet	Shumë I Mirë	I Mirë	Mjaftueshem	Minimum			
Germimi dhe mbushja e skarpatave	referohet specifikimeve	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Riparimi I skarpatave duhet kompletuar brenda 7 ditëve mbas verif. Defektit Në rastet e një trafiku duhet rip. brenda 6 orë Materiali do largohet nga rruga 4 orë për me pak se 50m ³ .Brenda 24 orëve për me shumë	20 % të shumës mujorë për komplet rrugen, për cdo që nuk plotësohet

							se 500 m kub.	
Strukturat	Sipas Specifikimeve	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Inspektim Vizual	Referuar Klauzolave përkatëse	25% për cdo një ndodhi kur verehen
Sinjalistika	Sipas Specifikimeve	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Sinjal e munguar ose e demtuar do zevedes brënda 14 ditëve,	20 % të shumës mujorë për komplet rrugen, për cdo që nuk plotësohet
Sinjalistika horizontale dhe vijëzimet	Vijëzimet duhet të jenë të pastra dhe të dukshme	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Vijëzimet e rrugëve të shtruara duhet të rilyhen brënda 56 ditëve nga njoftimi	25 % të shumës mujorë për komplet rrugen, për cdo ditë që nuk plotësohet riparimi
Parmaket mbrojtës ose Guardrailet	Duhet të jenë prezent në cdo kohe, të pastruara të drejtuara të vendosura në mënyrë solide	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Guardrailet e demtuara duhen zevendësuar brënda 7 ditëve	25 % të shumës mujorë për komplet rrugen, për cdo ditë që nuk plotësohet riparimi

	Shtyllat dhe elementët tjerë të ndriçimit duhet të jenë prezent, duhen kontrolluar dhe ndërruar llampat e djegura, shtyllat e dëmtuara nga aksidentet ose shkaqe të tjera duhet të riparohen ose të zëvendesohen . Cdo efekt i ndriçimit duhet riparuar nga kontraktori							
Ndriçimi		Njëlloj në të gjithë rastet	Njëlloj në të gjithë rastet	Njëlloj në të gjithë rastet	Njëlloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	Cdo riparim duhet të bëhet brenda 7 ditëve për llampat dhe brenda 30 ditëve për shtyllat dhe defektet tjera të linjës	20% te Lump Sum per cdo km qe nuk ploteson kriteret
Përshkrimi		NIVELI I SHËRBIMIT				Menyra e vëzhgimit	Koha e riparimit ose tolerances	Normat e penalitëtit për mospërputhje
Emertimi	Kushtet	Shumë I Mirë	I Mirë	Mjaftueshem	Minimum			
						Bllokimet të pastrohen	50 % të shumës mujorë	

Drenazhet	Sipas Specifikimeve	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Njelloj në të gjithë rastet	Inspektim Vizual	brënda 7 ditëve Dëmtimet e drenazheve brënda 21 ditëve	për komplet rrugen, për cdo ditë që nuk plotësohet riparimi
Bimesia	referohet specifikimeve	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Njelloj në të gjithë	Inspektim Vizual dhe matje	Bimesia nuk duhet të kaloje lartësinë e lejuar Prerja dhe pastrimi I degeve e shkurreve duhen bere para se të arrihen limitet e lejuara.	25 % të shumës mujorë për komplet rrugen, për cdo ditë që nuk plotësohet riparimi
Vegjetacion i	për lartësitë e lejuara të bimesise dhe mirëmbajtjes së bimësisë në anë të rrugës	rastet	rastet	rastet	rastet	e lartësise	Bimësia në ane të rrugës duhet krasitur, ujitur e zëvendësuar në rastet e tharjeve apo dëmtimeve.	

Pjesa B

Rregullat për punimet Emergjente

5. *Detyrimet e Kontraktorit gjatë Punimeve Emergjente dhe situatave Emergjente*

Kontraktori duhet të jete në gadishmeri dhe të veprojë menjehere në raste emergjencash sic janë permbytje, reshqije dherash, bllokime rrugesh etj. Kontraktori do ketë përgjegjësi të vazhdueshme gjatë gjithë kohës se ekzekutimit të Punimeve Emergjente për të siguruar kështu nivelet normale të shërbimit për të gjitha rrugët që përfshihen në kontratë. Përveç kësaj, Kontraktori do bëjë ç'është e mundur me arsyetimin me të mundshëm që të sigurojë shfrytëzimin normal të rrugëve të kontratës, duke përfshirë seksionet që preken nga emergjencat. Për keto raste nuk do ketë pagesa të vecanta nga Kontrata.

Nëse trafiku në rrugë nderpritet si rrjedhojë e një emergjencë, atëherë Kontraktori do ndermarrë gjithë masat e nevojshme si :

- Të rihape trafikun sa më shpejt të jetë e mundur, dhe
- Të mirëmbajë rrugën e hapur gjatë punimeve Emergjente,
- Të njoftojë mediatikisht dhe zyrtarisht organet e shtypit dhe audiovizive , pas miratimit nga Punedhënësi mbi situatën e krijuar.

pa gezuar asnjë shpërblim/pagese shtesë për këto shërbime. Kjo vlen edhe për gjithë rrethanat emergjente sic janë dëmtimet që pesojnë rrampat e ures, erozioni në bankina, renie e gjithë skarpatës, aksidentët rrugorë, permbytjet, etj.

6. *Riparime të vogla që janë të nevojshme nëpërmjet “Fenomeni Natyror i Paparashikuar”*

Nëse punimet e nevojshme për riparimin e dëmeve shkaktohen nga “Fenomeni Natyror i Paparashikuar” është nën vlerat treguese apo të një natyre që përjashtohet nga kategoria e Punimeve Emergjente, Kontraktori do kryejë ato punime si pjesë e detyrimeve të tij normale. Megjithatë ai do njoftojë gjithmonë Mbikqyrsin e Punimeve mbi dëmet që kanë ndodhur dhe masat riparuese që do ndermerren. Vlerat treguese për kilometër e rrugës për riparimet e vogla janë treguar në tabelën me poshtë:

Aktiviteti	Njesia	Sasia për situatat Emergjente
Rreshqitjet e Materialit në rrugën	M ³	500 (një në cdo ndodhi)
Dëmtimi, bllokimi, renie apo mbytje e Tombinove	Numri	1 në cdo 5 kilometra seksion rruge
Asfalto-beton	M ³	20
Shtresa bazë	M ³	50
Betoni	M ³	5

Bankina	M ²	500 (një në cdo ndodhi)
---------	----------------	-------------------------

Ne rast se tejkalohen vlerat e mesiperme kontrata nuk mund te perballoje situaten emergjente te krijuar dhe duhet te kerkoet mbeshtetje.

Theksojme se kjo Kontrate nuk perballon te gjitha nevojat qe ka rruga dhe nuk mund te zgjidhe te gjitha problemet qe mund te paraqiten gjate zbatimit te saj. Kjo Kontrate parashikon vetem Mirembajtjen Rutine dhe zgjidh vetem problemet e thjeshta te mirembajtjes. Per nevojat, problemet dhe emergjencat qe mund te paraqiten gjate zbatimit te Kontrates dhe nuk mund te perballohen nga kjo Kontrate Punedhenesi duhet te kerkoje mbeshtetje nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ne ecurine normale te zbatimit te Kontratave te Mirembajtjes Rutine e Dimerore me Performance mund te ndikojne faktore te ndryshem por kryesisht ndikimi kryesor mund te vije nga faktore natyrore sic jane permbytjet, termetet, reshqitjet e medha masive te dherave, rreshqitje totale te trupit te rruges, reshje te shumta debore shoqeruar me temperatura shume te ulta, shembje ose demtime serioze urash, muresh mbajttese etj. Si rezultat i fenomeneve ekstreme te motit mund te krijohen situata emergjente te pazakonta te cilat nuk mund te menaxhohen nga Sipermarresi dhe nuk mund te perballohen nga kjo lloj kontrate. Ne keto raste mund te nevojiten nderhyrje te tjera si realizim investimesh, planifikime fondesh per zgjidhje te perkohshme, studime per zgjidhje definitive. Ne raste te tjera mund te nevojiten nderhyrje emergjente nga Shtabet e Emergjencave Civile, nga Ushtria, nga Institucione te tjera Shteterore, private etj. Ndikim ne mbarevajtjen e Kontrates mund te kene edhe implementimi i projekteve ne aksin rrugor qe mirembahet. Nese do te kete implementim projektesh te ndryshme Kontrata do te nderpritet ose do te shkurtohet gjatesia e mirembajtjes.

Nje pjese e akseve rrugore paraqiten ne gjendje shume te amortizuar si rezultat i mungeses se investimeve prej shume vitesh. Ne keto akse edhe siguria rrugore nuk eshte ne standartet e duhura. Me anen e kesaj kontrate nuk mund te zgjidhen te gjitha problemet e amortizimit, por vetem mund te permiresohen. Gjithashtu me anen e kesaj kontrate siguria rrugore nuk mund te arrije nivelet e kerkuara bashkekohore pasi do te nevojiten projekte te vecanta sinjalistike. Ne keto raste nga ana e Sipermarresit duhet te behen te gjitha perpjekjet qe brenda mundesive te kontrates te arrihet nje nivel dhe standart sa me i larte performance.

Pjesa C

Rregullat Standarte

1. Kërkesat e përgjithshme

a. Hyrje

Cdo element i mirëmbajtjes do të zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

b. Marrja në dorëzim e seksionit rrugor për fillimin e implementimit të mirëmbajtjes

Seksionet rrugorë që do të kalojnë nën Mirëmbajtjen me Performance do t'i dorëzohen Kontraktorit nga Punëdhënësi në formën e një inventari të të gjithë elementëve rrugorë dhe karakteristikat mbi gjëndjen e tyre faktike.

Formulari i këtij procesi do të përgatitet ku të pasqyrohen :

- Seksioni rrugor dhe gjatësia
- Numri i korsive dhe gjëresia e karrexhatës
- Numri i veprave të artit (urat, tombinot, muret mbajtës)
- Sinjalistika horizontale
- Sinjalistika vertikale ne forme planimetrie (numri dhe lloji i tabelave, delineatorëve, reflektorëve, shevronë e tjere) qe do te hartohen nga Mbikqyresi se bashku me Kontraktorin.
- Mbrojtëse metalike ne forme planimetrie (lloji dhe sasia e tyre) qe do te realizohen nga Mbikqyresi se bashku me Kontraktorin.
- Drenazhet dhe elementë të tjere të rrugës specifikuar sipas segmentëve të veçantë.
 - Si pjesë e dosjes të jene pamjet filmike të rrugës, foto dhe video qe do te realizohen nga Mbikqyresi se bashku me Kontraktorin.

Ne lidhje me inventarin e sinjalistikes rrugore duhet qe cdo muaj gjate hartimit te Akt – Kontrollit Mujor te konfirmohet nese ka ndryshime dhe te specifikohen ndryshimet.

c. Përshkrimi i Punimeve

Punimet që behen nderthurin punimet rehabilituese, të mirëmbajtjes(rutinë dhe dimërore) Punimet rehabilituese mbulojnë bankinat, dranazhimet dhe shtrimin e rrugëve që mund të përfshijnë këto zëra si trotualet, sinjalistikë dhe vijëzuesit, parapetet dhe punime të tjera që lidhen me punimet civile dhe që do standardizohen sipas Niveleve të Shërbimit Punimet rehabilituese që nevojiten përfshijnë disa apo gjithë zerat e meposhtëm:

- Artikujt e përgjithshëm sic janë specifikuar.
- Planifikimin e punimeve.
- Sigurimin e burimeve të materialit dhe zonat e hedhjes.
- Punimet tokesorë duke përfshire germimin dhe argjinaturen
- Akomodimin e rrjedhjeve/levizjeve të trafikut publik dhe të kërkesave të aksesit në zonën e punimeve sipas masave të duhura.
- Pastrimi i ndertimeve ekzistuese të kullimit dhe i kanaleve ekzistuese.
- Ndertimi i tombinove.
- Ndertimi i trotuarit duke përfshire nënbazën dhe bazën e shkëmbit të therrmuar dhe sipërfaqes prej betoni të asfaltit.
- Instalimi i elementëve karakteristikë për punimet rrugore ,pajisjet rrugore, duke përfshire pengesat e celikta/ mbrojtset metalike, shenjat e trafikut dhe simbolet, etj.
- Nderhyrjet shtese për punimet kryesore.

Punimet e mirëmbajtjes përfshijnë gjithë punimet që duhen për të ruajtur rrugët e kontratës në nivelet e parapërshkruara të Shërbimit.

Përkufizimet shtese janë siguruar nëpërmjet dokumentave kryesorë të kontratës.

2. Termat

Asfalti

Një përzirje e proporcioneve të paracaktuara të materialit për beton, materialit të mbushesit (të përdorur për përzirje trashesie) dhe kordonit bituminoz të përgatitur për rrugen dhe që plotëson disa kërkesa specifike të pjeseve fizike të materialit miks; të vendosur zakonisht me anë të makinave të shtrimit të rrugës .

Sipërfaqja e asfaltit

Shtresa ose shtresat e asfaltit të ndertuara mbi bazën, dhe në disa raste, buza e karrexhatës/rruges

Baza; lenda e bazës

Një shtrese materiali që shtrihet menjëhere poshtë sipërfaqes- shtrese e ndertuar mbi nën-bazën.

Rruga e kalimit nga mjetet

Sipërfaqja që kalohet normalisht nga automjetet dhe që konsiston në një ose në një numër korsish trafiku afer njera-tjetres, duke përfshirë korsitë ndihmëse dhe buzët e rrugës.

Kullimi i ujit

Një pìrg apo kanal kullues gjatësor jashtë prizmit të rrugës i përdorur për të devijuar ujin që përndryshe do të rridhte në prizmin e rrugës.

Kanalet nënrrugorë

Cdo ndertim i paklasifikuar si ure që jep një hapje sipas një kalimi nënrrugor.

Pjeset e lëna/ të carat

E cara do të nënkuptojë të gjitha gërmimet nga prizmi i rrugës, duke përfshire kanalet kulluese anësorë, gërmimet nyjat hekurudhore dhe shtigjet e parkimit, dhe, aty ku klasifikohet si e çarë, gërmimet për kanale kullimi të hapura.

Mbushja

Ai porcion i prizmit të rrugës që konsiston në material importi të aprovuar i cili shtrihet mes shtratit të rrugës dhe lidhet nga tatëpjetat anësorë, të treguara në seksionet e kryqëzuara tipike tek skicat në drejtimet tatapjetë dhe jashtë nga anët e rrugës që janë për tu ndertuar. Materiali i importuar për të zevendesuar materialin e papërshtatshëm në shtratin e rrugës, do të klasifikohet gjithashtu si mbushje.

Kanalet kulluese të hyrjes dhe daljes

Kanalet që të çojnë tek ose që shkarkojnë nga kanalet nënrrugorë, dhe urat.

Korsia

Pjesë e një rruge mbi të cilën është kaluar vetëm për një nivel trafiku në një drejtim, i cili

është shenuar si i tillë nga shenjat përkatëse rrugorë.

Sasia

Një porcion i konsiderueshem pune ose sasi material i cili vlerësohet si njësi për qëllimin e cilësise se kontrollit dhe është përzgjedhur për të përfaqësuar material apo punë të prodhuar nga të njëjtat procese dhe materiale në thelb.

Shtresat e trotuarit

Shtresat e sipërme të rrugës që përmbajnë shtresat e zgjedhura, nënbazën, bazën, ose vijat e shtruara, dhe shtresat e anësorëve të rrugës.

Shtrati i rrugës

Materiali normal në vendin e punimit ku do të kryhet mbushja ose në mungese të mbushjes ndonjë shtresë trotuari..

Prizmi rrugor

Ai porcion i ndertimit të rrugës i përfshire mes nivelit origjinal të tokes dhe kufijtë e jashtëm të pjerrësive të mbushjeve, të carave, dhe kanaleve kulluese anësore. Ajo nuk do të përfshije shtresen e zgjedhur, nënbazën, bazën, sipërfaqen, buzet anësorë ose shtratin e rrugës ku këto rrijnë mbi token origjinale por duhet të përfshijnë vellimin e tyre deri në hapësirën që ato të shtrihen nën token origjinale dhe germimi të mund të kryhet për të lejuar ndërtimin e tyre.

Veglat

Kabllo, tubat, ose ndertimet/pjesët tjera, tubat për elektricitetin, lidhjet e telefonit dhe telegrafit, uji, ujrat e zeza etj.

Kanali kullues anësor

Një kanal kullues gjatësor i hapur i vendosur afer dhe në pjesen e fundme të së çares ose të tatëpjetave të mbushura.

Buza e rrugës

(a) Kur i referohemi kësaj si një sipërfaqë: zona mes buzës së jashtme të rrugës së shkelur dhe pikës së keputjes të anës së rrugës.

(b) kur i referohemi kësaj si një shtrese trotuari: trotuari i sipërm që shtrihet mes buzës së jashtëme të bazës dhe pikës së thyerjes së buzës së rrugës.

Pika e thyerjes së buzës së rrugës

Vija përgjatë së ciles, planet e shtrira të sheshta të sipërfaqës së buzës së rrugës dhe tatëpjeta e jashtme e mbushjes dhe trotuari kryqëzohen. Kjo buze është normalisht e rumbullakët në një rreze të paracaktuar.

Prishja (Materiali)

Materiali original tokësor që vjen nga punimet e ndertimit dhe që nuk përdoret për qëllime ndertimi. Në përgjithsi, është padyshim një material i marrë nga germimi i cili

ose plus kerkesave ose i papërshtatshem për përdorim në punime.

Stabilizimi

Trajtimi i materialeve të përdorura në ndertimin e shtratit të rrugës, mbushjes ose trotuarit nga shtimi i ngurtësimit cimentoz si gëlqerja ose cimetonja e portland ose modifikimi mekanik i materialit nëpërmjet shtimit të një ngurtësuesi dheu ose kordoni/ngurtësuesi bituminoz. Asfalti dhe betoni nuk do të konsiderohen si materiale që janë stabilizuar

Nënbaza

Shtresa e Materialit në maje të shtresave të zgjedhura ose mbushjes dhe nën bazën e buzeve të rrugës.

Rruga që kalohet nga mjete

Ajo pjese e rrugës ku kalohet me mjete e cila përfshin korsi të ndryshme trafiku dhe korsi ndihmese por përjashton buzet e rrugës.

3.Mjeshtëria dhe Kontrolli i Cilësisë

Përgjegjësia i takon kontraktuesit për të furnizuar materiale dhe për të prodhuar punë që përputhet në cilësi dhe saktësi detajesh me të gjitha kerkesat e specifikimeve dhe skicat, dhe kontraktuesi – me shpenzimet e tij- do të ngreje nje sistem kontrolli të cilësisë si dhe të sigurojë inxhinierë me eksperiencë, përgjegjes, mbikqyrës, teknike materiali, teknike të tjerë dhe staf tjetër teknik, sëbashku me të gjithë transportin, mjetet dhe pajisjet, për të siguruar supervizim të saktë dhe kontroll pozitiv të punimeve në cdo kohë.

4.Dorëzimet tek Mbikqyrësi

Kurdo që kontraktuesit i kërkohet ti paraqesë Mbikqyresit i Punimeve propozime, programe, detaje, skica, llogaritje, informacion, literaturë, materiale, raporte testesh dhe vertetime, Mbikqyrësi do ta marrë parasysh cdo paraqitje, dhe nëse duhet, do ti përgjigjet kontraktuesit në përputhje me dispozitat përkatëse të kushteve të kontratës. Cdo paraqitje do të behet në datat e rëna dakord me Mbikqyrësin e Punimeve duke patur parasysh programin e aprovuar dhe nevojën për ti dhënë vetes kohën e duhur për të shikuar cdo paraqitje.

Aprovimi i Mbikqyresit i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktuesin nga përgjegjësitë e tij sipas kontratës.

5.Mirëmbajtja e rrugëve dhe ndertimeve ekzistuese

Kontraktuesi do të mirëmbajë të gjitha rrugët dhe ndertimet ekzistuese duke përfshire pajisjet e rrugës se tërthortë, nga fillimi i punimeve deri në fund të kontratës dhe/ose datën kur hapen seksionet për trafikun publik. Sipërfaqet e rrugës se mjeteve, kanalet kulluese dhe ndërtimet dhe cdo ndricim brenda kufinjve të kontratës (qoftë ekzistuese apo të rikonstruara), do të mbahen në rregull dhe të lirë nga defektet e dukshme gjatë

përiudhes se punimeve deri në leshimin e certifikatës se përfundimit të punimeve.

6. Materialet dhe artikujt e prodhuar

Përpara se të bëhet ndonje porosi për materiale dhe sende të prodhuara për tu futur tek punimet, kontraktuesi do ti paraqesë Mbikqyresi i Punimeve emrat e firmave nga të cilat propozohet të merren keto materiale dhe artikuj të prodhuar. Për sejcilin furnizues detajet do të përfshijnë një përshkrim të materialeve dhe artikujve që do të furnizohen, origjina e tyre, specifikimi i prodhuesit, cilësia, pesha dhe të dhënat e fortësise dhe cdo detaj tjetër përkatës. Kontraktuesi do të depozitojë me Mbikqyrsin e Punimeve, shembuj/mostra të ketyre materialeve dhe artikujve kur kerkohen dhe kur duhet, vërtetimet e prodhuesit për testet e fundit të bera për artikuj të ngjashëm.

7. Njoftim i nderhyrjeve

Asnjë veprim nuk do të kryhet pa njoftim të plotë të dhënë për Menaxherin e projektit nga kontraktuesi. Kjo do të jetë mjaftueshëm në avance të kohës se planifikuar të veprimit sa për ti mundësuar Mbikqyresi i Punimeve të bëjë ndonjë rregullim të nevojshëm për inspektim dhe kontroll. Për cdo fazë të punimeve që do të kontrollohet, do të bihet dakord me Mbikqyrsin e Punimeve.

Kontraktuesi do ti japë Mbikqyresi i Punimeve jo më pak se një ditë të plotë pune para – njoftimit me shkrim për qëllimin e tij për të vendosur ose dhënë nivelet e ndonjë/cdo pjese të punimeve në mënyrë që të behen rregullimet për kontrollin.

8. Punimet e Përkohshme

Për të gjitha punimet e përkohshme, kontraktuesi do ti paraqesë Mbikqyresi i Punimeve skicat që tregojnë rregullimin/sistemimin e përgjithshëm të punimeve të përkohshme (me diagrama dhe përshkrime që tregojnë se si propozohet që të ata të zbatohen) dhe si përshtaten ata në programin e përgjithshëm për punimet permanente.

Tëresia e punimeve të përkohshme duke përfshirë impantin dhe pajisjet për tu përdorur, do të jenë përgjegjësi e kontraktuesit në lidhje me ndertimin e tyre, mjaftueshmerinë, sigurinë, mirembajtjen dhe heqjen me përfundimin e kontratës. Ekzaminimi nga Mbikqyresi i propozimeve të punimeve të përkohshme të kontraktuesit apo nënkontraktuesit të tij apo i ndonje projekti apo skice që lidhet me të, nuk do ta përjashtojë kontraktuesin nga ndonjë përgjegjësi/detyrim i vendosur mbi të sipas kontratës.

Nuk do të bëhet pagesë vecan për koston e përputhjes me kerkesat e kësaj pike dhe kontraktuesi mendohet të ketë mbuluar koston për plotësimin e ketyre kerkesave në vlerat e tij për punimet.

9. Informacioni i dhënë nga punëdhënësi

Cdo informacion që përmbahet në dokumentat e kontratës ose i dhënë vecmas, ofrohet në mirëbesim por në rrethana që i përkasin llojit të informacionit të dhënë, nuk mund të jepet garanci që informacioni është padyshim i saktë ose përfaqësues në kushtet e vendit të punimeve.

Punëdhënësi nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi për saktësinë e informacionit të siguruar për ndonjë dëmtim që mund të rezultojë, qoftë direkt apo si pasojë vijuese që do të shfaqet gjatë kohës së kontratës, qoftë edhe si pasojë e nje informacioni të pasaktë. Cdo masë e marrë nga kontraktuesi në këtë informacion do të jetë në rrezik të vetë atij.

10. Kërkesat e përgjithshme të ndertimit

Do të zbatohen kërkesat e përgjithshme të mëposhtme:

1. Kur puna e natës është autorizuar nga Mbikqyrësi, Kontraktori do të furnizojë me ndicimin e përkohshëm të duhur dhe do të sigurojë e të instalojë ndonje ndricim shtese që mund të kerkoje Mbikqyrësi në menyre që të supervizohen punimet dhe të kryhen testimet dhe ekzaminimet e materialeve.

2. Materialet e sjella në këtë vend punimesh (duke përfshire cdo material që duhet të jetë i disponueshem ose i furnizuar nga punëdhënësi) do të përdoren vetëm për zbatimin e punimeve.

3. Kontraktori do të marrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me:

-Cdo kanal kullimi apo vijë uji për të parandaluar baltën, përmytjen, erozionin e shtretërve dhe brigjeve dhe ndotjen e ujit që mund të ndikojë në menyre të ndersjelltë cilesinë e paraqitjes ose mund të shkatojë dëmtim tek njerezit, kafshët apo jeta bimore.

-Burimet ujore nëntokesore (duke përfshire ujin që i dihet venburimi) për të parandaluar cdo ndërferencë me pajisjen ose shkeputjen nga burimet dhe do të sigurojë që në asnjë menyre veprimet e tij nuk ndotin ose nuk ndikojnë ndersjelltas cilesinë e tij.

4. Kontraktori duhet të sigurojë, të mirëmbaje dhe të heqë, me përfundimin e punimeve, pellgjet e mbeturinave dhe pajisjet tjera të ndertuara për të minimizuar ndotjen si pasojë e veprimeve të operatorit.

5. Kontraktori do të sigurojë, të mirembajë e të heqë, me përfundimin e punimeve, gardhin e duhur rreth pjesëve të vendit të punimeve duke përfshire masat e duhura të sigurisë për rruget e aksesit. Kjo do të përmbushet pa ulur në asnjë menyre detyrimet e tij për mirëmbajtjen e aksesit të lirë nga punëdhënësi, Mbikqyrësi dhe/ose kontraktorë të tjerë apo persona të tjere që kanë të drejtë për këtë akses.

6. Kontraktori do të jetë përgjegjes për tu njohur me dhe për vezhgimin e të gjitha

dekreteve shtëtërore, urdheresave ose rregulloreve që përfshijnë ato që lidhen me taksat, rregulloren e shendetit dhe sigurise, ruajtjen mjedisore dhe taksimin e të punësuarve.

11.Mbrojtja nga uji

Kontraktori do të jetë përgjegjes për të marrë masa për ujin, qoftë nga kanalet kulluese ekzistuese, rrjedhjet ujore, burimet nëntokesore, rreshjet, efektet e batices apo ndonje burim ose shkak tjetër. Në shkarkimin dhe devijimin e ujit, masat duhet të jenë në vend për shmangien e përmytjes ose të demtimin të punimeve apo sherbime tjera, erozionit dhe/ose ndotjes.

Kontraktori do të mbajë tëresinë e punimeve të lire nga uji, dhe do të sigurojë të gjithë molet, vendet e rrethuara me lume, pompimin, platformen mbi shtylla, brigjet.cadrat, kanalet kulluese të përkohshme, ulluqet e shkarkimit, etj të nevojshme për këtë qëllim. Aty ku është e mundur, punimet do të programohen në menyrë që nevoja e kanaleve kulluese të përkohshme, terreni original, janë pjesërisht të parandaluara nga punimet në periudha të thata.

Nga shumat e tij, kontraktuesi do të llogarise të gjitha kostot për tu marrë me ujin duke përfshire ato për të marrë masat e nevojshme për të parandaluar demtimin si pasojë e erozionit dhe baltave gjatë ndertimit. Masat do të përfshijnë kryerjen e përkohshme të kanaleve të kullimit, kontrollet e pastrimit, gurët e thyer, etj. Materiali i prishur ose rezervë do të derdhet për të mos nderhyre në rrjedhjen, vijat ujore ose në ndonje nga sistemet kulluese të ujit.

Me mbylljen e punimeve cdo ditë, sipërfaqja e cdo shtrese të përfunduar do të rregullohet në menyrë që pellgu dhe rreshqitja e sipërfaqes të mos ndodhin. Cdo demtim i punimeve ose i pronave afër tyre, që rezultojnë nga dështimi i kontraktuesit për të marrë masat e nevojshme, do të plotësohet me shpenzimet e kontraktuesit.

Nuk do të bëhet pagesë e vecantë për koston e përputhjes me kerkesat e kesaj pike dhe kontraktuesi mendohet që ti ketë mbuluar kostot për plotësimin të ketyre kerkesave nga shumat/vlera e tij e punimeve.

12.Mbrojtja e sherbimeve komunale ekzistuese

Kontraktuesi duhet të dijë pozicionin e të gjitha sherbimeve ekzistuese si, kullimet e ujërave sipërfqësore, kabllot për elektricitetin dhe telefonin, shtyllat e ndricimit, tubacionet kryesore të ujrave etj para se të fillojë ndonje germim apo punim tjetër që mund të prekë sherbimet ekzistuese. Per kete Kontraktori para fillimit te punimeve duhet te njoftoje me shkrim Autoritet pergjegjese si OSHE, Albtelekomin, Drejtorine e Ujesjelles – Kanalizimeve etj. Sipas perkatesise. Kontraktori nuk mban pergjegjesi per linja nentokesore e mbitokesore te paligjshme (pa autorizim nga Autoriteti Rrugor

Shqiptar).

Skicat e kontratës tregojnë vendin e shërbimeve komunale ekzistuese. Informacioni i dhenë në keto skica tregon vetëm vendndodhjen e përafert të tyre. Kontraktuesi sëbashku me një përfaqësues të agjensive të shërbimeve komunale individuale do të verifikojë ekzistencën dhe vendndodhjet e sakta të të gjithë shërbimeve komunale publike të prekura nga punimet e përkohshme apo të përherëshme duke përfshirë por pa kufizim:

- Tubacionet kryesore të ujit, lidhjet e shërbimit dhe pusetat
- Kabllot mbitokesore me voltazh të mesëm dhe linjat e shtylles që lidhen me keto.
- Kabllot nëntokesore me voltazh të mesëm.
- Kabllot mbitokesore me voltazh të ulët dhe linjat e shtylles lidhur me keto.
- Nënstacionët dhe kapanxhat elektrike.
- Kabllot telefonike mbitokesore dhe linjat e shtylles lidhur me keto.
- Kabllot telefonike nëntokesore.
- Kutitë telefonike dhe kutitë e komutatorit.
- Pajisje të tjera të përziera sic drejtohet nga menxheri i projektit.

Kontraktori do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim të punimeve ekzistuese apo shërbimeve (me autorizim nga ArrSh) dhe do të demshpërblejë punëdhenësin kundrejt çdo ankese lidhur me këtë (duke përfshirë edhe dëmtimet pasuese). Kontraktori do të jetë përgjegjës për ricaktimin e çdo shërbimi të prekur në këtë mënyrë.

Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet në gërmimin, rimbushjen dhe në bërjen kompakte të materialeve afër tubacionëve kryesore, kabllëve etj dhe për të lenë elementë si metrat ujore, kutitë e rubinetave etj. Kujdesi i kontraktorit i kushtohet rregullores që është në fuqi në Shqipëri në lidhje me boshllëqët/hapësirat e sigurisë së punimeve nga kabllot që kanë voltazhe të ndryshme për veprime që do të kryhen afër linjave mbitokësore të energjisë.

Pavarësisht nga kërkesat e mesipërme dhe pa pakësuar përgjegjësinë e kontraktorit, ai do të informojë Mbikqyrsin e Punimeve menjëherë nëse ekspozohet, vendoset apo dëmtohet ndonjë punim apo shërbim ekzistues. Të gjitha punimet që duhen të kryhen për të korigjuar ndonjë dëmtim të shkaktuar tek shërbimet komunale do të behen sipas pelqimit të agjensisë së pronarit apo Mbikqyresit të Punimeve dhe me shpenzimet e kontraktuesit.

Të gjitha kostot të cilat mund të shkaktohen nga kontraktori si rezultat i programimit dhe koordinimit të punës për të mundësuar ndryshim të shërbimeve që do të kryhen dhe kostoja e çdo paralajmërimi të sigurisë i cili mendohet si i nevojshëm si pasojë e afërsisë së punimeve tek fuqia apo linjat e shërbimeve komunale do të jenë me shërbimet e kontraktuesit.

Asnjë pagesë e veçantë nuk do të bëhet për koston e përputhjes me kërkesat e kesaj pike në lidhje me shërbimet komunale të cilat nuk do të devijohen në mënyrë të përhershme, të hiqen apo të braktisen si pjesë e punimeve dhe kontraktuesi mendohet të ketë mbuluar koston e plotë për plotsimin e të gjitha kërkesave të përkohshme me vlerat/shumat e tij për punimet.

13..Devijimi i sherbimeve komunale

Kontraktori do të jetë përgjegjes për rregullimin/sistemimin, në kordinim me Autoritetin e duhur, sapo të njihet kërkesa për levizjen apo ndryshimin e sherbimeve qoftë për punime të përkohshme apo të përhershme. Keto mund të përfshijnë enërgjinë, linjat telefonike, tubacionë kryesore të ujit, kanalizimet dhe kanale kulluese sipërfaqësore të ujit. Sistemimet për ndonje zhvendosje apo ndryshim do të jenë subjekt i aprovimit të pronarit të agjensisë së pronarit dhe Mbikqyresi i Punimeve. Kontraktuesi do të lejoje kohen e duhur në program për njoftimin dhe ekzekutimin e punimeve të sherbimeve komunale sic është renë dakord me Autoritetin e duhur.

Aty ku puna e autorizuar do të kryhet nga vetë forca e punes se agjensise, kontraktuesi do të kordinojë dhe lehtësoje punimet.

Në rastin kur furnizimi me uje pritet kur levizet apo ndryshohet nje tubacion kryesor i ujit, atëhere kontraktuesit do ti kerkohet të furnizojë me uje të pijshem për ndonje banor të prekur nga të tilla punime.

Pagesa për marrjen me sherbime komunale ku keto sherbime komunale kerkojnë rivendosje permanente do të behet me vlerat në faturat e sasive dhe ato vlera do të përfshijnë të gjithë koston e zbatimit të punimeve të kërkua. Aty ku diversioni apo rivendosja janë të përkohshme për të lejuar kontraktuesin të zbatoje punimet por nuk kerkohet rivendosje përmanente, kontraktuesi mendohet ti ketë mbuluar koston e plota për plotësimin e kërkesave të përkohshme në vlerat e tij për punimet në përputhje me paragrafin paraprires.

Kontraktorit i kujtohet se sherbimet komunale të treguara tek skicat do të konsiderohen si tregues të sherbimeve komunale në cdo vend dhe se mund të ketë të tjera presente që nuk tregohen tek skicat. Eshtë përgjegjësi e kontraktorit të konstatojë shtrirjen e plotë të shërbimeve komunale në cdo vend punimi dhe të japë nga shumat e tij për punimet për koston e bërjes së tyre.

14. Koordinimi me qeverinë dhe nëpunësit e policisë

Kontraktuesi do të konsultohet me nëpunës të policisë dhe qeverisë në fushën që i përket kërkesave të tyre për kontrollin e trafikut dhe çështjeve tjera. Kjo mund të çojë tek dhënia e asistences dhe masës se lehtësirave që mund të kerkohen nga këta nëpunës për zbatimin e detyrave të tyre në lidhje me punimet.

Asnjë pagesë e vecantë nuk do të bëhet për koston e përputhjes me kërkesat e kësaj pike dhe kontraktuesi mendohet të ketë mbuluar koston e plotë për plotsimin e të gjitha kërkesave të përkohshme me vlerat/shumat e tij për punimet.

15. Furnizimi me ujë

Kontraktuesi do të sigurojë një furnizim me ujë të pastër, të mjaftueshem dhe të vazhdueshem – për ndertimin e punimeve dhe për të gjitha shtëpitë, zyrat, laboratorët dhe repartët e punës. Kontraktuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për berjen e sistemimeve (duke përfshirë tubacionët dhe kontatoret e nëvosjhem për lidhjen me tubacionët kryesore të ujit) dhe sigurimin e pompave, ruajtjen e rezervuareve apo mjetëve të transportit të ujit ku është e nevojshme dhe për pagesën e të gjitha tarifave dhe pagesave të ujit dhe për heqjen e kenaqëshme të këtyre sistemimeve dhe dispozitave me përfundimin e punimeve.

Uji do të jetë i pastër nga mbetjet solide dhe pa asnjë artikull në sasi të konsideruar nga Mbikqyrësi si i dëmshëm për punimet. Uji i siguruar/sjellur në zyra, laboratore dhe shtëpi do të jetë me shumice dhe i pijshëm sipas aprovimit të nëpunësit mjeksor në zonën apo sipas ndonjë Autoriteti tjetër sic mund të thotë Mbikqyrësi.

Asnjë pagesë e vecantë nuk do të bëhet për koston e përputhjes me kërkesat e kësaj pike dhe kontraktori mendohet të ketë mbuluar koston e plotë për plotësimin e të gjitha kërkesave të përkohshme me vlerat/shumat e tij për punimet.

16. Moti i pafavorshëm

Kontraktori do të pranojë si të vertetë të gjithë risqet e vonesave në përfundimin e punimeve që mund të shkaktohen nga moti, duke përfshirë (por pa u kufizuar nga):

- Renien shiu me sasi me të madhe se ajo e pritur që ndalon, pengon ose vonon punimet;
- Periudha temperaturash më të ulëta apo me të larta se sa temperaturat e pritura që shkaktojnë një ngadalesim në veprime;
- Ererat jashtëzakonisht të forta dhe ndonjë drejtim të parashikueshem ere që shkakton ndërprerje të punimeve, demtim të pajisjeve, materialeve dhe mjeteve/godinave si dhe humbje kohe si pasoje e riparimeve ose zvendesimeve të punimeve dhe pajisjes.

17. Heqja e kampeve

Me mbarimin e kontratës dhe pas marrjes së aprovimit me shkrim nga Mbikqyrësi, kontraktuesi do të largojë (çmontojë) dhe të heqë të gjithë ndërtimet e perkohshme që formojnë një pjesë të punimeve dhe do të bëjë planin për shkëputjen e furnizimit me ujë dhe elektricitet, heqjen e shërbimeve të përkohshme të kullimit dhe do të pastrojë kanalet dhe gropat e ujërave të zeza.. Kontraktuesi do të riparojë vendin e punës, sa më shumë të mundet, dhe ta kthejë në gjendjen origjinale dhe ta lejë atë në gjendje të pastër dhe të rregullt.

Programi i kontraktorit

1.Përshkrim

Kontraktori do sigurojë një program dhe metodikë punimesh për të kryer punimet rehabilituese për secilën rrugë ku nevojitet ky rehabilitim. Ky seksion shpreh kërkesat dhe procedurat për përgatitjen dhe dorëzimin e programit paraprak të Kontraktorit dhe programin pasues të detajuar dhe ecurinë treguese si edhe kërkesat që kanë të bëjnë me rifreskim dhe përmbledhje të gjithë këtyre.

2.Të përgjithshme

Programi i Kontraktorit do përdoret nga Kontraktori që të planifikojë dhe ekzekutojë punimet Rehabilituese. Programi do përdoret gjithashtu nga Mbikqyrësi për të monitoruar ecurinë dhe për të qënë baza e vlerësimit të vonesave mbi ecurinë e Punimeve.

Programi do përgatitet nga Kontraktori në fazat e mëposhtëme:

Programi Fillestar. Një program që përmbledh në total punimet rehabilituese, që do dorëzohet të Mbikqyrësi për dijeni nga ana e tij. Nëse Mbikqyrësi nuk bie dakort me të pasi ky program s'përputhet me Kontratën, atëhere ky program do rishikohet dhe ridorëzohet serish. Kur të ketë renë dakort Mbikqyrësi mbi këtë program, atëhere ai do behet Programi i Miratuar.

3.Paraqitja e programit

3.1 Afatet kohore

Programi fillestar lidhet me datat e përfundimit të kontratës dhe me ndonjë tjetër moment, dhe /ose me kontrollet/përmbajtjet e paraqitura në kontratë.

Ky program behet programi i pranuar me pranimin nga ana e Mbikqyrësi i Punimeve. Programi i pranuar do të lidhet me datat e përfundimit të kontratës dhe me ndonjë tjetër moment, dhe /ose me kontrollet/përmbajtjet e paraqitura në kontratë. Prandaj, nëse mbarëvajtja aktuale nuk përputhet me programin e pranuar, Mbikqyrësi për aprovim/pranim ka të drejtë ti kërkojë kontraktuesit që ti paraqesë Mbikqyrësi i Punimeve për pranim një program të rishikuar që tregon rendin e procedurës dhe periudhat e nevojshme për të siguruar plotësimin e punimeve në datat e përfundimit të kontratës (në datën që specifikohet si data përfundimi të punimeve në kontratë.

3.2 Raportimet mbi metodiken e punimeve

Në të njëjtën kohë që kontraktuesi paraqet programin, kontraktuesi duhet ti paraqesë Mbikqyrësi i Punimeve për pranim një përshkrim të përgjithshëm të sistemimeve dhe metodave për ndertim dhe projektme punimesh të përkohshme që kontraktuesi propozon ti adaptoje për zbatimin e punimeve rehabilituese. Formulimi duhet ti referohet tërthorazi aktiviteteve në program.

Kontraktuesi duhet ti paraqesë Mbikqyresi i Punimeve informacion të mjaftueshem që mund të konsiderohet i nevojshëm me arsye nga ana e Mbikqyresi i Punimeve për të interpretuar, vlerësuar dhe dhënë pranim formulimit të metodes.

Kurdo që të kërkohet nga Mbikqyrësi, kontraktuesi duhet ti sigurojë atij për informacion vecori me të detajuara të formulimit të metodës se kontraktuesit.

Nëse kontraktuesi do të nderrojë një formulim metode ose në vijim Mbikqyrësi do ta quajë të arsyeshëm e të nevojshme këtë ndryshim të formulimit të metodës se ciles i është dhënë aprovim me përpara, atëhere kontraktuesi duhet të paraqesë një formulim metode të rishikuar tek Mbikqyrësi për pranimin e tij.

Pranimi/aprovimi i Menaxehrit të Projektit për formulimin e metodës se kontraktuesit nuk e ben këtë formulim metode një dokument të kontratës, ose mandat që punimet do të ndertohen në mënyrë strikte në përputhje me formulimin e metodes. Kontraktuesi, në cdo kohe, mbetet përgjegjës për ndërtimin e punimeve në përputhje me kërkesat e kontratës.

3.3 Miratimi

Brënda 10 ditëve punë të Kontraktuesit në pranimin e programit komplet me të gjithë informacionin e kërkuar për Mbikqyrësin e Punimeve për miratim, Mbikqyrësi do të pranojë programin ose do të japë arsyet për mospranimin e programit. Nëse jepen këto arsye, Kontraktuesi do të marrë përgjegjësinë e arsyeve dhe do ta riparaqesë programin brënda një periudhe kohre prej 10 ditë punë. Nëse Mbikqyrësi nuk e pranon apo e refuzon programin brënda 15 ditëve punë, Mbikqyrësi do të ketë menduar se ka pranuar programin ashtu si është paraqitur.

Mbikqyrësi gezon të drejtën të hedhe poshtë një program që tregon se punimet e përfunduara janë mbaruar me heret se data e përfundimit të kontratës nëse po i njejt program nuk është i saktë në vlere apo/dhe llogari.

Me marrëveshje, Kontraktuesi dhe Mbikqyrësi mund të shpërndajnë printimet e formave të ndryshme të programit të Kontraktuesit, por në asnjë rrethanë nuk mund të japin me paraqitjen e kopjeve elektronike të kërkuara.

3.5.Siguria e Publikut

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e publikut që kalon në sheshin e ndërtimit. Të gjitha gërmimet apo impiantët dhe gjëra të tjera që përbëjnë rrezik potencial për publikun duhet të kenë barrikada dhe të kenë të vendosura shenjat e duhura të kënaqshme për Mbikqyrësin e Punimeve dhe Kontraktuesi duhet të sigurojë roje të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e publikut gjatë gjithë kohës. Të gjitha rrugët ekzistuese për

këmbësorët do të ruhen në një gjëndje të mirë me përjashtim të rastit kur garantohet një rrugë tjetër alternative e kënaqshme për Mbikqyrsin e Punimeve. Uljet dhe ngritjet e përkohshme në rrugë duhet të jenë në një kënd dhe projektim të tillë që të garantojnë stabilitet dhe siguri duke i lejuar Materialet e përfshira.

3.6 Njoftimet për aksidentet

Kontraktuesi do të njoftojë menjëherë Mbikqyrsin e Punimeve në rastet kur ndodhin aksidentet (në shesh ose jashtë sheshit) në të cilin Kontraktuesi, personeli i tij, ose Impianti i Ndërtimit apo ato të nënkontraktuesve të tij janë të përfshirë direkt ose indirekt në dëmtimet ndaj këtyre njerëzve. Një njoftim i tillë mund të jetë verbal në fillim, por duhet të ndiqet nga një raport gjithëpërfshirës brënda 24 orëve që ka ndodhur incidenti.

Pjesa E

Siguria në rrugë dhe kontrolli i trafikut

1. Kërkesa të Përgjithshme

Kontraktuesi duhet t'i mbajë rrugët ekzistuese të hapura ndaj trafikut gjatë punimeve të ndërtimit por mund ta kalojë trafikun në një rrugë anësore me standarde të barabarta kur kjo e fundit të jetë miratuar nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për kostot e të gjitha shmangieve në rrugë.

Kontraktuesi duhet t'i mbajë rrugët që do të preken nga punimet të pastra nga dherat dhe Materialet e tjera të mbetura si dhe të sigurojë që zona e ndërtimit mund të akomodojë trafikun me siguri në çdo kohë. Kontraktuesi do të ngrëjë dhe mbajë shenja, barrikada, dhe të tjera mjete për kontrollin e trafikut siç mund të kërkohen për të drejtuar trafikun brenda dhe jashtë zonave të ndërtimit dhe siç tregohet në skemat e përkoheshme të Sinjalizimit – Kontrolli i Trafikut të Përkohshëm ose siç drejtohet nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi, pa kompensime shtese, do të zëvendësojë mjetet e kontrollit të trafikut që mund të humbasin, që mund të jenë vjedhur, shkatërruar apo konsideruar si të papranueshme kur është kërkuar përdorimi i tyre.

Gjatë orëve të pushimit dhe me përfundimin e punimeve të një ndërtimi, të gjitha shenjat e paralajmerimit, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për sigurinë e publikut, do të hiqen. Sipërfaqet e lyera dhe retro-pasqyruese tek shenjat, barrikadat dhe të tjera mjete do të mbahen të pastra, në gjëndje të mirë punë, si dhe të kenë gjithmonë aftësinë e tyre retro-pasqyruese. Masat, ngjyrat, mesazhet dhe vendndodhjet do të jenë me miratimin e Mbikqyrësi i Punimeve.

Kontraktuesi do të kujdeset gjatë gjithë kohës për të siguruar përshtatshmerinë dhe sigurinë e banorëve përgjatë rrugës apo ndonjë autostrade publike të prekur nga punimet. E drejta e hyrjes në afërsi të vendit të punimeve do të mbahet gjithmonë.

Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për hetimin dhe vendosjen e kërkesave për kontrollin dhe sigurinë e trafikut. Kjo përfshin familjarizimin me kushtet e trafikut,

rëndësinë e mbajtjes së sigurisë së trafikut dhe minimizimin e vonësive në trafik duke bashkëpunuar me agjensitë përkatëse për kontrollin e trafikut.

2. Masat për Kontrollin e Trafikut

Për të lehtësuar lëvizjen e trafikut dhe sigurinë në vendet e punimit që janë afër, Kontraktuesi do të furnizojë dhe do mirëmbajë shenjat e trafikut, dritat, barrikadat, konët dhe materiale të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga Mbikqyrësi.

Për kontrollin e duhur të trafikut siç nevojitet apo kërkohet ose drejtohet nga Mbikqyrësi, Kontraktori do të furnizojë dhe të vendose përsona me flamur, detyra e të cilëve do të jetë të drejtë lëvizjen e trafikut përmes ose anash punimeve. Me qëllim minimizimin e ndërprerjes së trafikut, Kontraktuesi mund t'i mbyllë me gardh përkohësisht pjese të sheshit, siç nevojitet për të siguruar një barrierë vizive midis zonës së punimeve dhe trafikut të afërt duhet:

- Panelet e shenjave do të jenë ngjyrë portokalli me legjendë të zezë me përjashtim të rastit kur specifikohet ndryshe.
- Postblloqët do të kenë dru të butë ose material tjetër të pranueshëm nga Mbikqyrësi.
- Shenjat duhet të jenë në gjëndje të qëndrojnë në pozicionin e tyre gjatë trafikut normal dhe kushteve me erë.
- Barrikadat dhe gardhet e përkohshme do të ndërtohen prej druri, metali ose plastike dhe të jenë të lyera me drejtim nga trafiku.
- Konet do të kenë një lartësi minimumi 75 cm me një bazë të zgjeruar dhe të jenë në gjëndje që të përballojnë impaktet pa dëmtime të koneve apo automjeteve. Të gjitha konet do të kenë ngjyrë portokalli/të bardhë, të jenë të dallueshme dhe të jenë në gjëndje të qëndrojnë në pozicionin e tyre në kushtet e trafikut normal dhe me erë.
- Dritat e paralajmerimit (elektrike, me ngjyrë, flash, nga të dyja anët) do të jenë ashtu siç do të miratohen nga Mbikqyrësi
- Mjetet e kontrollit të trafikut do të përdoren vetëm kur të jenë nevojat.

3. Numri i Korsive të Trafikut

Kontraktuesit i kërkohet të mbajë një sipërfaqë me standart të barabartë me atë të rrugës origjinale gjatë gjithë kohës, për sa i përket gjërësisë, kurbave, gradientit, dhe cilësisë së dhënies së makinës dhe të bëjëpunimetë duhura për të arritur këtë. Mbikqyrësi mund të miratojë një rrugë të përkohshme me shenja të sakta për shmangien e trafikut atëherë kur Kontraktori mund të vërtetojë se kjo nuk do të shkaktojë vonësa të panevojshme në qarkullimin e trafikut. Me një miratim të tillë, Mbikqyrësi mund të përcaktojë oraret kur mund të përdoret rruga me kapacitet të reduktuar. Nëse ndodhin vonesa shtese, Mbikqyrësi mund ta tërheqë miratimin e tij dhe në raste të tilla, Kontraktuesit i kërkohet që të rivendose standartet e rrugës origjinale brënda 48 orëve.

Kur me mendimin e Menaxherit Projektit, shmangia nuk është e arritshme, ndërtimi në rrugët publike ekzistuese do të bëhet vetëm në gjysëm e gjërësise se plotë të rrugës. Gjatësia e një rrugë me mbylljen e njërës gjysme do të minimizohet dhe gjërësia e korsise së përdorshme do të jetë jo më pak se 3.0m.

4. Punimet e Përkohshme Rrugore

Përpara se të ndërtohet një rrugë e përkohshme, Kontraktori duhet të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme, duke përfshirë këtu pagesen nëse kërkohet, me autoritet publike apo me pronarët e tokave në lidhje me përdorimin e tokës dhe duhet të marrë miratimin e Mbikqyesi i Punimeve. Të gjitha rrugët e përkohshme do të ndërtohen në përputhje me kërkesat e Mbikqyesi i Punimeve, por Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për çdo dëmtrim të shkaktuar nga përdorimi i këtyre rrugëve të përkohshme.

Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë për miratim Mbikqyesi i Punimeve projektet të cilat përmbajnë detajet e shtrirjes, shenjave, ndriçimit, profilit, cilësise se dhënies se makinës dhe kohëzgjatjes se rrugës se përkohshme si dhe mirëmbajtjen e tyre siç janë propozuar.

Kontraktori duhet të dorëzojë për miratim nga Mbikqyrësi, vizatimet që tregojnë detaje të plota të këtyre zërave sic propozohet për në trupin e rrugës, sinjalistike, ndricim, profilet, udhëtimin me makinë, dhe kohezgjatjes se rrugës në rrugët provizore si dhe rregullimet për mirëmbajtjen e modifikuar.

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme për të lejuar kalimin përgjatë rrugës se impiantit të ndërtimit, materialeve dhe personelit që i përket ndonjë kontraktuesi tjetër të përfshirë në këto punime ndërtimi. Kontraktori duhet të furnizojë, mirëmbajë dhe heqë me përfundimin e punimeve të gjitha rrugët e përkohshme dhe duhet të pastrojë dhe ta kthejë tokën në përputhje me kërkesat e Mbikqyesi i Punimeve.

5. Ndihma ndaj Mbikqyesi i Punimeve

Kontraktori duhet të garantojë bashkëpunim të plotë dhe ndihmen e tij në të gjitha aspektet e kontrollit të sigurise se trafikut dhe mjedisit të kryera nga Mbikqyrësi apo Punëdhënësi.

Pjesa F

Kontrolli i cilësisë

Përshkrim

Kjo pjese përshkruan kërkesat për arritjen e cilësisë.

Kontraktuesi mban përgjegjësi për cilësinë e kontrollit të ndërtimeve, materialeve, prodhimet dhe instalimet që përfshijnë punimet. Kontraktuesi duhet të vendosë dhe mbajë një sistem kontrolli cilësie efikase. Sistemi duhet të jetë i përshtatshëm në mënyrë që të mbulojë të gjitha veprimet.

1. Miratimi

Kur Kontraktorit i kërkohet të paraqesë mostra materialeve apo përzjerje Mbikqyesi i Punimeve për miratimin paraprak të tyre, duke qënë të përdorura në Punime, përdorimi i këtyre materialeve apo përzjerësve pa miratimin me shkrim të Mbikqyesi i Punimeve do të krijojë mosplotësimin nga ana e Kontraktorit i cili do të përgjigjë për rrjedhimin e një mosplotësimi të tillë. Të gjitha mostrat do të paraqiten në kohën e duhur për testimin e përshtatshëm nga laboratorit i pavarur i testimit.

Miratimi i Mbikqyesi i Punimeve për çdo material dhe përzjerje nuk do të lehtësojë në asnjë mënyrë Kontraktorin nga obligimi i tij për të garantuar materialet, përzjerjet dhe mjeshtërinë në përputhje me specifikimet dhe vizatimet..

Ndonjë material prodhuar që duket kontradiktor me materialin e njëjtë të miratuar do të krahasohet dhe testohet dhe do t'i nënshtrohet një procesi të ri miratimi, vetëm në rast se ky material hiqet vullnetarisht dhe zëvendësohet ose korrigohet.

2. Inspektimi dhe Prova

Inspektimi i testimit është i ndarë në dy kategori:

- Inspektim në shesh ose i përditshëm dhe testim;
- Inspektimi jashtë sheshit dhe testim.

1. Inspektimi në terren dhe testimet

Inspektimi në terrenin e punës do të kryhet brënda kantierit ku kryhen punimet. Ndersa testimet e materialeve do të kryhen rregullisht nga laboratorit i vendosur për këto teste i cili miratohet nga Mbikqyrësi.

2. Inspektimet jashtë terrenit dhe testimet

Kontrata mund të përfshijë testimet jashtë terrenit dhe inspektimin për pajisjet dhe Materialet e identifikuara në specifikime. Testimi dhe inspektimi jashtë terrenit do të realizohet në prani të Mbikqyesi i Punimeve.

Kontraktori do të japë shënimin e posaçëm me shkrim tek Mbikqyrësi në jo më pak se 28 ditë përpara se shkëmbimet e inspektimit jashtë vendit të kërkohen dhe do të sigurojë për prodhuesin, një hyrje të sigurtë dhe lehtësi si dhe të

bashkëpunojë me personelin e inspektimit në përmbushjen e detyrave të tyre.

3. Matjet dhe Pagesa

Kontraktori është plotësisht përgjegjës për të gjitha testet e kërkuara për të siguruar besueshmërinë që materialet që ai furnizon dhe puna që bën është në përputhje me kriteret e kërkuara. Kontraktori është plotësisht përgjegjës për të gjitha kostot e një testimi të tillë.

Laboratori testues i pavarur është në të mirë të Kontraktorit për ta lehtësuar nga nevoja e marrjes së pajisjeve të shtrenjta e shpesh shumë të përdorura në shesh për të bërë teste që nuk kërkohen rregullisht. Kostoja e testeve të tilla, apo e grupeve të testeve të tilla, do të mbarten nga Kontraktori. Kostoja e shoqëruar e mostrave, transportit të mostrave, dhënia e ndihmës dhe gjëra të tilla do të jenë vetëm në përgjegjësi të Kontraktorit.

Pjesa G

Menaxhimi ambjental

1.Përshkrim

Punëdhënësi merr përsipër të mbroje ambientin dhe të drejtoje aktivitetin e tij të përditshëm në një mënyrë ekologjikisht përgjegjëse dhe të ndaloje apo pakësoje në minimum efekte të mundshme ambientale negative të lidhur me ndertimin e rrugës. Kontraktuesi është i detyruar të respektojë të gjitha rregullat, politikat dhe procedurat në fjalë të ambientit përcaktuar nga ligjet dhe rregullat që janë përcaktuar në vendin tonë për mbrojtjen e ambjentit.

Nëse një plan menaxhimi ambjental (PMA) është përpunuar, zhvilluar për këtë kontratë, kontraktuesi është i detyruar të zbatojë dispozitat si dhe gjithë procesin e ndertimit. Apo nëse nuk ekziston një PMA , kontraktuesi duhet të kenaqë totalisht kërkesat e treguara sa vijon. Shumë nga kërkesat ambientale janë të përfshira direkt në pika specifike , megjithatë kontraktuesi është njoftuar se cdo pikë sa poshtë vijon duhet të jenë korrektësisht të vezhguara në të gjitha zbatimet e projektit dhe të gjithë kostot e mbledhjes , të gjitha kostot e mbledhjes ambientale janë konsideruar të jenë përfshirë tek kontraktuesi të kuotuar taksa cmime, ku ekziston një mundësi për të paguar.

Punëdhënësi rezervon të drejtën e autorizimit të pavarur të monitorimit të ambientit që zhvillohet gjatë gjithë periudhes së punës .Monitoruesit do të referojnë shkelje të dukshme të kërkesave ambientale punëdhënësit dhe inxhinierit, stafi inxhinierik dhe për të monitoruar kërkesat ambientale ditë pas ditë.

2.Rivendosja (ribimësia)

Të gjitha prerjet dhe pjerresitë e argjinatures dhe prishjet e përgjive dhe shpatet në gropat e thella të huazuara dhe zonat e fushave dhe cdo punim përkohshëm duhet të rivegjetohet me bime,shkurre dhe lendina aprovuar nga Inxhinieri. Në përfundim të punimeve nuk do ekspozohen, terrene mbetëse të pavegjetuara në të dy punimet e

përkohshme apo të përhershme të punimeve, nder të cilët vendbanimet e fushave, stacionet e punimeve, etj. Në ato bankina që janë me tëpër se 3 metra të larta do merren masa që të vendosen shkurre e pemë të vogla pas bankinës deri në një lartësi prej 1.5 metrash.

3. Nivelet e zhurmave

Paisje me nivel të lartë të zhurmës duhet të limitohen për të punuar nga 08-18 dhe do menaxhohen vetëm në ditët normale të punës. Frenimi i nivelit të zhurmes mund të zbutet nga Inxhinieri nëse ai është i bindur se pozicioni i influencuar është krejtësisht larg rrezes degjimit dhe nga cdo komunitet potencialisht i influencuar. Niveli i lartë i zhurmes se paisjeve duhet të karakterizohen si paisje që prodhojnë një nivel zhurme me të lartë se 90db në një distance 10 m në kushtë normale punë. Në se është drejtuar keshu, kontraktuesi përdor barriera antizhurmë për të mbrojtur sektorët kritike (shkolla spitale etj) nga efekte të nivelit të lartë të zhurmes.

4. Rrugët e aksesit

Të gjitha hyrjet në zonat e përkohshme të zena nga ana e kontraktuesit duhet të jenë të drejtuara me qëllim evitimin e dëmeve mjedisore. Të tilla rrugë duhet të aprovohen nga Inxhinieri para se të krijohen. Nëse e sheh të arsyshme inxhinieri miraton dhe jep keshilla nga pikpamja ambientale para aprovimit të të tilla rugeve.

5. Rrugët hyrëse në prona

Të gjitha hyrjet e pronave ekzistuese, rrugët duhet të respektohen në cdo moment të zbatimit të punimeve. Kudo që prona ka një hyrje ekzistuese kontraktuesi duhet të sigurojë përmes disponibilitetit të punimeve të përkohshme adekuatë që kjo hyrje mbetet në dispozicion të pronarit të pronës gjatë punimeve deri në atë shtrirje prone sic u përmend me lart.

6. Pemet per tu prerë

Kontraktuesi në cdo moment duhet të marrë në kohë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar shkatërrimin e pemeve dhe bimësisë. Duhet të sigurojë që personeli tij në cdo kohë të mos marrë përsiper prerjen e paautorizuar të pemëve apo të hapësirave.

7. Takimet me Publikun

Kontraktuesi gjen masat e nevojshme duke përfshire mbledhjet publike me qëllim të garantojë që publiku të jetë vazhdimisht në dijeni të programeve dhe asaj qe ndodh. Sigurohet që së paku nje anetar i personelit të tij është disponibel gjatë orarit të punimeve per t'u perballur me kerkesat e publikut dhe reklamimet e tyre ne aktivitetin e tij.

Pjesa H

Punimet me dhera

1. Përshkrim

Punimet e specifikuara në këtë paragraf mbulojnë gërmimet dhe argjinaturat e kërkuara për ndertimin e anëve të rrugës së automjeteve dhe për kanale të reja kullimi. Gjithashtu, për ndertimin e zonave të mbushjes dhe argjinaturave të vendit të mbyllur kënetor duke përdorur material nga gërmimet në vendin e punimeve dhe zonat e marra hua të aprovuara si dhe për përgatitjen e nën-pjerresive.

Gërmimi dhe rimbushja e lidhur me gropen ose riparimin e ngastrës, pastrimin e kanaleve të kullimit dhe kanaleve nën-rrugorë, puna e faturuar në mënyrë specifike si gërmim strukturor dhe rimbushje strukturorë, nuk do të përfshihet në këtë përshkrim pune.

2. Klasifikimet

Gërmimi i specifikuar sipas këtij paragrafi do të klasifikohet si i përgjithshëm, materiali papërshtatshëm dhe si gërmim kanalesh.

2.1. Gërmimi i përgjithshëm

Gërmimi i përgjithshëm do të përfshijë gërmimin e rrugës së automjeteve dhe gërmimin e marrë hua sic specifikohet me poshtë. kështu, do të jetë në përputhje me kërkesat e skicave.

2.2 Gërmime në kuneta

Kjo punë mbulon gërmim për kanale dhe gropa të reja ku tregohet tek skicat ose sic udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi.

Tolerancat për kanale të reja janë si me poshtë, duke siguruar që zona e kryqëzimit të kanaleve, gjëresia e shtratit, dhe niveli i majës së shpatit nuk do të jenë me pak se ata të treguar tek skicat/vizatimet ose të urdheruara nga Mbikqyrësi.

2.3.Gërmimi i rruges se automjeteve

Gërmimi i rruges së automjeteve do të konsistojë në gërmimin dhe vendosjen tek argjinaturat (të hedhjeve të kenaqshme) e të gjithë materialit të nevojshëm për ndërtimin e punime tokësore të treguar tek skicat duke përfshirë çdo ulje tek pjerresitë ekzistuese të argjinaturave. Aty ku gërmimi në një rrugë automjetesh kërkohe në një nivel specifik dhe kontraktuesi gërmon nën nivelin e kërkuar, ky mbi gërmim do të bëhet duke përdorur material të aprovuar, me cilësi jo më të pakët sesa materiali i mbi gërmuar me shpenzimet e kontraktuesit.

2.4.Gërmimi në gurore

Gërmimi i papapërshtatshëm do të konsistojë në gërmimin, transportin dhe vendosjen në argjinaturë të materialit nga burime të autorizuar të marrjes hua. Ajo do të përfshijë vetëm material që është i përshtatshëm për ndertimin e argjinaturave apo të punimeve tjera të mbuluara nga kontrata, dhe, ku specifikohet kështu, do të jetë në përputhje me kërkesat e skicave.

3. Hedhja e materialeve të tëpërta dhe të papërshtatëshme

3.1. Pronësia e materialeve të germuara

Cdo materiali i tëpërt do të behet pronësi e kontraktuesit dhe do të vendosen jashtë territorit të rrugës me pelqim të Mbikqyresi i Punimeve dhe në përputhje me ligjet e shtetit, me planin e menaxhimit mjedisor, dhe me kërkesat e kësaj specifike. Kostot për keto hedhje/vendosje do të mbulohen tërësisht nga kontraktuesi i cili do ti bëjë zbritje në shumat e tij të germimit.

3.2. Hedhja / Zonat e mbeturinave

Derisa të behet ndonje lejim tjetër, kontraktuesi do të hedhe të gjithë materialin e tëpërt të germuar, duke përfshirë materialin e papërshtatshëm, jashtë rrugës në zona të aprovuara të mbeturinave. Kontraktuesi do ti pajise zonat e hedhjes pa kompensim shtesë dhe do ti identifikojë ata dhe metodën e propozuar të hedhjes për aprovim nga ana e Mbikqyresi i Punimeve.

Zonat e siguruara nga kontraktuesi për hedhjen e materialeve të hequra do të jenë larg pamjes se projektit dhe do të aplikohet të paktën 100 m distancë nga rruga publike me e afërt .

4.. Materialet për skarpatat

4.1 Kerkesa të Përgjithshme

Fjalët “mbushje” dhe “argjinaturë” përdoren në mënyrë zëvendësuese të njëra – tjetrës në këtë material.

Materialet e përdorura për ndërtimin e mbushjeve nuk duhet të përmbajnë cungje, rrënjë, lëndë bimore, plehra apo materiale të tjera që nuk mund të kompaktësohen në një strukturë të fortë e të përshtatshme. Materialet e përcaktuara si të papërshtatshme duhet të hiqen dhe të hidhen poshtë. Ndërtimi i mbushjes apo argjinaturës duhet të kryhet në përputhje me planet ose sipas urdhërave të Mbikqyresi i Punimeve. Materiali i mbushjes nuk duhet të përmbajë pjesëza më të mëdha se 150mm.

4.2. Mbushje e përzgjedhur posaçërisht.

Në rastet kur mbushja e përzgjedhur posaçërisht paraqitet në plane ose urdhërohet nga Mbikqyrësi, materiali i përdorur duhet të jetë i tillë, që të ofrojë një ndërtim të qëndrueshëm me depërtueshmëri të ulët dhe duhet të ketë miratimin e Mbikqyresi i Punimeve.

4.3. Përmbajtja e Lagështisë.

Materialet duhet të kompaktësohen në përmbajtjen optimale të lagështisë, në mënyrë që të arrihet dendësia e përcaktuar në specifika. Nëse është e domosdoshme, për të arritur përmbajtjen e lagështisë, materialit duhet t'i shtohet ujë ose përmbajtja e lagështisë duhet të ulet duke e punuar materialin dhe / ose duke formuar grumbuj materialesh, në mënyrë që t'i mundësohet tharja, siç mund të jetë e nevojshme.

5. Ndertimi i argjinatures

Mbushjet ose argjinaturat duhet të ndërtohen sipas marrëveshjes paraprake ose Ndërtimit Fillestar, vijave, shkallëve dhe planëve të paraqitura në Planet ose sipas urdhërit të Mbikqyesi i Punimeve, brenda tolerancave të përcaktuara. Zgjerimi i një argjinature ekzistuese duhet të përfshijë prerjen dhe mbushjen pasuese të shesheve ndarëse të prera në skarpatën ekzistuese. Për këtë prerje të shesheve ndarëse nuk do të kryhet pagese e përveçme, dhe kostoja e kësaj pune do të përfshihet në shpenzimet e Kontraktuesit. Zgjerimi do të matet në to dhe nuk do të ketë matje të veçantë për prerjen apo mbushjen e shesheve ndarëse. Ato do të ndërtohen në seksione me gjatësi jo më pak se 100 m ose përgjatë të gjithë gjatësisë e mbushjes apo argjinaturës dhe do të vendosen në shtresa me thellësi jo më shumë se 200 mm, me matje të lirshme dhe në të gjithë gjerësinë e argjinaturës. Keto shtresa do jenë afersisht paralelisht me linjen e profilit vertikal të rruges. Materiali i bankinave do ngjeshet mirë.

6. Mirëmbajtja dhe Mbrojtja e Punimeve

Ndërsa ndërtimi është në vazhdim, gjatë gjithë kohës duhet të ruhet drenazhimi i duhur për shtresën e rrugës. Kontraktuesi duhet të ruajë të gjithë ndërtimin e punimeve tokësore gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe duhet të marrë të gjitha masat e duhura paraprake për të parandaluar humbjen e Materialit nga shtresa e rrugës, për shkak të veprimit të erës apo ujit.

Ai duhet të riparojë me shpenzimet e tij, përveç nëse në këto specifika parashikohet ndryshe, çdo rrëshqitje toke, gërryerje, zhytje dheu, ulje apo probleme të tjera që mund të paraqitën përpara pranimit përfundimtar të punimit.

Të gjitha kanalet e gërmuara si pjesë e këtij punimi duhet të ruhen nga cekëtimi i natyrshëm apo cënime të tjera të vijave, shkallëve dhe skicimeve të paraqitura në plane, deri në pranimin përfundimtar të projektit.

7. Dhënia e Formës Përfundimtare dhe Kompaktësimi: Nën-nivelimi

Si punim i shkallëzimit përfundimtar, sipërfaqja e punimeve tokësore duhet të ketë formë të tillë, që të përputhet me marrëveshjen paraprake apo ndërtimin fillestar, vijat, shkallët dhe skicimet e paraqitura në Plane ose sipas urdhërit, brenda tolerancave të përcaktuara. Nuk do të kërkohet punë krahu, përveç nëse nevojitet në zona të kufizuara ku nuk mund të përdoren pajisjet. Atje ku sipërfaqja e sipërme e argjinaturës duhet të formojë shtrat, ose pjesa e poshtme e Nënbazës apo nënbazë më e ulët, duhet të kompaktësohet dhe të marrë formën e saktë, për të qënë në përputhje me formën dhe nivelet e kërkuara sipas Standartit Shqiptar të Ndërtimit të Rrugeve.

8. Gjeotekstilet.

Në rastet e paraqitura në skicime, baza e argjinaturës duhet të përforcohet me një membranë gjeotekstili ndërtimor, të shtruar siç paraqitet dhe në nivelet apo skicat që mund ti bashkëngjiten kontratës. Këto membrana përforcuese duhet të jenë në përputhje me kërkesat e skicimeve.

9. Veprimet pranë trotuarit.

Gjatë punimit me punë krahu ngjitur me trotuarin, që përdoret për të ruajtur trafikun, duhet të paraqitet kujdes i jashtëzakonshëm për të shmangur aksidentet për këmbesoret.

10.Skarifikim i sipërfaqeve ekzistuese

10.1. Të Përgjithshme

Si përgatitje për hedhjen e materialit shtese apo shtreses se re në disa zona do kerkohet të behet skarifikim dhe ngjeshje. Ky artikull mbulon kerkesat për skarifikim, dhenien e formes dhe ngjeshjen e materialeve ekzistuese.

10.2. Ekzekutimi i Punimeve

Ndersa ecin punimet, do behet drenazhim i saktë për shtratin e rruges e cila ka nevojë për mirembajtje gjatë gjithë kohes. Kontraktori do ruaje gjithë sipërfaqet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës dhe do marrë gjithë masat e nevojshme për të parandaluar humbje materiale nga shtrati i rruges për shkak të nderveprimit të ererave apo ujit.

Me shpenzimet e tij, përvec rasteve kur përjashton kontrata, ai duhet të riparojë cdo rreshqitje, zhvendosje apo keqformim të shfaqur para se të merret në dorezim puna.

Skarifikimi do konsistojë në therrmim/thyerje të materialeve mbi nje sipërfaqë ekzistuese, ridhenie të formes që nevojitet për të bere kallepet dhe ngjeshjen sic nevojitet përpara hedhjes se ndonjë materiali shtese.

Materiali ekzistues do shkritohe dhe therrmohet deri në atë nivel që të mos ketë asnje cope jashtë standartit të lejuar me nje dimension me të madhe se gjysma e thellesise nominale të mbetjeve të skarifikuara. Agregatet apo pjesezat e dobeta do therrmohen dhe gjithë pjesezat që mbetura të përmases se tëpruar do zhvendosen.

Materiali i skarifikuar do rishpërndahet në nje menyre të tille që para se të behet ngjeshja e sipërfaqes të jetë në përputhje me atë forme përfundimtare sic kerkohet në kontratë (që zakonisht behet nje sipërfaqë paralele sipas kushtit të kerkuar e përfundimtar pasi të hidhen shtresat e mevonshme shtesë) dhe të ketë një shtresë me material të shkrfitur që të jetë i barabartë në trashesi me thellesinë nominale të skarifikimit të parapërcaktuar.

Pjesa I

Gërmimi i strukturave & mbushja

1.Përshkrim

Puna e përshkruar në këtë pjese përbëhet nga gërmimet për puseta kanalesh nën rrugë, tubacione nën rrugë, mure mbajtëse, mure kryesore, kanalizime të përforcuara me beton dhe ndertime të ngjashme. Tarifa e cituar do të përfshijë të gjitha kostot që kanë lidhje me:

-Ndërtim dhe heqjen e vendeve të rrethuar me lumë, copëzimet, kryqëzimet, etj.

-Pompimi ose e kundërta, tharja nga uji e themeleve të gërmimeve.

-Heqja e ndertimeve ekzistuese ose pjeseve të ndertimeve që nuk janë të mbuluara nga ndonjë objekt tjetër në kontratë, duke përfshirë këtu themelet, mbajtëset, shtyllat, krahët, dhe të gjitha materialet e tjera, pengesat, etj.

-Çdo gërmim tjetër shtese të kërkuar për sigurimin e sipërfaqes së punës

-Heqja e materialit të tepërt dhe pastrimi përfundimtar, siç mund të jetë e nevojshme për kryerjen e plotë të punës.

-Rimbushja me materiale të miratuara.

2.Gërmimet për shmangien e lumit

Gërmimet në ndryshimet e drejttimeve, zmadhimeve, thellimeve apo përforcimeve të burimeve dhe lumenjve apo në formimin e rrugëve të reja të rrjedhjes së ujrave do të kryhet ashtu siç është paraqitur në Skicime apo siç do të udhëzohet nga Mbikqyrësi dhe mund të përfshijë pastrimin e sheshit, zhvendosjen e pjerrësive, gradimin e shtratëve dhe heqjen e materialeve të gërmuara.

Aty ku drejtimit e rrjedhjes së ujrave duhet të ndryshojnë, kanalet e mëparshëm duhet të pastrohen nga të gjitha bimët dhe depozitimet e buta dhe të mbushet me kujdes me materialin e miratuar, të depozituar dhe kompaktuar siç është udhëzuar nga Mbikqyrësi.

3. Materialet gjeotekstile për strukturat

3.1 Të Përgjithshme

Aty ku tregohet në Skicim ose drejtohet nga Mbikqyrësi, Kontraktori duhet të sigurojë filtër plastike (gjeotekstile) e cila do të mbështillet rreth betonit të pusetave të kanaleve të nëndheshme të paravendosura dhe prapa betonit të paravendosur të shtyllave për të mbajtur materialin mbushës.

3.2.Materialet

Materialet përforcuese të Gjeotekstitit duhet të jenë të një lloji me veti të miratuara, me thurje fijesh të vazhdueshme prej 100% polipropileni apo materiali tjetër të miratuar dhe të përputhen në mënyrë thelbësore me kërkesat e caktuara më poshtë.

PLASTIKA e bazës duhet të përmbajë stabilizues dhe/ose pengues për t'i bërë fijet rezistente ndaj shthurjes për shkak të ekspozimit të zgjatur ndaj dritës dhe nxehtësisë së rrezeve ultraviole. Gjithashtu, ajo duhet të jetë krejtësisht jo e biodegradueshme, rezistente ndaj kimikateve të dheut dhe bakterieve dhe e pandikueshme nga AIDS dhe alkalinet.

Kërkesat për cilësitë e thurjes gjeotekstile janë si vijon:

Thurja	Tipi 300	Tipi 500
Ne drejtim te gjatesise		
Fortesia normale elastike (minimum)	300 kN/m	500 kN/m
Zgjatja ne fortesine nominale	< 13%	< 11%
Ngarkesa ne zgjatjen 2%	> 30 kN/m	> 90 kN/m
Ngarkesa ne zgjatjen 5%	> 110 kN/m	>400 kN/m
	> 230 kN/m	
Ne drejtim te terthorte:		
Nominal tensile strength (minimum)	40 kN/m	50 kN/m
Zgjatja ne fortesine nominale	< 7%	< 9%
Testi I vrimave statike		
Forca e shtyrjes permes	> 10 kN	> 10 kN
Vendosja e shtryrjes permes	< 30 mm	< 40 mm
Rezistenca Ultra Violet		
Testi Xenon	UTS > 90%	UTS > 90%
Klasifikimi	Klasi C	Klasi C
Rezistenca e termo-oksidimit	Klasi A	Klasi A

Vini re qe karakteristikat I referohen gjatesise dhe perkatesise se terthorte te katalogut te ndertimit. Gjate instalimit gjatesia e perdorur si me siper do te jete e terthorte me linjen qendrore re rruges.

Pervec karakteristikave mekanike te listuara me siper, gjeotekstilja e aprovuar do te ketë një sipërfaqe të sheshtë në menyrë konsistente të përshtateshme për promovimin e fërkimit mes ndërtimit dhe dheut te afërt.

Kontraktuesi do të paraqesë detaje, me një vërtetim që tregon emrin e prodhuesit, emrin e produktit, numrin e stilit, përberjen kimike, dhe shembujt e materialit te propozuar tek Mbikqyrësi për rishikim dhe aprovim.

Etiketat e produktit do të tregojnë qartë emrin e prodhuesit ose furnizuesit, emrin e stilit, dhe emrin e katalogut. Cdo dokument i transportit të mallit do të perfshijë një shënim që vërteton se materiali është në perputhje me certifikatën e prodhuesit.

Cdo katalog i gjeotekstileve do të ambalazhohet me një material që do të mbrojë gjeotekstilin nga demtimi si pasojë e ujit, dritës së diellit dhe ndotësve. Amabalazhimi mbrojtës do të mirëmbahet gjatë periudhave të dërgimit me rruge detare/anije dhe ruajtjes. Gjate ruajtjes, katalogjet e gjeotekstilit do te ngrihen nga toka dhe do te mbuloen sic duhet për ti mbrojtur ata nga demtimi i vlerave me karakter fizik te gjeotekstileve.

3.3. Filtri Plastik (Gjeotekstil)

Filtri plastik do të vendoset në ose në drejtim të kundërt të një shtrati apo sipërfaqeje të përgatitur, pa pircje dhe, copëra që mund të dëmtojnë copën. Copa do të vendoset e lirshme, jo e tërhequr pa rrudha e pa palosje. Materiali i dëmtuar do të riparohet ose do të zëvendësohet nga një copë gjeotekstile që është aq e madhe sa të mbulojë zonën e dëmtuar dhe të arrijë kërkesat e përputhjes. Copa do të jetë mbi njëra tjetrën me një minimum prej 450 mm (18") në të gjitha nyjet, tegelat dhe anët.

Kerkesat për të gjithë materialet do përshtatën me Standartin Shtetëror të Projektimit e Ndertimit të rugeve në vendin tonë.

3.3.1. Instalimi

Per Proceduren e instalimit te perforcimit gjeotekstil do te bihet dakord paraprakisht mes kontraktuesit dhe Mbikqyesi i Punimeve. Veprimet fillestare të shtresës do të monitorohen nga të dyja palet si dhe cdo ndryshim apo rregullim tek procedura e rënë dakord dhe e demonstruar. Një procedurë e kenqëshme, mbi të cilën është rënë dakord, nuk do te ndryshohet pervec se me miratim te menaxherit te projekeit i cili do te kontaktohet menjëhere nëse kontraktuesi e ndien që kerkohet ndonje ndryshim.

Procedura e rënë dakord do të jetë e tillë për të siguruar që:

- Copa shtrihet sa me shpejt te jete e mundur pas perfundimit te kanaleve kulluese vertikale;
- Copa shtrihet mbi një sipërfaqe të lëmuar;
- Copa shtrihet ne menyre korrekte me veniet/mbulimet e duhura dhe me gjatesitë e bashkimit;
- Copa shtrihet pa zhubrosje;
- Rimbushja behet sapo të jetë shtruar copa;
- Ankorimi bëhet menjëherë pas rimbushjes që fillon në nivelin e duhur të mbushjes;
- Shtresa e argjilte behet per mbrojtur zonat e ekspozuara sa më shpejt te jetë e mundur pasi shtresat janë rimbushur.

Sa më shpejt të jetë e mundur pas instalimit te një seksioni të plotë të kanaleve kulluese të argjinaturave, kontraktuesi do të instaloje memebbranën gjeotekstile për perforcimin e bazës së argjinaturës.

Sapo seksioni rrugor të jetë gati për shtresën e copës, panelet e copës do të tërhiqen në menyre të terthorte pergjate vijës së rruges ne pozicionin e sakte te tyre me gjatesi ankorimi te rrethuar paster ne cdo anë të shtratit të rrugës. Anesorja/buza e cdo paneli do te mbuloje panelin tjetër me një minimum 300 mm. Drejtimi i copës do te jete i terthorte në linjën rrugore dhe asnjë bashkim mes gjatësive te copës nuk do të lejohet; cdo panel i plotësuar do të jetë një pjesëe vecantë cope.

Pas shtreses, e gjithë copa do te jete e lemuar dhe e lire nga zhubrosjet.

Kur shtrimi i njëres pjese kryehet, kontraktuesi do ti kerkojë Mbikqyresi i Punimeve të inspektoje dhe te aprovoje shtrimin. Menjëhere pas marrjes së ketij aprovimi, do te fillojë rimbushja.

Rimbushja do të fillojë nga fundi i punimeve të pjesës nga pjesa e mbaruar me para dhe e rimbushur pjesërisht dhe asnjë pajisje apo automjet nuk do të lejohet të levize mbi copën e dalë ne shesh.. Materiali do te derdhet vetem ne materialin e vendosur me pare dhe do te shperndahet me kujdes perpara per te mbuluar copen. Nivelet do te kontrollohen me kujdes cdo here per tu siguruar se ka nje minimum absolut mbulimi 15mm tek copa ku makinat dhe pajisjet kalojnë ose punojnë. Ne vijim te kompaktësise dhe aporrvimit te shtresës së parë, do të vendoset një shtresë e dytë mbushjeje për ta sjellë argjinaturen ne nivel. Aty ku niveli eshte mbi nivelin origjinal te tokes, duhet patur kujdes per tu siguruar qe eshte vendosur gjeresia e duhur e argjinatures. Anesoret e mbushjes do te pershtaten si te jete e nevojshme për të dhënë gjërësine e duhur dhe gjatësia e ankorimit do të sillet dhe terhiqet në menyre të tendosur ne pozicionin në majë të shtresës.

Rimbushja e shtresës tjetër të argjinatures do të fillojë sapo gjatesitë e ankorimit të jenë në vend sic duhet. Rimbushja do të fillojë nga qendra e argjinaturave duke vijuar drejt në mënyrë të tillë që fundet e lira te gjatesive te shtrira/fiksuar te jene vendosur sic duhet poshte rimbushjes para se veeprimi të arrije ne anesoret/buzet e jashtme te argjinatures.

Sapo me shpejt praktike te jetë e mundur pas plotësimit të ndertimit të argjinatures në lartësine e kërkuar, shtresa e argjiltë mbrojtëse do të vendoset për të mbuluar cdo copë zone të ekspozuar dhe për të mbrojtur mbushjen/hedhjen e rëres nga erozioni.

Pjesa J

Nënbaza granulare

1.Përshkrimi

Kjo pjesë mbulon aplikimin e nënbazës me material granular i cili do të përbëhet nga një material agregat i përshtatshëm që përputhet me kërkesat e specifikimeve të mëposhtme.

2.Materialet

Materialet e menduara për përdorim në punë si nënbazë do të jenë shkëmb i copëtuar i marrë nga depozitimet e materialit të masivit të shkëmbit që thërrmohet natyralisht ose zhavor me kënde, ose zhavor rrumbullak që është shtypur në masën të paktën 60% e materialit që do të tregojë një faqe të prerë dhe nuk do të ketë bimësi, trupa të huaj dhe materiale të tjera të dëmshme. Nuk duhet të përmbajë plisa ose agregatë të një natyre apo të një cilësie të mjaftueshme që të mos arrihet të merret një sipërfaqe e lëmuar.

Kontraktuesi duhet të mbajë përgjegjësi plotësisht për furnizimin me material nënbaze.

1. Gradimi

Materiali duhet të përputhet me kërkesat e mëposhtme për nënbazën granulare:

Madhesia e sites (mm)	Perqindja qe kalon sipas peshes
63.0	100
40.0	70 - 100
20.0	50 -85
10.0	40 - 75
4.75	30 - 60
2.36	20 - 45
1.18	15 - 37
0.075	4 - 15

2. Lendet e demshme

Te gjitha agregatet do te jenë të lira në menyrë te arsyeshme nga kokrrat e argjilës, pjesët e buta dhe te shkriфта, kripa, alkalinet, lendet organike, shtresat aderente, dhe substanca te tjera te papercaktuara te cilat mund te permbajne karakteristika te padeshirueshme. Pesha e substancave te demshme nuk do ti kaloje perqindjet e meposhtme:

Qymyrguri dhe linjit (AASHTO T-113) 0.50%
 Pjese e buta dhe te shkriфта (AASHTO T-112) ≤0.50%
 Kokrra argjile (AASHTO T-112) ≤0.50%
 Thengjill dhe zhir ≤0.5%
 Guaska te lira/boshe ≤1.0%
 Lende organike (Ëet) ≤0.20%

3.Kompaktesia (ngjeshja)

Kompaktësia do të jetë me rul vibrues dhe niveli I kompaktësisë nuk do të jetë më pak se 98%.
 Tolerancat

Me perfundimin e nenbazes, siperfaqja e siperme e drejtimit final do te jetë e pershtateshme ne linje/vije dhe nivel brenda nje tolerance +.00 to – 40mm

4.Trashësia e shtreses

Trashësia e nenbazes do te jete e tille sic kerkohet per te arritur tolerancat e nivelit te specifikuar duke partur parasysh nivelet aktuale te shtresave te meposhtme.

Pjesa K

Shtresa e parë dhe veshja me bitum

1.Pershkrimi

E gjithë puna e shtresës së parë dhe veshjes me bitum, do te permbushet ne perputhje me

specifikimet dhe ne përputhje me linjat, dimensionet, dhe shenimet e treguara tek skicat ose sic udhëzohet nga Mbikqyrësi.

2.Pajisjet

Pajisjet e mëposhtme duhet të jenë të disponueshme dhe në gjendje të mirë pune:

Shpërndarësi

Distributori lidhës që përdoret për shpërndarjen e lidhësve të bitumit, duhet:

Të jetë në gjendje të mirë pune dhe duhet të kalibrohet sipas metodave të zakonshme për të përcaktuar trashësinë e shtreses.

Të ketë një shufër spërkatjeje, ku gryka e jashtme e çdo skaji të kësaj shufre të ketë një zonë hapjeje prej të paktën 25% dhe jo më tepër se 75% më të madhe se grykët e tjera. Të gjitha grykët e tjera duhet të kenë hapje uniforme.

Të ketë një shufër spërkatjeje ku distanca midis qendrave të hapjeve të grykëve të jashtme të kësaj shufre, të jenë të barabarta me gjerësinë e aplikimit të kërkuar – me tolerance të lejueshme deri në 50 mm. Kur aplikimi kryesor mbulon më pak se gjerësinë e plotë, hapja normale e grykës fundore në linjën bashkuese mund të mbetet njëlloj me ato të grykëve të brendshme.

Të mos ketë asnjë çarje karburanti apo lidhjeje;

Të ketë një shufër spërkatjeje të drejtë dhe të pastër, me kokat spërkatëse të të njëjtit lloj, të cilat hapen njëkohësisht dhe nuk rrjedhin kur mbyllen;

Të ketë koka spërkatëse, të gjitha në të njëjtin kënd me shufrën spërkatëse dhe të vendosura në nivelin e duhur, në mënyrë që të arrihet mbulimi i duhur i spërkatjes;

Të ketë grykë të rregulluara në mënyrë të tillë që ventilatorët spërkatës të pastrojnë njëri – tjetrin;

Të ketë shosha të pastra e të padëmtuara;

Të jetë i pajisur me tubin e posaçëm të dorës për spërkatjen e këndeve dhe zonave të tjera që nuk i arrin dot shufra spërkatëse;

Të jetë i pajisur me goma pneumatike, të cilat duhet të kenë gjerësi të mjaftueshme llastiku në kontakt me sipërfaqen e rrugës, për të shmangur thyerjen e lidhjes apo formimin e një vazhde në sipërfaqe;

Të jetë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të një operatori të miratuar nga Mbikqyrësi 1 dhe të ketë certifikatë përputhshmërie me standartet e kërkuara.

Spërkatësi i Ujit

Duhet të ketë pajisje efikase spërkatjeje, të tillë që të spërkasë një shtresë uniforme uji, me shpejtësinë e miratuar, mbi të gjithë zonën që do të shtrohet me shtresën kryesore.

Furça Rotative

Duhet të jetë vetëlëvizëse ose e pajisur me një automjet të përshatshëm me rimorkio, me goma pneumatike.

Pajisje të Ndryshme

Pajisjet e tjera duhet të përfshijnë furça dore, letër të përforcuar për pikëlidhjet, tela, gozha dhe të gjitha pajisjet e tjera ndihmëse, që duhet për kryerjen e punimit në mënyrë efikase dhe të saktë.

Çisternat për Transportim

Të gjitha çisternat që transportojnë materiale bitumi për përdorim në projekt, duhet të jenë pajisur me një aparat të miratuar për marrje mostrash.

Çisternat për Magazinim

Të gjitha materialet e shtresës kryesore që janë magazinuar në gjendje të nxehtë, duhet të magazinohen në një konteiner me sistem qarkullimi që funksionon saktë dhe të kenë një kapak sigurie. Temperatura maksimale e magazinimit duhet të jetë sipas rekomandimit të prodhuesit të materialit të shtresës kryesore.

Në rastet kur materiali prej bitumi duhet të matet nga një çisternë magazinimi, kjo e fundit duhet të kalibrohet nga një Specialist i miratuar nga Mbikqyrësi, përpara se të përdoret.

Kalibrim

Të gjithë distributorët, çisternat e transportit dhe ato të magazinimit që do përdoren në këtë punim, duhet të kalibroheshin nga një Specialist i miratuar nga Mbikqyrësi dhe asnjë distributor apo çisternë nuk duhet të përdoret deri sa të kalibrohet në mënyrë të kënaqshme.

Mund të pranohen kalibrimet e kryera për distributorët, çisternat e transportit dhe ato të magazinimit nga një firmë e besueshme dhe e mirënjohur që merret me kalibrimin e çisternave. Kalibrimet e kryera apo të miratuara nga Mbikqyrësi duhet të përdoren, për të përcaktuar sasinë për çdo distributor dhe çisternë transporti apo magazinimi.

3. Aplikimi

3.1. Moti dhe Kushtëzime të tjera

Asnjë shtresë kryesore nuk do të aplikohet nën këto kushte të pafavorshme:

Gjatë motit me mjegull apo lagështi,

Kur bëhet gati të bjerë shi;

Kur fryn era aq fort, saqë mund të shkaktojë spërkatje jo të njëtrajtshme;

Pas perëndimit të diellit;

3.2. Përgatitja

Jo më tepër se 24 orë përpara spërkatjes, shtresa që do të jetë kryesore duhet të fshihet dhe të pastrohet nga të gjitha materialet e tepërta dhe të dëmshme, me anë të një furçe rrotulluese dhe / ose furçave të dorës. Fshirja duhet të kryhet me kujedes, në mënyrë që të mos i shkaktojë dëmtime shtresës.

Para se të spërkatet cilido material të shtresës kryesore, shtresa kryesore duhet të kontrollohet për përputhshmërinë me sipërfaqen dhe kërkesat e tjera të specifikuar. Çdo seksion që nuk përputhet me kërkesat e specifikuar, duhet të korrigjohet.

Një spërkatje e lehtë me ujë, e mjaftueshme për të lagështuar sipërfaqen, mund të aplikohet në mënyrë uniforme në shtresë, menjëherë përpara aplikimit të shtresës kryesore. Nëse aplikohet sasi e tepër uji në shtresë, kjo e fundit duhet të lihet të thatet, derisa të arrihet një sipërfaqe e lagështuar në mënyrë uniforme.

Përmbajtja e lagështisë së shtresës nuk duhet të tejkalojë 90% të përmbajtjes optimale të lagështisë për materialin që formon shtresën. bashkëlidhur, sipërfaqja e asfaltit duhet të pastrohet nga të gjitha materialet e tepërta, pluhuri dhe ndotësit shoqërues, ose duke përdorur furçën rrotulluese, ose me anë të ajrit me presion të lartë. Nëse Mbikqyrësi e porositi, ndotja e sipërfaqes për shkak të baltës, jashtëqitjeve të kafshëve apo materiale ngjitëse të kësaj natyre duhet të pastrohen me përdorimin e ujit, ose me anë të spërkatjes së kujdesshme me presion, ose duke spërkatur dhe fshirë me furçën rrotulluese; nëse përdoret ujë për të pastruar sipërfaqen, shtresa e lidhur me gozhdë / bashkëlidhur nuk duhet të spërkatet, derisa sipërfaqja të jetë tharë krejtësisht, përveç rastit kur përdoret emulsion. Në këtë rast, sipërfaqja mund të jetë e lagësht, por nuk duhet të ekzistojë ujë i dukshëm mbi të.

3.3. Aplikimi ne objekt

Materialet për shtresën e kryesore dhe atë lidhese duhet të aplikohen në një temperaturë që do të miratohet nga Mbikqyrësi. Temperatura e saktë do të jetë ajo që do të sigurojë shpërndarje uniforme dhe do të caktohet nga Mbikqyrësi, pas testeve të miratimit që do të kryhen nga Kontraktuesi.

Norma e aplikimi të shtresës së parë do të varet nga karakteri i sipërfaqes, por do të jetë e mjaftueshme për të pjekur tokën në tëresi dhe në mënyrë uniforme pa material shtesë.

Norma e aplikimi do të jetë brenda linjës:

$$0,8 - 2,0 \text{ kg/m}^2$$

Norma faktike e aplikimit do të jetë siç është drejtuar nga Mbikqyrësi pas testeve të miratimit duke përfshirë aplikimet provë për seksionet e shkurtra.

Kudo që të jetë e mundur, ai i dorës së parë do të aplikohet në një ose më shumë rrugë në mënyrë të barabartë mbi të gjitha gjerësitë e rrugës dhe duke lejuar të depërtojë dhe të konservojë derisa trafiku mund të kalojë mbi sipërfaqe pa lënë gjurmë goma mbi shtresën e dorës së parë. I gjithë trafiku do të largohet nga sipërfaqja derisa ky kusht të arrihet.

Gjerësia totale e sipërfaqes së shtresës së dorës së parë do të jetë siç tregohet në Skicimet ose siç përshkruhet nga Mbikqyrësi dhe buzët e sipërfaqes së shtruar do të jetë paralele me vijën qendrore të rrugës.

Ku nuk është e mundur për trafikun të përdorë shmangie, shtresa e dorës së parë do të aplikohet dhe do të lejohet të depërtohet për aq kohë sa është e praktikueshme përpara se të aplikohet një shtresë agregati me një normë prej afërsisht $0.0035\text{m}^3/\text{m}^2$..

Nëse shtresa e dorës së parë aplikohet në më shumë se një rrip, lejimet do të bëhen për shkelje të rripit nga 100 mm.

Gjerësia totale e sipërfaqes së asfaltuar do të jetë ashtu si tregohet në Skicim ose përshkruhet nga Mbikqyrësi dhe buzët e pjesës së shtruar do të jenë paralele me vijën qendrore të rrugës. Nëse shtrimi aplikohet në më shumë se një rrip, lejimi do të bëhet për shkelje të rripit nga 100 mm.

Përpara aplikimi të vijimit të asfaltimit shtresa e asfaltimit do të jetë lejuar të thahet. Nuk do të lejohet trafiku mbi sipërfaqet e shtruara përveç atyre të nevojshme për ndërtim.

3.4. Mbrojtja e Punimeve ndihmese

Kur shtresa e dorës së parë është aplikuar afër trotuarit ose sipërfaqeve të tjera prej betoni, (përveç ku ato duhet të mbulohen me veshje bitum) do të mbulohet me kartë të trashë ose përndryshe të mbrojtur ashtu siç është miratuar nga Mbikqyrësi gjatë aplikimit. Ndonjë material bitumi i depozituar në këto sipërfaqe të betonuara duhet të hiqet menjëherë.

Kontraktori duhet, me koston e tij, të zëvendësojë të gjithë përbërësit të njollosur të cilët nuk mund të pastrohen. Lyerja e sipërfaqeve të njollosura nuk do të pranohet si masë riparuese e pranueshme.

3.5. Mirëmbajtja dhe hapja e trafikut

Aty ku agregati është aplikuar për sipërfaqen e shtruar me kusht lejimin e trafikut, Kontraktori do të mirëmbajë shtresën dhe sipërfaqen e primuar përgjatë periudhës kur sipërfaqja është e hapur për trafikun dhe do të riparojë të gjitha dëmet për sipërfaqen e shtruar siç është udhëzuar nga Mbikqyrësi.

3.6. Tolerancat

Norma aktuale e spërkatjes e matur me temperaturën e spërkatjes nuk do të shmanget nga norma e kërkuar e spërkatjes ashtu siç është specifikuar ose urdhëruar nga Mbikqyrësi, në më shumë se $0.06\text{l}/\text{m}^2$. buzët e sipërfaqes së spërkatur do të jenë saktësisht me vijën me një devijim maksimal prej 25 mm nga vija e specifikuar e buzës.


3.7. Testimi

Kontraktori duhet të njoftojë Mbikqyrsin e Punimeve të pakën 24 orë para për qëllimin e tij për të përhapur shtresën e dorës së parë apo shtresën litar, në mënyrë që normat e spërkatjes aktuale të mund të porositen dhe/ose të verifikohen nga Mbikqyrësi. Ndryshe nga sa është pranuar më parë, Kontraktori do të spërkatë vetëm kur Mbikqyrësi është i pranishëm dhe pjesa që do të spërkatet është miratuar me shkrim. Norma e shpërndarjes së shtresës së dorës së parë dhe materialit të shtresës tjetër do të kontrollohet në intervalet e treguara nga Mbikqyrësi, por nuk do të jetë më pak se dy teste në çdo ditë të shtrimit.

KERKESAT PËR SHITRESEN SIPËRFAQËSORE

Shtresat rrugore përbehen nga këto pjese kryesore:

- a) Mbulesa e përbërë nga dy shtresa: shtresa e sipërme konsumuese që është në kontakt me verimin e rrotave (ngarkesave të levizeshme) dhe agjëntëve atmosferike, dhe shtresa e poshtëme lidhese.
- b) Themeli
- c) Nënthemeli
- d) Shtresa përforcuese
- e) Tabani (original apo i përpunuar) sipas figures se meposhtëme.



Një shtrese rrugore e ndërtuar mirë është e nevojshme të ketë këto cilësi:

- Të ofrojnë një adheqencë të mirë
- Të mundësojnë një drenim të mirë të ujrave sipërfaqësore

- Të minimizojë zhurmat e levizjes së automjeteve
- Të rezistojë ndaj plasaritjeve dhe gropezimeve
- Të mbrojë shtresat rrugorë nën të
- Të kërkojë mirëmbajtje minimale
- Të jetë e përshtatshme për riveshje dhe riciklim
- Të jetë e durueshme në kohe

Mbulesa rrugore duhet të ketë një strukturë dhe cilësi të veçantë për sa i takon kontaktit me rrotat e automjeteve. Siç shihet në figurën me poshtë, sipërfaqja e kontaktit rrugë-rrotë ndahet në tre zona:

- Zona 1 : ku shtresa e ujit sipërfaqësor është e pandërprere
- Zona 2 : ku shtresa e ujit shpërndahet duke formuar një film uji të hollë, i cili mund të shpërndahet dhe të penetrojë në një pjesë të sipërfaqës së kontaktit
- Zona 3 : ku shtresa e ujit largohet e gjitha dhe realizohet një kontakt i mirë e “ i thatë” i gomave me sipërfaqën e rrugës. Për të arritur që të sigurohet një largim i ujit dhe në këtë mënyrë një adhirencë e nevojshme për një shpejtësi të caktuar të levizjes së rrugës, përveç cilësive të vetë gomës, në një pjesë të konsiderueshme rol të rëndësishëm luan edhe makrotekstura e mbulesës rrugorë.




Figura shoqëruese: Zonat e bashkeveprimit Rrotë – Rruge

REHABILITIMI I BANKINAVE

Qëllimet e rehabilitimit të bankinave të hapura është përgatitja e një shtrese të lemuar dhe të qëndrueshme që:

- Nuk do të deformohet nga ngarkesat
- Ka një rezistencë të lartë ndaj trafikut dhe motit
- Është i padepërtueshem

Pjesa L

Veshja sipërfaqësorë

1. Korigjim i bazës

Pasi të jetë hedhur shtresa e parë, baza do kontrollohet mirë për butësi dhe saktësi në nivelim, ngritje e seksion tërthor. Cdo racion i bazës që nuk përputhet me kërkesat e specifikuara do korigjohet me asfaltin që do paguhet nga financat e Kontraktorit, derisa të arrihen kërkesat e specifikuara. Asfalti që përdoret për korigjimin e bazës apo nën-bazës, do jetë e njëjta përzierje sic specifikohet për shtresën e sipërme dhe maksimumi që do përdoret për madhësinë e agregatit do i dedikohet trashësisë së kërkuar për korigjimin e secilit rast.

Përveç këtyre, për korigjimin e bazës, Mbikqyrësi gezon të drejtën të urdhëroje heqjen dhe zevendesimin e shtresës apo porcionëve që janë hedhur në bazë dhe shtresat e nënbazës që nuk përputhen me kërkesat e specifikuara, në vend që të lejohet korigjimi i punimeve nën standartin e lejuar të materialeve me asfalt.

2. Pastrimi i Sipërfaqes

Sapo të aplikohet shtresa e parë (veshja primare) para se të hidhet asfalti, sipërfaqja do pastrohet dhe thahet për të eliminuar kështu gjithë Materialet e rrezikshme.

Në vendet ku është demtuar shtresa e parë, ajo do riparohet me dorë me anë të një furce, apo spërkatje të Materialit të parë mbi racionët e demtuara.

Veshja apo shtresa e parë do thahet tërësisht para se të hidhet asfalti. Programi i Kontraktorit do mundësojë që të ketë vonësa derisa ato behen për hedhjen e shtresës së parë, racionin e aplikimit, porozitetin e bazës dhe përberjen e masës së lëshshme, dhe kushtet klimatike.

Përgatitjet për pozicionët e lartëpërmendura duhet të behen me përdorimin e makinërise për prerje asfalti, me qëllim që prerja të jetë në forme të rregullt latrorë ose drejtkëndesh. Fundi i gropës së krijuar duhet të pastrohet Mirë para spërkatjes me emulsion.

3. Vendosja e shtresës ngjyëse ose spërkatjes me emulsion

Pas pastrimit të sipërfaqëve të prera në mënyrë vertikale, dhe të fundit të gropave, pasohet me mbulesë ngjyëse ose ose spërkatje me emulsion. Kontraktori duhet të bëjë kujdes në sigurimin e sasise së nevojshme të emulsionit që do përdoret. Kjo shtresë duhet të mbahet pastër dhe asfaltobetonit që do të përdoret duhet të hidhet 2-3 orë me vonë. Nëse shkaktohet ndonjë demtim nga kushtet atmosferike, ky demtim duhet të riparohet përpara shtrimit të asfaltit.

4. Mbushja gropave me asfaltobeton

Vendosja e asfaltobetonit në gropa duhet të bëhet në mënyrë manuale. Temperaturat minimale e Materialit gjatë hedhjes së tij duhet të jetë 150 gradë. Ngjeshja e shtresës së hedhur nënkupton përdorimin e cilindrit vibrues prej 1.5-2 ton e drejtuar me dorë.



4.1. Të Përgjithshme

Përzierja do shpërndahet në rrugë në një mënyrë të tillë që mos ketë asnjëherë mungesë asfalti në masë. Temperaturat e përzierjes do kontrollohet me anë të matjes së një mase të zakonshme

menjehere sapo hidhet nga kamioni, dhe temperaturat mesatare e hasur nuk do jetë me pak se 10°C nën temperaturën e specifikuar për përzierjen në tabelën e mesipërme. Përshtatja e shufrave të medha prej druri, ushqyesve, hinkës, etj, do kontrollohet shpesh për të siguruar një shpërndarje uniforme të përzierjes. Nëse ndodh shpërberja, nderhyrjet e hedhjes së asfaltit do nderpritën menjehere derisa të gjëhet shkaku dhe të korrigjohet.

Shtesa dhe heqja e Materialit pas shtrimit normalisht nuk do lejohet dhe shtruesi duhet të shpërndahet me vlerat dhe nivelet e sakta që kërkohet për trashesinë e ngjeshjes pa gjetur gropa, apo nivelime si këto.

Operatorët nuk do lejohen të ecin sipër shtresës së pangjeshur.

Nëse është e mundur, shtrimi të nisë nga fundi i kendeve dhe cepat me të futura të kthesave të mbiniveluara. Gjithmonë duhet mbiniveluar shtresa në kendet me të thepisura në me shumë se 5%. Shpërndarja do rregullohet në mënyrë që lidhjet gjatësorë të mos koincidojnë me shtresat e thella të shtreses asfaltike sipërfaqësorë.

Shtrimi duhet të jetë i tillë që të sigurojë një kontroll të përhershëm të saktë automatik të niveleve dhe seksioneve tërthorë. Në zonar e limituara, që s'mund të hyjnë makinëritë e shtrimit, përzierja mund të hidhet me dorë apo menyrë të tjera që të arrihen rezultatë specifike. Shtrimi do kryhet në atë mënyrë që të menjahohen carjet dhe që lejojnë kontrollin në të gjitha nivelet.

Kapaciteti i përzierjes dhe shpejtësia e operimit të shtreses do jetë e bashkerenditur që të sigurohet shtrim i vazhdueshëm dhe të menjahohen parregullsitë nëpër shtrese. Shtrimi do ndalojë kur të nisin shirat apo kur sipërfaqja duket me sy të lirë që është e njome.

4.2. Mbishtresat

Në rast të mbishtresave, nuk do nevojiten shufra drejtimi gjatë vendosjes së përzierjes derisa të specifikohet në kërkesat e Mbikqyesi i Punimeve. Në të gjitha rastet, duke përfshirë shtresat niveluese, shtresa do behet me shufrat e tërheqjes me anë të makinërise elektronike e cila siguron një renie tërthorë të qëndrueshme dhe mund të zhduke parregullsitë.

4.3. Asfalti

Asfalti do hidhet në zonat e limituara me ndihmë të shtruesve të vegjël, veglave të punës, apo pajisjeve të tjera që janë të miratuara. Hapesira që lidhet me këtë do mbushet mirë me asfalt, pa lenë asnjë boshllëk ndermjet asfaltit të fresket dhe shtresave ekzistuese. Gjithë klauzolat në lidhje me temperaturën, përberjen e përzierjes, uniformitetin, etj, do aplikohet, dhe trashesia e shtreses e kontrolli do jenë të tilla që kërkesat për ngjeshje dhe tolerancat e sipërfaqës të jene perfekte.

5 .Impianti dhe makineri

5.1. Te pergjithshme

Gjithe impiantet dhe makinerite e perdorura për punimet do të jenë një kapacitet me vlerë të përshtatshme dhe në kushte shumë të mira pune.

Gjithe impiantet dhe makinerite qe do kryejne punime ne rrugë gjate fazes se punimeve te garancise do behen te lira nda cdo sigurim, karburant apo rrjedhe gazi, dhe asnje rimbushje apo sherbim të cdo makinerie nuk do lejohet qe te behet ndersa kjo makineri eshte ne ruge.

5.2. Shperndaresi i Binderit

Shperndaresi i binderit që është shfrytëzuar për të shperndare bitum duhet që:

- Te jete ne nivelet e kushteve te punes dhe te kalibrohet kundrejt metodave për percaktimin e trashësisë së shtresave.
- Të ketë nje shufer sperkatje jashte sondes ne secilin prej fundeve te shufres sperkatese duhet te kete nje zone te hapur jo me shume se 25% apo jo me shume se 75% pervec sondave te tjera.
- Te mos kete asnje rrjedhje karburanti apo binderi;
- Shufra e sperkatjes, ku gjithë kokat e sperkatesit te jene te te njejtit tip qe hapen e mbyllen ne te njejtën kohe dhe nuk rrjedhin ndersa mbyllen;
- Te gjitha kokat e spërkatësve te spërkatën në të njejtin kend me shufren e spërkatjes dhe të pershtaten ne nivelin e duhur per te arritur shtrimin e kerkuar;
- Ti kenë fletet qe te mos ngatërrohen me njera tjetren;
- Duhet te pajisen me frena pneumatike që gezojne gjërësi të mjaftueshme në fërkim kur kontaktojnë me rrugën që të menjahohen thyerjet e kufirit apo krijimin e nje grope ne siperfaqe;
- Të jenë ne kontroll te drejtperdrejte te nje operatori qe eshte miratuar nga menxheri I projektit në bazë të referencave, me shkrim, apo ne bazë të një certifikate qe autorizon perfaqesues Autoritetin e Rrugeve.
- Kontraktori do sigurojë një menyre prove ne kantier që shpërndaresi i binderit të kete rezerva te mjaftueshme për të ruajtur shpejtesine konstante të kerkuar ne kthesën më të fortëe ku sperkatësi nuk ka mundur të nderhyje, dhe të arrije një shpërndarje sa me uniforme të përzierjes.
- Niveli me optimal i spërkatjes e percakton prova, dhe me pas ky nivel do rregullohet sa më mirë perpara cdo spërkatje. Nje aplikim jo i rregullt i binderit nuk do pranohet.

5.3. Shpërndarësit e gurëve

Shpërndarësit e gurëve do bëjnë të mundur të shperndajnë gurë me të njejtat permasa specifike rregullisht në një gjerësi qe varion ndermjet 0.75 meter dhe 2 metrave apo me shumë dhe do bëjë të mundur që të lejojë ndryshimin e vlerës së aplikimit brenda tolerancave te specifikuar, dhe te shperndaje ne menyre uniforme ne ne dyrja drejtimet transversale dhe gjatesore.

Shpërndarësit që nuk kanë një forcë shtyrëse të veten do jenë nga ai tip që mund të ngjiten shumë shpejt në anën e prapme të trungjeve, dhe të nderhyjnë nderkohë që terhiqen mbrapsht ndersa po shperndahen gurët.

5.4. Rrulat

Ne kantier duhen rula te mjaftueshëm që janë të shumëllojshëm per punimet në menyrë që të ruhet koha e duhur e punës. Te paktën duhet nje rul pneumatik:

Rulat me frena pneumatike

Rulat me frena pneumatike duhet te kene nje force te veten ngjeshese te pajisur me nje profil shume te lemuar te sheshte me frena pneumatike me permasa e dimetër uniform. Masa e rulit nuk duhet te jete me pak se 20 ton (e pangarkuar) dhe do operojne deri ne 15 tone deri ne nje urdher te dyte dhene nga Mbikqyrësi.

Rulat duhet te pajisen me gjithë mjetet e nevojshme që mbajne rrotat të lagura dhe të pastra gjatë ndërhyrjes.

Rrotat e rulit duhet të kenë hapësiren e nevojshme që njeri kalim I rulit të kapë gjithë atë copë që eshte e barabartë me gjërësinë rrotulluese te makinerise. Masa totale nderhyrese dhe presioni I frenave mund te ndryshoje vetem nga urdherat e Mbikqyresit te Punimeve. Presionet e seciles frene nuk duhet te jene me shume se 35 kPa nga njera tjetra.

Rulat Fshirës me rrota hekuri

Rulat fshires me rrota hekuri kanë forcë shtyrëse të veten, dhe kane nje mase ndermjet 6 dhe 8 tone. Duhet te kene gjithë mjetet e nevojshme qe te pastruar dhe luciduar rrotat. Rrotat e rulit do pershtaten per te kaluar gjithë zonën, vetëm me kalimin e nje ruli, me një gjërësi që është e barabartë me gjërësinë rrotulluese të rulit.

Rulat me rrota hekuri

Rulat me rrota hekuri do kenë nje force shtyrese tre rroteshe apo rulat biciklete me mase nga 6 dhe 8 tone dhe do kene mjetet e nevojshme per pastrimin dhe lucidimin e rrotave. Masa e rulit qe kerkohet do miratohet vetem nga Mbikqyrësi. Pa miratimin e Mbikqyresit te Punimeve nuk do perdoret asnje rul me rrota hekuri.

Kërkesa Shtesë

Lloji dhe numri i rulave do behet me miratimin e Mbikqyresit te Punimeve për secilin lloj të garancisë dhe programit te propozuar.

Asnje punim garancie nuk do vazhdojë nëse rulat e kërkuar nuk janë në kantier apo në kushte pune.

5.5. Furcat

Furca fërkuese do ketë atë përmase lloj dhe masë që heq gjithë gurët që mund të shperndahen mbi siperfaqe dhe pa shkarkuar asnje gur nga binder..

Furca rrotulluese

Nje furcë rrotulluese e miratuar, e kompletuar me mjetin terheqes qe eshte pershtatur me frena të lemuar pneumatike, qe duhet te jene prezent në cdo kohë gjate Punimeve.

5.6. Impinati me veshjen paraprake

Spërkatja e gurëve mund të behet nga cdo makineri e përshtatshme që është e aftë të mbulojë gjithë guret në mënyrë uniforme.

5.7. Makineri te Ndryshme

Makineri të mjaftueshme për kapjen dhe tërheqjen e agregateve dhe binderit duhet të sigurohen që bëjnë në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme zhvendosjen dhe aplikimin e materialeve bituminoze si specifikohet. Kontraktori do beje të mundur gjithë makineritë e nevojshme ndihmëse dhe veglat e punës për të kryer sa më mirë punën.

Makinerite kundër zjarrit për të shuar zjarret nga bitumi që mund të shaktohen në terren, sëbashku me makinerite e duhura për ndihmen e parë kundër djegieve me bitum.

Mbikqyrësi do jetë përgjegjës që do kërkojë impiantin e rezervës, nëse do ketë dyshime për mosfunksionimin e makinerive të siguruar.

6 .Kufizime dhe Kërkesa te Pergjithshme

6.1. Kufizime nga Moti

Minimumi I temperaturave të sipërfaqes rrugore në të cilat sperkatja e llojeve dhe niveleve të ndryshme të binderit do behet si më poshtë:

Binderat me Bitum

- | | |
|---------------------------------------|------|
| • nivelim – penetrim me bitum | 25°C |
| • MC-800 nivelim – penetrim me bitum | 10°C |
| • MC-3000 nivelim – penetrim me bitum | 10°C |

Sa herë që temperatura e sipërfaqes së rrugës ulet nën temperaturën e sipër treguar për binderin në fjalë, apo, sipas mendimit të Mbikqyrësit të Punimeve, patjetër do ulet nën temperaturën e kërkuar për sperkatjen me binder, asnjë shtresë binderi nuk do hidhet.

Nuk do kryhet asnjë punim me bitum gjatë ndonjë kohe me mjergull apo kohe me shi, dhe, kur fryn era e ftohtë, temperatura e mesiperme do rritet deri në 3°C deri në 6°C sic udhëzohet nga Mbikqyrësi.

Kur frynë era të ftohtë që mund të interferojnë në vetë ushtrimin e punimeve, asnjë punim garancie dhe vecanerisht sperkatje me binder nuk do kryhet në asnjë mënyrë.

6.2. Permbajtja e perziereësve

Asnjë shtresë nuk do vihet derisa perberja e perzierjes që ka arritur maksimumin deri në 50 mm në baze të jete me pak se 50% e permbajtjes së perziereësve sic përcaktohet nga Mbikqyrësi. Nuk do hidhet asnjë shtresë tjetër menjëherë pasi të ketë rënë shi në pjesën ekzistuese të plasarit dhe/apo në sipërfaqen që rezulton tepër poroze në ngecjen e perziereësve në strukturën shtruese. Një vonesë prej 24 orësh apo një shtyrje kohe në afat do behet vetëm nëse udhëzohet nga Mbikqyrësi.

6.3. Kufizime të tjera

Do aplikohet periudha e kruimit si me poshtë për të bërë trajtimet e mëposhtme, përpara se të bëhet aplikimi shtresës bazë/si shtrim meqë kjo specifikohet në Specifikimet e Projektit:

- | | | |
|---|---|---------|
| • | Teksture me ujë dhe material argjile | 6 javë |
| • | Hedhje e menjehershme e ujit dhe këtyre materialeve | 12 javë |
| • | Shtrimi i plasaritjeve | 2 javë |
| • | Riparimi i gropave të mëdha | 6 javë |

Derisa të miratohet një urdher tjetër nga Mbikqyrësi, që do ketë prova të tjera në vijim, Kontraktori do procedojë me programin e gjithë shpatkëve në çdo ditë pune në orën 15.00.

6.4. Përgatitja e zonave që do shtrohen (tapeti)

Te përgjithshme

Zonat që do shtrohen në bazë do pastrohen nga ngjitje pluhurat dhe papasteritë, karburantet e derdhura apo të tjera materiale të demshme që mund të shkaterojnë shtresën bazë.

Tapete të reja për tu ndertuar

Atje ku ka nevojë për bazë apo bankina të reja do bëhet sërisht shtrimi, sipërfaqet do kontrollohen për përputhshmëri me tolerancat e sipërfaqes dhe gjithë kërkesat e tjera që janë specifikuar. Çdo lloj porcioni që nuk përputhet me kërkesat e vena ose do korrigjohet më parë ose do hiqet dhe rindertohet para se të shtrohet.

Sipërfaqet ekzistuese për tu rishtruar

Rruget ekzistuese që kërkojnë rishtrim, në fillim duhet që të urdhërohen nga Mbikqyrësi.

6.5. Venia e kufijve të zonave të punës

Punët e reja

Kontraktori do kufizojë zonen e primerit bazë që do shtrohet me anë të piketimeve të linjave të korrentit në çdo skaj të gjërësise së specifikuar për shtrim.

Punimet që duan rishtrim

Menjëherë pas veshjes së pare apo pasi të spërkatet me binder, linja qendrore e rrugës do vijëzohet nga një fiber apo ngjeshje me tekstile deri në 3 mm trashësi, e siguruar mirë me thumba, në çdo interval prej 15 m drejt dhe intervale në kthesa prej 5 m, nëpër sipërfaqen ekzistuese. Kjo tekstile do lihet në një pozicion që të jete gati për gjithë nderhyrjet e mëpasme.

7. Lidhjet

Të gjitha lidhjet ndermjet seksioneve në afersi me punimet do behen me anë të prerjes së shtresës sapo të hidhet materiali. Duhet të hiqet menjëherë materiali që del tepër apo që s' duhet. Një vegël prerese do nevojitet për të prerë lidhjet gjatësorë.

Lidhjet do behen si për kendet edhe ato paralele në linjen qendrore, si dhe lidhjet në shtresën përfundimtare të sipërfaqes aty ku të jetë e mundur, duke korresponduar me vijëzimet e korsise.

Përpara se të hidhet serish një shtresë e re në atë ekzistuese, shtresa ekzistuese do lyhet me një shtresë të hollë bitumi të të njëjtit lloj që përdoret për shtresën mbuluese, sipas udhëzimeve të Mbikqyesi i Punimeve, ose shtresa do përshtatet me një djegës gazi për të nxehur sipërfaqen e shtresës ekzistuese.

Fugat do kenë rrjeta dhe të njëjtin material dhe densitet sic e ka pjesa e ngelur e asfaltit. Gjithë fugat do shkruhen me shkumës për të dalluar në procesin e prerjes.

Skajet e jashtme të shtresës asfaltike do shkurtohen gjatë bankinës, dhe paralelisht me linjen qendrore, për të marrë gjëresinë përfundimtare, sic tregohet në vizatimet që bashkeshoqërojnë specifikimet, brënda tolerancave .

Cdo spërkatje aksidentale në punimet ekzistuese nëpër fuga do hiqet me përthithje të furcave drejt punimeve që s'kanë ende ngjeshje, në mënyrë që të menjahohen parregullsitë nëpër fuga. Sado të ndaloje e bllokohet procesi i shtrimit për shkak të përzierjes, gjithmonë Kontraktori do formoje një lidhje të duhur sipas kushtëve të mesipërme, sipas udhëzimeve të Mbikqyesi i Punimeve.

8. Ngjeshja

Përzierja duhet të rrotullohet sa me shpejt të jetë e mundur pasi ajo të përpunohet me vibrator, rrotat metalike dhe rulat pneumatikë me tërheqje në një sekuenca të parapërcaktuar dhe miratuar gjatë shtrimit të seksionëve të proves. Një rrotullim i tillë do nisë dhe veazhdoje vetëm për aq kohësa është efektiv dhe s'rezulton gabim. Përdorimi i rulave pneumatike me tërheqje për binderat e pagraduar dhe johomogjenë do vlerësohet nga seksionet e proves.

Duhet të përdoren sa me shumë rula që të jetë e nevojshme për të siguruar kështu densitetin e specifikuar të shtresës dhe materialin e kerkuar. Gjatë rulimit të sipërfaqes, rrotat metalike do mbahen të lagur me ujë të mjaftueshëm për të menjanuar ngarkimin e materialit.

Pasi të behet ngjeshja e lidhjeve gjatësorë dhe skajeve, do nisë rulimi gjatësor për anët dhe gradualisht duke shkuar drejt qendrës së rrugës, përveç në kthesat e mbiniveluara, apo në ato vende ku zonat ku do shtrohen kanë prerje tërthore që bie drejtë, dhe kur të nisë me rulim do nisë në pjesën e ulët, dhe të ngrihet me krahun e sipërm, duke prekur serish cdo gjurmë të meparshme, për të mbuluar gjithë zonën në tëresi. Gjatë lodhjes/uljes së fuqisë së rullit, rulat do kenë një shpejtësi të ulët por uniforme (jo më tepër se 5 km/h) me rulin që kalon në shtresën me të afert, derisa të specifikohet për llogarit të kulmeve të thepisura.

Nuk duhet të behet asnjë levizje e shtresës asfaltike gjatë punës së rulave pneumatike me tërheqje me të renë temperaturë të asfaltit nën 100°C. Rulat me tre rrota, që kanë diametër të madh të frenave, preferohen të jenë të llojit si bicikletë dhe mund të përdoren në lidhje me rulat pneumatike me tërheqje që të sigurojnë rimorkion të asfaltit e të mos derdhet e ngelet nëpër rrota.

Për përzieresit e binderave jo homogjenë rekomandohet që të shtohet një detërgjent tregu me përqëndrim nga 1 deri 3,000, në uje që të përdoren të njoma gomat e rulave pneumatike, që të limitojnë rimorkion. Sekuenca e rulave që do përdoren për ngjeshje i takon anës së Kontraktorit që të sigurojë shtrimin e kompletuar me një densitet sic matet në berthamen e mbuluar deri apo me të madhe se 97%, heqim përqindjet e boshllëqëve në përzierjen e miratuar, teorikisht të densitetit maksimal.

Kontraktori do ndermjetësojë një mase të kalibruar për të vazhduar me kontrollin gjatë operimeve të ngjeshjes. Përveç kësaj kërkese, kontrolli i miratuar që ndermerret për operimet e ngjeshjes në lidhje me përfundimin e punimeve nga Mbikqyrësi do vazhdohet serish me bazën në shtresat e ngjeshjes po nga Mbikqyrësi. Kjo do të bazohet nga shtresat e marra nga baza e shtresës së ngjeshur.

Kërkesat e meposhtëme do aplikohen përgjithësisht për rulimin dhe ngjeshjen që janë:

- Materiali nuk do shpërndahet në mase të tëpërt gjatë drejtimeve gjatësorë dhe transversale vecanërisht kur ndyshohen marshet, kur ndalohet apo nisën rulat.
- Nuk do formohet asnjë plasaritje apo fije fshese nuk duhet të nderthuret apo lidhet me shtresën e poshtme që nuk duhet të thyhet.
- Densiteti do jetë uniform me gjithë zonën që është hedhur shtresa dhe gjatë gjithë thellesisë së shtresës.
- Rulat nuk do lihen pa levizur në shtresën asfaltike para se të jetë ngjeshur tërësisht dhe të ftohet se bashku me temperaturën e ambjentit. Rulat nuk do lihen asnjëherë pa levizur kudo nëpër ato vende ku është hedhur asfalt.
- Në zonat e kufizuara ku rulat e specifikuar nuk mund të përdoren me, ngjeshja do kryhet me makineri ngjeshje mekanike që veprojnë me duar apo rulat me vibrim që janë të miratuar. Densiteti I përshkruar në kërkesa do jetë i aplikueshem për gjithë pjesën e ngelur, mbi gjithë trashësinë e shtresës, pa respektuar metoden e ngjeshjes.

a. Seksionet e provave

Para se Kontraktori të nisë me ndertimin e çdo shtrese asfalti apo shtrese sipërfaqësorë ai duhet të tregojë që, duke bërë proven mbi një sipërfaqë të shtruar prej 300 m², makineria dhe procesimet që ai mendon të përdorë, nuk do e lejojnë atë që të bëjë shtresën e asfaltit në përputhje me kërkesat e specifikuar.

b. Mbrojtja dhe Mirëmbajtja

Kontraktori duhet të mbrojë dhe asfaltojë sipërfaqën nga gjithë dëmtimet derisa punimet të pranohen përfundimisht nga Punëdhënësi dhe Kontraktori duhet të ruajë mirë sipërfaqën e asfaltuar derisa të leshohet certifikata e mirëmbajtjes. Çdo dëmtim që ndodh deri në sipërfaqën e përfunduar apo ndonjë defect që mund të çojë në ndonjë punim me probleme duhet të

rregullohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

Nivelimi

Sipërfaqja e përfunduar nuk duhet të jetë me pak se niveli i projektimit apo me shumë se 10mm me lartë se niveli i projektimit në cdo pozicion.

Niveli i sipërfaqës do kontrollohet nga instrumentat e nivelimit, të përdorura fillimisht me një kuader që përfshin 5 pozicionë tërthorë të karrexhatës me intervale të rregullta prej 15 metrave në sipërfaqe gjatë gjithë rrugës. Pozicionimi i këtyre seksionëve të provave duhet të behet në bazë të udhëzimeve të Menaxherti të Projektit dhe duhet të behet në mënyrë të tillë që ato të mos koencidoje normalisht me pikat e kontrollit që janë shfrytëzuar nga Kontraktori për të bërë pikëtimin e nivelimeve të sipërfaqës. Përvec nivelimit të provave, nivelet do ndermerren në cdo pikë ku sipas një inspektimi visual të jep përshtypjen që sipërfaqja mund të ketë çrregullime, ndryshime të medha apo të ulta të nivelimit.

Gjësia

Gjësia e sipërfaqës se përfunduar nuk duhet të jetë me pas se ajo që thotë projekti në vizatime në cdo pozicion dhe në asnjë vend nuk duhet të ketë devijim jashtë linjave të treguara në Vizatimet nga me shumë se 50 mm.

Trashesia

Trashesia e shtreses sipërfaqësore duhet të jetë e tillë që të përkoje me tolerancën e nivelit të lejuar me sipër. Trashesia në cdo vend duhet të jetë e saktë me atë që është përcaktuar në vizatime.

Kur dështon në plotësimin e Tolerancave të Sipërfaqes

(1) Kur dështon në plotësimin e kerkesave minimale themelore për trashesinë apo kur nuk plotëson dot minimumin e kerkesës se nivelit (jo me pak se niveli I projektimit) kjo nuk mund të jetë kurrsesi e pranueshme dhe do të zvogeloje koston e Kontraktorit, ose me heqjen dhe zevendesimin e shtreses nën standart apo me aplikimin e një shtrese shtese. Në rastin e shtreses shtese, përmbajtja, trashesia dhe materiali duhet të miratohet dhe do ndiqet e udhëzohet nga Mbikqyrësi, por në asnjë rast nuk do vihet një shtrese shtese me me pak se 20mm me material rere asfaltike apo 35 mm asfalto beton që lejohet. Në rastin e një shtrese prej 35mm të asfaltobetonit duhet të sigurohet një projekt I ri për përzierje asfaltike me ndermjetësimin e agregatëve me përmase deri në 18mm, e gjithë kjo në përputhje me këto Specifikime. Aty ku aplikohet material shtese kjo duhet të behet për gjatë gjithë gjëresise se rrugës për një gjatësi rrugë jo me pak se 100 metrash dhe një korsi shtese prej të paktën 10 metra gjatësi për reren Asfaltike dhe 20 metra gjatësi për asfalto betonin. Nuk modifikohet gjë vetëm me zhvendsojen e materialit shtese në mënyrë të tillë që hapësira ndermjet seskioneve të jetë me pak se 300 metrash. Në këtë rast duhet të shtrohet material shtese në gjithë gjatësinë e rrugës.

(2) Atje ku sipërfaqja është shumë e ngritur por që përmbush gjithë kërkesat për uniformitetin që janë përcaktuar me sipër dhe konform me gjithë kërkesat në përgjithësi për kanalet/kunetat, aty do të jetë e pranueshme në ato zona ku do aplikohën konsiderata shtese (psh. Interseksioni me asfaltimin ekzistues) ku Mbikqyrësi mund të pezulloje punimet dhe të kërkojë që të prishen dhe zevendesohen këto punime që të behen serish në përputhje me këto standarte.

(3) Aty ku sipërfaqja arrin trashesinë e kerkesave të vena por që dështon të arrije uniformitetin do të quhet i pranueshem deri në një pikë ndjekur nga penaltëti financiar. Aty ku niveli i

defekteve tejkalon maksimumin e pranueshem shtresa duhet të zvogelohet si një deshtim i plotësisimit të kerkeses se venë për trashesinë e kerkuar .

Sipas rrethanave duhet të miratohet një seksion për sipërfaqet në vendet ku ka devijim nga fundi i 3 metrave të skajit të drejtë që tejkalon 20mm. Në të tilla raste do behet nivelimi në jo me pak se 10 metra të gjithë gjëresise se korsise se përfunduar që do hiqet dhe do zevendesohet me nivelet e pranuar të uniformitetit të sipërfaqës.

Në asnjë rast nuk duhet të miratohet një sipërfaqë me shumë defekte .Kur totali i parregullsive në gjithë korsitë tejkalon 7mm në cdo 100 metër të gjatësisë lidhese të rrugës, në këtë rast sipërfaqja duhet të zvogelohet e quhet deshtim në plotësimin e trashesise se kerkuar sic është përcaktuar me sipër.

Atje ku dështon shtrimi i sipërfaqës në lidhje me kërkesen e uniformiteti por që mund të pranohet nëpërmjet një penaliteti financiar në përputhje me Standartet e paragrafit me poshtë ky penalitet do përcaktohet si me poshtë:

Të përcaktohet precizioni i milimetrave të vlerave maksimale të gjithë parregullsive që tejkalojnë 5mm në cdo seksion prej 100 metrash në secilën korsi të prekur. Të hiqen 30mm nga ky total dhe të ndahet shuma që del me 10; merr rezultatin si përqindje të asaj pagese për atë sipërfaqe që prek 100 metra rrugë si një faktor që do ulet.

Psh. Totali i gjithë parregullsive maksimale në proven e 100 metrave gjatësi është 102mm. Heqim 30 lihet 72mm.

Ulet pagesa nominale për një sipërfaqë që kap 100 metra për një korsi me koeficientin prej 7.20%.

9 .Karakteristikat specifikimet dhe punimet për shtresat

9.1 Përshkrim

Ky specifikim mbulon gjithë materialet, impiantin e ndertimit, dhe kërkesat për të marrë trajtime apo veshje me bitum në rrugë në gjithë pozicionët e treguara në Vizatime.

Trajtimet e sipërfaqës do konsistojnë në aplikimin e veshjes me bitum që vihet në rrugë ndjekur nga spërkatja me agregatë në rastin e veshjes se vetme të dhe përseritjen e kësaj në rastin e veshjes dopio të sipërfaqes) në zonat e treguara sipas Vizatimeve.

9.2 Materialet

Binderi me bitum

Binderi me bitum do përmbaje specifkimet në përputhje me ato që miratohen nga Mbikqyrësi.

Shtrimi i drejtë me Bitum

Shtrimi i drejtë me bitum. sipas Standartit Shqiptar

Spërkatja dhe cilesitë e thithjes se bitumit të shtruar drejt mund të përmirësohen nëse krijohet mundësia në kantier me anë të spërkatësve/preresve me sasitë e miratuara të parafinës se fuqishme në përputhje me procedurat e miratuara

Nivelimi

Nivelimi do përputhet me kërkesat e vendosura në tabelen me poshtë për agregatët që do

përdoren:

9.3 Prerjet e shtresave bituminoze

Sasitë maksimale të parafinës mund të shtohen me lejen e Mbikqyesi i Punimeve për pjesen me të madhe të asfaltobetoneve kategoria bitum që varet nga temperaturat e sipërfaqes rrugore në kohën e spërkatjes. Sasi me të vogla se ato që janë treguar mund të përdoren, nëse e lejojnë kushtet në testim që të krijohet përthithja e duhur ndermjet binderit, agregatit dhe sipërfaqes ekzistuese. Preresi me i mirë është fuqia e parafinës por që nafta apo kerosoni mund të përdoren për prerjen e bitumit sipas direktives se Inxhinierit.

9.4. Kufizime nga Moti

Minimumi i Temperaturave të sipërfaqës rrugorë në të cilat spërkatja e llojeve dhe niveleve të ndryshme të binderit do behet si me poshtë:

Binderat me Bitum

- | | | |
|---|-------------------------------------|------|
| • | nivelim – penëtrim me bitum | 25°C |
| • | MC-800 nivelim – penëtrim me bitum | 10°C |
| • | MC-3000 nivelim – penëtrim me bitum | 10°C |

Sa here që temperaturat e sipërfaqes se rrugës ulet nën tëmpëraturen e sipër treguar për binderin në fjale, apo, sipas mendimit të Mbikqyesi i Punimeve, patjetër do ulet nën tëmpëraturen e kerkuar para spërkatjes me binder, asnjë shtrese binderi nuk do hidhet.

Nuk do kryhet asnjë punim me bitum gjatë ndonjëkohëme mjergull apokohëme shi, dhe, kur fryn ere e ftohtë, Temperaturat e mesipërme do rritët deri në 3°C deri në 6°C sic udhezohet nga Mbikqyrësi.

Kur fryjnë era të ftohta që mund të ndërferojnë në vetë ushtrimin e punimeve, asnjë punim garancie dhe vecanërisht spërkatje me binder nuk do kryhet nëasnjë mënyrë.

9.5. Përmbajtja e përzieresve

Asnjë shtrese nuk do vihet derisa të përpërja e përzierjes që ka arritur maksimumin deri në 50 mm në bazë të jetë me pak se 50% e përmbajtjes se përzieresve sic përcaktohet nga Mbikqyrësi. Nuk do hidhet asnjë shtrese tjetër menjehere pasi të ketë renë shi në pjesen ekzistuese të plasaritur dhe/apo në sipërfaqën që rezulton tëpër poroze në ngecjen e përzieresit në struktura shtruese. Një vonëse prej 24 orësh apo një shtyrjekohëne afat do behet vetëm nëse udhezohet nga Mbikqyrësi.

9.6. Kufizime të tjera

Do aplikohet periudha e kruimit si me poshtë për të bërë trajtimet e meposhtëme, përpara se të behet aplikimi shtreses bazë/si shtrim meqë kjo specifikohet në Specifikimet e Projektit:

- | | | |
|---|--------------------------------------|--------|
| • | Teksture me uje dhe material argjile | 6 jave |
|---|--------------------------------------|--------|

- | | | |
|---|---|---------|
| • | Hedhje e menjehershme e ujit dhe këtyre materialeve | 12 jave |
| • | Shtrimi i plasaritjeve | 2 jave |
| • | Riparimi i gropave të medha | 6 jave |

Derisa të miratohet një urdher tjetër nga Mbikqyrësi, që do ketë prova të tjera në vijim, Kontraktori do procedojë me programin e gjithë spërkatjeve në cdo ditë punë në orën 15.00.

9.7. Përgatitja e zonave që do shtrohen (tapeti)

Të përgjithshme

Zonat që do shtrohen në bazë do pastrohen nga pluhurat dhe papastërtitë, karburantët e derdhura apo të tjera materiale të demshme që mund të shkatërojnë shtresën bazë.

Tapete të reja për tu ndertuar

Atje ku ka nevojë për bazë apo bankina të reja do behet serish shtrimi, sipërfaqët do kontrollohen për përputhshmeri me tolerancat e sipërfaqës dhe gjithë kërkesat e tjera që janë specifikuar. Cdo lloj porcioni që nuk përputhet me kërkesat e vena ose do korrigojohet me pare ose do hiqet dhe rindertohet para se të shtrohet.

Sipërfaqet ekzistuese për tu rishtruar

Rrugët ekzistuese që kërkojnë rishtrim, në fillim duhet që të urdherohen nga Mbikqyrësi.

9.8 Venia e kufijve të zonave të punës

Punët e reja

Kontraktori do kufizojë zonën e primerit bazë që do shtrohet me anë të pikëtimeve të linjave të korrentit në cdo skaj të gjëresise se specifikuar për shtrim.

Punimet që duan rishtrim

Menjehere pas veshjes se pare , linja qëndrorë e rrugës do vijejohet nga një fiber apo ngjeshje me tekstile deri në 3 mm trashesi, e siguruar mirë me thumba, në cdo interval prej 15 m ne rrugen drejt dhe intervali në kthesa prej 5 m, nëpër sipërfaqën ekzistuese. Kjo tekstile do lihet në një pozicion që të jetë gati për gjithë nderhyrjet e mepasshme.

9.9 Hapja për Trafikun

Mbikqyrësi do jetë përgjegjës për përcaktimin e cdo rruge që shtrohet në mënyrë që mos zihet trafiku për publikun.

Rruga nuk do hapet për trafikun deri sa binderi të thahet mjaftueshem për të mbajtur cakullin në mënyrë që mos kapet nga rrotat e automjeteve.

Kontraktori nuk do lejojë që të kalojë sipër rrugës se sapa shtruar ndonjë makinëri e ndertimit pasi mund të shkaktojë dëme në asfalt. Kontraktori duhet të pajisë rrugen me sinjalistike për limitin e shpejtësisë në përputhje me udhëzimet e Mbikqyrësi i Punimeve.

9.10. Defektet

Sipas opinionit të Mbikqyrësi i Punimeve atje ku ka humbje të theksuar të gjurmës rrugorë nga rreshqitja e rrugës dhe ku nuk janë verejtur mirë gjithë kërkesat e Specifikimeve gjatë rrjedhës së punimeve të Kontratës apo gjatë Periudhës së Përgjegjshmerisë së Defekteve e ky defekt mund t'i

transferohet Kontraktorit, për arsye se nuk ka shfrytëzuar saktë vlerat e aplikimit, apo ndonjë gabim apo defekt tjetër ardhur nga Kontraktori, atëhere Mbikqyrësi do urdherojë punimet korrigjuese të cilat do kryhen me kosto të Kontraktorit, duke përfshirë furnizimin, shtresat, grumbullimin e materialeve në kantierin e përzgjedhur dhe me vonë c'montimin e tyre, e zhvendosjen e cakullit që ishte rezervuar për punimet korrigjuese. Kontraktori duhet që në cdo rast të jetë ai përgjegjësi për Mirëmbajtjen e rrugës gjatë gjithë Përiudhes së Mirëmbajtjes Rutinë.

9.11 Punime të lidhjes së shtresave me sipërfaqet ekzistuese

Shtresa përfundimtare do behet uniform me teksturen pa asnjë boshllëk apo grope dhe nuk do ketë asnjë material agregat të humbur apo derdhje bitumi.

Cdo zonë që tregon ndonjë shenje derdhje pasi të jetë hapur ky seksion rrugën për trafikun atëhere do behet korrigjimi i rrugës punimet korrigjuese do ndermerren në një mënyrë të tillë që të përpunohet Mirë ngjyra, tekstura, dhe shtresa përfundimtare me punime të ngjashme.

Shtresa bazë përfundimtare nuk do ketë porozitet apo ndonjë vlezim të llojit tjetër që mund të ndiqet me pas me deformime dhe ngritje të pajustificueshme dhe nuk ka asnjë rendesi nëse distanca është shumë e vogël ndermjet deformimeve që mund të çojë me vonë në një carje të mevonshme.

Skajet e shtrese do jenë të tilla që ti përputhen një devijimi maksimal prej 15 mm nga linja e skajit të specifikuar.


10. Riparimi i plasaritjeve

-10.1. Plasaritjet gjatësorë

Formimi dhe zhvillimi i plasaritjeve në shtresën qarkulluese duhet të evitohet me qëllim të ndalimit të depërtimit të ujrave atmosferike në shtresat e konstruksionit të rrugës që mund të shkaktojnë ngrirjen e ujrave gjatë dimrit dhe zhvillimit të gropave me vonë.

Plasaritjet në tërë gjatësinë e tyre duhet të trajtohen në këtë mënyrë: pastrimi i tyre me kompresor dhe mbushja me ngjitës bituminoz.

Shembuj të plasaritjes gjatësorë në figurat e mëposhtëme.




10.2. Plasaritje (gjatësorë dhe tërthorë) – të kryqëzuara

Sipërfaqja duhet të trajtohet si në vijim:

- Pastrimi i sipërfaqës me kompresor ajri
- Spërkatja me leng të nxehtë bituminoz
- Shpërndarja e fraksionit 3/8 mm dhe ngjeshja deri ne nivelin e shtreses ekzistuese, pa krijuar cedim.

Shembull plasaritje tërthorë



Shembull të plasaritjeve në forme rrjetë por dhe cedim të shtresave

10.3 Riparimi i anëve të rrugëve

Skajet e demtuara dhe të deformuara të shtresave do të riparohen si me poshtë:

- Prerja e skajit në gjëresi deri në 50 cm
- Largimi i materialeve të prera
- Formimi i ri i skajeve të prera
- Pastrimi i sipërfaqës
- Furnizimi dhe shtrirja e asfaltobetonit duke përfshirë edhe ngjeshjen për nivelimin e plotë të shtresës së korigjuar.

Pjesa M

Kanalet e betonit për drenazhet dhe drenazhet e nëndherave

1.Përshkrim

Puna sipas këtij Seksioni do konsistojnë në ndertimin e kanaleve të drenazhit prej betoni të llojeve që janë treguar në vizatime dhe instalimin e drenazheve të nëndherave.

Puna do përfshijë klauzolen për lidhjet dhe çdo bashkimi që duhet për të marrë ndertimin e tubave lidhes nga basenët pritëse, Drenazhet e tokës, kanalet dhe tiparet e tjera që mund të hasen apo janë treguar në Vizatime dhe sic mund të kërkohej nga Mbikqyrësi.

2.Programimi i Punimeve

